

NJË RAST I PANJOHUR

ROMËT NË SHQIPËRI

RAPORT I QËNDRËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E ROMËVE

Seria e "Raport mbi Vendin" Nr. 5

Korrik 1997

TABELA E PËRMBAJTJES

Mirënjohje

1. Hyrje
2. Nje Krim i Urryer: Vrasja e Fatmir Haxhiut
3. Abuzimi policor ndaj romëve të Shqipërise
 - 3.1. Dhuna, përvetësimi i paarave dhe arrestimet e paligjshme
 - 3.2. Konfiskime të paligjshme
 - 3.3. Marrja peng nga policia dhe të drejtat për nje proces gjyqesor legjitim
 - 3.4. Vrasjet policore
4. Dhuna në komunitet
 - 4.1. Shpërnguljet për shkak të ndarjes se tokave
 - 4.2. Romet si qytetare pa mbrojtje
5. Trajtimi diskriminues ndaj romëve
 - 5.1. Diskriminimi nga autoritetet lokale
 - 5.2. Diskriminimi në ushtri
 - 5.3. Diskriminimi në shkolla
6. Manipulimi politik i romëve shqipëtare
7. Romet e Shqipërise jashtë shtetit
8. Ne Zyren e të Drejtave të Njeriut
9. Epilogu: Logjika e kaosit
10. Nje zgjidhje e drejtë: Rekomandime të Qendres Europiane per te Drejtat e Romëve drejtuar Qeverise Shqiptare
11. Bibliografia
12. Shtojcat

MIRËNJOHJE

Qendra Europiane per te Drejtat e Romeve (ERRC) u është shumë mirënjohëse për kohën, mundimin dhe ndihmën personave të mëposhtëm, pa të cilët, përgatitja e këtij raporti nuk do të ishte e mundur.:

Shumë romëve dhe jevgjeve të Shqipërisë që pranuan të intervistohen nga ERRC.

The Human Rights Project (Bullgari) që ndau bujarisht me ERRC informacionin dhe intervistat e një misioni të mëparshëm (Janar 1996) ne Shqipëri.

Përveç personave të përmendur në raport, Elsa Ballauri, Zef Brozi, Marcel Cortiade, Robin Phillips, Arben Puto dhe Valdete Sala na ofruan informacion mbi romët në Shqipëri, minoritetet në Shqipëri, historinë e shoqërinë shqiptare, dhe mbi ligjin shqiptar.

Altin Hazizi dhe Edlira Hoxholli shërbyen si perkthyes gjatë misionit të ERRC në Shqipëri. Fisnik Bajo, Andi Dobrush, Pëllumb Fortuna, Arian Pano dhe Artan Puto, qe ndihmuan ERRC përpara, gjatë dhe pas kerkimeve në Shqipëri.

Fred Abrahams, Betty Ebelrly, Altin Hazizaj, Kathleen Imholz dhe Orla Mulholland lexuan një ose më shumë se një draft të raportit dhe ofruan komente rreth formës dhe përmbajtjes së tij.

"Pse po endeni nëpër të gjithë Shqipërinë? Unë mund t'ju tregoj të gjithë historinë që tani. Ata rrinë në një zyrë sa mbushin xhepat me para, dhe pastaj lëvizin-- ata nuk rrinë kurrë kaq gjatë në një vend, sa të merren me diçka."

Një i ri shqiptar, Dhjetor, 1996

1. HYRJE

Në bazë të statistikave zyrtare të regjistrimit të fundit të popullsisë shqiptare (Prill 1989), 98% e popullsisë prej 3.182.417 persona janë shqiptarë etnikë. Pjesa tjetër prej 2% (64.186) janë: 58.785 grekë etnikë, 4697 maqedonas, 100 malazezë dhe serbë dhe 1261 "të tjerë", të përbërë kryesisht nga vllahë dhe arixhinj¹. Këto shifra, veçanërisht për këta të fundit janë shumë të dyshimta.

Burime të tjera vlerësojnë se në Shqipëri jetojnë deri në 120.000 Romë (arixhinj).² Ata përbëjnë katër fise të mëdha, Meckâra, Kabuzie, Cergâra ose skodrâra, dhe Kurtôfa.³ Së paku 5.000 romë jetojnë në katër lagje të Tiranës⁴, më e madhja e të cilave është në rrethinat e "Kinostudios"⁵. Afërsisht 1.200 romë banojnë në komunën e Halilaj në Fushë-Krujë, 25 km në veri perëndim të Tiranës.⁶ Romët jetojnë në një numër komunitetesh të mëdha në Fier dhe rreth tij, kryesisht komuniteti i madh urban i "Lagjes Azotik" (afërsisht 1.400 persona), rrethinat e Baltezës (600-800 persona), dhe në fshatin fqinj *Levan* (afërsisht 2.400 persona). Romë jetojnë në zona të veçuara rreth qyteteve juglindor të Korçës, kryesisht në fshatrat e Bilishtit, Maliqit, Pojanit dhe Zverdës. Afërsisht 800 romë banojnë në një zonë të veçantë në afërsi të qytetit të Delvinës. Në Berat, afërsisht 200-300 romë banojnë në periferi të qytetit, por vitet e fundit shumë prej tyre janë shpërngulur për në komunitetin e madh rom të Elbasanit. Një vendbanim tjetër pranë Beratit, në Moravë, përbëhet nga afërsisht 800 romë. Në qytetin jugor të Gjirokastrës, afërsisht 2.000 romë jetojnë në një lagje të veçantë të quajtur Zinxhiraj. Komunitete të vogla romësh ekzistojnë në të gjithë Shqipërinë.

Romet kanë jetuar në territorin e shtetit të sotëm shqiptar prej 600 vjetësh.⁷ Ardhja e tyre koinçidoi me nënshtrimin e popullit të Shqipërisë së sotme ndaj otomanëve turq. Gjatë mëse 500 vjetësh të sundimit otoman mbi katër vilajetet (njësi administrative në perandorinë otomanë), shumica e romëve dhe shumë shqiptarë ndryshuan fenë në myslimanë.⁸ Jeta e romëve ndryshoi pak pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë më 1912⁹ dhe, sipas Kenrich & Puxon, trajtimi i romëve nën pushtimin italian (1939-43) ishte relativisht i mirë, ashtu si edhe në Itali. Gjatë Luftës së II Botërore, ndryshe nga vendet e tjera të Evropës Lindore, nuk ka patur kampe përqëndrimi apo persekutim sistematik të romëve:

Duket që arixhinjtë vazhduan një ekzistencë paqësore gjatë gjithë Luftës së II Botërore megjithëse ka një histori sipas së cilës disa u internuan në një ishull të Adriatikut. Disa arixhinj u bashkuan me partizanët nga 1943 e mbrapa.¹⁰

Gjatë periudhës së komunizmit, nën qeverisjen e gjatë të komunistit diktator Enver Hoxha nga 1944 deri në vdekjen e tij më 1985, u bënë shumë përpjekje për të krijuar një komb unik shqiptar nëpërmjet shtypjes së identitetit kulturor. Argumenti zyrtar ishte që minoritetet gëzonin të njëjtat të drejta si edhe qytetarët e tjerë

¹ Shifrat janë marre nga e perditshmja shqiptare *Zeri i Popullit*, 9 korrik 1989, te cituara ne Hall, Derek, *Albania and Albanians* [Shqiperia dhe Shqiptaret], London, Pinter Reference, 1994, p. 25. Per romet dhe arixhinjte nuk ka patur kategori te vecante regjistrimi.

² Shiko shtojcën 1.

³ Kurtiade, Marcel, " Between Conviviality and Antagonism: The Ambiguous Position of the Romanies in Albania" Midis bashkejteses dhe antagonizmit: Pozicioni i papercaktuar i romeve ne Shqiperi], *Patrin*, No.3, 1995, p. 10.

⁴ Duka, Jeta; Duka, Jenuz and Veliu, Skender, Famille, habitat, emploi chez les roms", *Les familles Rom d'Europe de l'Est*, IDEF, No.3, 1993, pp.48-50.

⁵ On kinostudio [Ne kinostudio], shiko Fonseka, Isabel, *Bury Me Standing* [Me varrosni ne kembe], London: Chatto & Windus, 1995, pp. 22-82, si dhe Fonseca, Isabel "Among the Gypsies" [Midis Arixhinjve], *The New Yorker*, September 25, 1995, pp.84-97.

⁶ Duka, Duka and Veliu, cituar me pare, p.49.

⁷ Kolsti, John, "Albanian Gypsies: The silent Survivors" [Arixhinjte e Shqiperise: te mbijetuarit e heshtur], ne Crowe and Kolsti eds., *The gypsies in Eastern Europe*, Armonk, New York: Sharpe, 1991, p. 51.

⁸ Kjo nuk eshte e vertete per Shqiperine e Jugut ku, ERRC [Qendra Europiane per te Drejtat e Romeve] vrojtoi qe shume rome, si edhe minoriteti grek i Shqiperise se Jugut, jane anetare te kishes ortodokse.

⁹ Ne vendet fqinje dhe veçanerisht ne Jugosllavi, pas shembjes se perandorise turke, shqiptaret etnike u konsideruan si grupi etnik fajtor per bashkepunimin me otomanet. Romet ne rajonet e Maqedonise dhe Kosoves ne Jugosllavi, te cilet kishin filluar te asimiloheshin qysh me pare prej shqiptareve, shpesh rane ne gracken e persekutimit post-otoman ne shtetet e reja sllave. Romet ne Shqiperi i shpetuan ketij fati ngaqe nuk ishin te bashkuar me ndonje minoritet etnik te akuzuar per ndihme dhe bashkepunim me nje fuqi te huaj. Shiko Kolsti, John, cituar me pare, pp. 52-53.

¹⁰ Kenrich, Donald and Puxon, Grattan, *Gypsies Under the Swastika* [Arixhinjte nen Swastika], Hatfield: University of Hertfordshire Press, 1995, p. 108.

shqiptarë.¹¹

Sipas ortodoksise së ngurtë staliniste e cila u aplikua ne forme shabllon në Shqipëri, shoqëria supozohej të zhvillohej drejt homogjenitetit të plotë, në të cilin identitetet kulturore dhe etnike do të treteshin dhe mbeteshin si mbeturina të të kaluarës kapitaliste. Megjithëse në praktikë ekzistonin ndryshime të rëndësishme në trajtimin nga autoritetet, një minoritar nën regjimin e Hoxhës kishte një ndjenjë të përbashkët me shumicën, atë të "sigurisë për të nësërmen". Jeta e romëve nën regjimin komunist, edhe pse e varfër dhe jo e lirë, çmohej me të njëjtat garanci minimale të punësimit, edukimit, kujdesit shëndetësor, strehimit dhe shërbimeve komunale. Fundi i komunizmit, për romët si edhe grupe më të gjera njerëzish që po dilnin nga tërmeti i "revolucionit" shqiptar të 1991-it, do të thoshte jo lindja e demokracisë por humbja e sigurisë. Trauma e kësaj humbjeje duket se sundon mbi çdo vlerësim të të drejtave dhe lirive të fituara: tipik për mentalitetin post-komunist, ky qendrim është madje më i fortë midis romëve, dhe kjo është e kuptueshme nën versionin e cunguar të "demokracisë" shqiptare. Shumica e romëve me të cilët ERRC (Qendra Europiane për të Drejtat e Romëve) bisedoi në 1996-ën, u shprehën se jeta e tyre ishte më e mirë përpara 1991-it.¹² Në Shqipëri është edhe një grup tjetër, fati i të cilit është i lidhur ngushtë me atë të romëve dhe që do të ishte e pamundur të mos përmendej këtu. Këta janë jevgjit.¹³ Një debat i fortë zhvillohet reth faktit, nëse jevgjit janë një minoritet i veçantë, apo romë të asimiluar.

Jevgjit shikohen në mënyra të ndryshme si pasardhës të migrantëve Koptikë (Coptic) të cilët erdhën nga Egjipti në Shqipëri në shekullin e katërt, si turq të kamufluar; ose si romë "jo-nomadë" të asimiluar. Disa aktivistë romë pretendojnë që ishte Enver Hoxha ai që "shpiku" këtë kategori. Në një artikull të saj të 1938-s në *Journal of the Gypsy Lore Society*, Margaret Hasluk përmend disa nëngrupime të ndryshme, por vetëm një minoritet të madh jevg, të ndarë në "vendalinj" dhe "nomadë" (romë).¹⁴

Hugh Poulton, i cili vrojtoi shfaqjen e një minoriteti egjiptian në Maqedoni, me një mit identik të origjinës, jep shpjegimin e mëposhtëm:

Duke marrë në konsideratë problemet që romët kanë dhe pasigurinë etnike të shumë qytetarëve myslimanë (që ka mbetur nga koha e perandorisë otomanë kur diferencimi bëhej më shumë mbi bazën e besimit se të etnise) veçanërisht në zonat e dominuara nga shqiptarë myslimanë nacionalistë dhe të mirë organizuar, ndoshta nuk është surprizë që kohe pas kohe shfaqen pretendime nacionalistë të pazakonta. Në 1990-en në Maqedoni u krijua shoqata e qytetarëve "Egipcian" të Ohrit nga afërsisht 4.000 banorë të Ohrit dhe Strugës fqinje, nën udhëheqjen e Nazim Arifi-t, i cili hoqi dorë të jetë rom në favor të të qenit egjiptian. Një shoqatë simotër u themelua pas pak kohe në Kosovë dhe pretendonte të kishte 100.000 "pasardhës të Faraonëve" në Kosovë dhe 20-30.000 në Maqedoni. Ata i dërguan një peticion Asamblesë federale dhe kuvendeve kombëtare të Serbisë dhe Maqedonisë që të fusnin një kategori të veçantë për "egjiptianët" në regjistrimin e popullsisë të vitit 1991. Kjo u fut në regjistrimin maqedonas të 1991-it, por ky fenomen (për të evituar kompleksin e të qenit arixhinj) nuk është përhapur shumë dhe nuk duket se do të përhapet, përveç zbulimit të fundit të dokumenteve në librarinë e Vatikanit të cilat sikur po tregojnë që egjiptianët erdhën në Maqedoni midis viteve 306 dhe 327 pas Krishtit në formën e 150.000 ushtarëve dhe 150.000 kalorësve.¹⁵

Është bërë një orvatje për të trajtuar identitetin e jevgjëve, sikundër Poulton shikon maqedonasit "Egypciani": një ideologji e kultivuar nga një minoritet si kundërpërgjigje ndaj persekutimit dhe përbuzjes që lidhet me identitetin nacional të individit.¹⁶ Nga ana tjetër, duhet bërë kujdes kur zhvlerësohet pohimi i një personi apo grupi njerëzish rreth vetvetes. Sikundër një vrojtues i njohur ka vërejtur,

Unë mora pjesë në një konferencë mbi minoritetet në Jugosllavi në fillim të viteve 90' dhe aty ishin edhe tre njerëz nga Shoqata e Egjiptianëve. Reagimet ndaj këtyre njerëzve ishin absolutisht të pabesueshme: as edhe një person i vetëm nuk i trajtoi ata seriozisht dhe nuk e pranoi që ata mundet, me të vërtetë, të ishin egjiptianë.¹⁷

¹¹ Hall, cituar me sipër, pp. 58-59.

¹² Eshte veshtire te thuhet nese situata social ekonomike e romeve eshte permiresuar apo keqesuar pas 1991, dhe akoma me e veshtire te vleresosh ndryshimet ne statusin e te 'drejtave te njeriut' te tyre. Departamenti i Shtetit te Shteteve te Bashkuara i pershkruan ndryshimet si pozitive, se paku nga kendveshtrimi i te drejtave baze. Romet ishin veçanerisht subjekt i nje persekutimi te dhunshem zyrtargjate diktatures komuniste. Udeheqesit e tyre pohuan se gjendja e komunitetit u permiresua ndjeshem me ardhjen e qeverise demokratike. Ata nuk kishin ankese as per diskriminim zyrtar, as shoqeror. Komuniteti botoi nje gazete te permuajshme ne gjuhen shqipe dhe rome. Nuk ka raportime dhune te drejtuara kunder romeve, edhe pse ata trajtohen me perbuzje nga shqiptaret etnike."Shiko U.S. Department of State, *Country Reports on Human Rights Practices for 1995*, Washington: U.S. Government Printing Office, April 1996, p.758.

¹³ Shumesi i trajtes se shquar: nje jevg; dy jevgi, jevgjit.

¹⁴ Shiko Hasluk, Margaret, "The gypsies of Albania"[Jevgjit e Shqiperise], *The Journal of the Gypsy Lore Society*, Vol. 17, No. 2, April 1938, pp. 49-61.

¹⁵ Poulton, Hugh, *Who are the Macedonians?* [Kush jane Maqedonasit ?], London: C. Hurst and Co, 1995, pp. 141-142.

¹⁶ Megjithate konkluzioni i Poulton se kjo ka te beje me " pasigurine etnike te shume qytetarëve myslimaneve "nuk vlen per Shqiperine.

¹⁷ *European Roma Right Center* interviste me Stefan Myller , 12 Prill, 1997, Vienna.

Pikëpamja që romët dhe jevgjit janë, në të vërtetë, dy grupe të ndryshme - si dhe arsyeja e konfuzionit- trajtohet nga Marcel Cortiade dhe Pëllumb Fortuna i organizatës së romëve shqiptarë *Rromani Baxt* në një letër të botuar në gazetën në *Le Monde* më 2 Janar 1997:

Minoriteti i jevgjeve [...] Nuk ka lidhje me arixinjtë (romët) ngaqë ata ne te gjitha aspektet janë pasardhës të Koptëve (Copts) të cilët janë vendosur prej shekujsh në Ballkan. Romët kanë origjinë indianë. Njerëzit injorantë në Shqipëri shikojnë ngjyrën e lëkurës por ata nuk janë në gjendje të dallojnë kujt origjinë i përket ajo ngjyrë. Ata nuk mund të kuptojnë që evgjitet ose jevgjit, edhe pse kanë lëkurë të zezë si ne, përbëjnë një grup etnik plotësisht të ndryshëm dhe vetëm flasin gjuhën e adoptuar të vendit të tyre . Ata e konsiderojnë vetveten superiore ndaj arixinjve [...] Evgjitet akoma ruajnë dy fjalë të gjuhës koptike " Aspi chochi" që do të thotë " Mbylle gojën (është për një) spiun." ¹⁸

Romët dhe jevgjit që folën me ERRC tentonin të shikonin ngjashmëri dhe, në të njëjtën kohë , të përcaktonin ndryshime të rëndësishme midis të dy grupeve. Disa jevgj, për shembull, i treguan ERRC që romët nuk ishin të interesuar të jetonin normalisht si shqiptarët dhe për rrjedhojë ishin inferiorë. Një jevgj i tregoi ERRC:

Ne jemi njësoj me romët, por në flasim shqip. Por në nuk jemi si romët kur është fjala për shkollimin. Romët nuk i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë, ndërsa neve po. Ne duam që fëmijët tanë të marrin edukimin e duhur, ndërsa romët as që e çajnë kokën për gjëra të tilla. Shumë jevgj janë mjekë dhe inxhinierë. Ne kemi një shok jevgj i cili është mjek dhe është martuar me një të bardhë. Për më tepër, në nuk e përdorim fjalën "jevgit". Ne e konsiderojmë vetveten genie humanë.¹⁹

Ndërkohë, disa romë i konsiderojnë jevgjit inferiorë sepse ata "kanë humbur kulturën e tyre". Demir X., Një udhëheqës i romëve në Korçë, u tregoi grupit *Projekti për të Drejtat e Njeriut* [Human Right Project]:

Ne jemi romët dhe ata janë jevgjit; ata nuk janë romët. Ka milionerë në mes tyre. Ata nuk kanë gjuhë. Ata kanë martesë të përziera. Ata nuk e vështrojnë traditën.²⁰

Megjithatë, disa romë pretendojnë të kenë te aferm të cilët e quajnë veten "jevgj", kështu që identiteti duket se funksionon si një pikë konvergimi për asimilimin, i cili mund ti tërheqë drejt tij.

Linja romë / jevgj, pamvarësisht nga origjina etnike e grupeve të tyre, shfaq të gjithë tensionët tipike që lindin midis minoriteteve të asimiluara dhe të paasimiluara; megjithëse të dy grupet janë të përjashtuara nga rrjedha kryesore e shoqërisë, ato harxhojnë shumë energji "për të kultivuar egoizmin e një diference të vogël" (Freud). Së fundi, si romët edhe jevgjit jetojnë përtej kontekstut të ngjyrës në Shqipëri dhe konsiderohen të ngjashëm nga shumica. Sipas sociologut shqiptar Kimet Fetahu, "Romët dhe jevgjit janë shumë të nënvlefësuar. Ata bëjnë punët fizike më të rëndomta dhe më të pista."²¹

Ky raport është rezultat i një punë të gjatë 11 muajsh (Korrik 1996 - Maj 1997), të kryer nga ERRC, e cila përfshin dy misionë në Shqipëri, në Korrik dhe Dhjetor 1996. Ky është studimi i parë i thelluar i situatës se të drejtave të njeriut të romëve në Shqipëri. Për shkak të konfuzionit shumë të përhapur në lidhje me statusin e ndarjes etnike midis romëve dhe jevgjeve, si edhe të faktit që stereotipe tipike për romët aplikohen për të dy minoritetet, ERRC ka zgjedhur ti konsiderojë romët dhe jevgjit, për qëllimet e këtij studimi, si një minoritet të ndarë në komponëntin e asimiluar dhe të paasimiluar. Kjo ndarje nuk duhet parë as si një pozicionim në lidhje me vendin (et) përkatës të origjinës të sejcilit grup, dhe as si një koment mbi kulturën(at) e jevgjevë dhe romëve. Sidoqoftë, të marrë së bashku, romët dhe jevgjit përfaqësojnë "minoritetin arixhi" tipik për shoqëritë e tjera të Evropës lindore dhe të Ballkanit. Do të ishte e pamundur të krijohet një tablo të plotë të dinamikës së qëndrimeve të shqiptarëve përkundrejt minoriteteve inferiore pa u kushtuar vëmendjen e duhur këtyre dy grupeve.

Në fillim të 1997-ës, shoqëria shqiptare u pushtua nga nje krize e thelle ekonomike e sociale. Zhgënjimi i thellë në lidhje me korrupsionin në rritje, shtypjen dhe nepotizmi, të cilat shikohen si shkaktarë të degradimit të revolucionit demokratik shqiptar, shkaktuan revoltën menjëherë pas kolapsit të të ashtuquajturave skema investuese "piramidale". Me humbjen e të gjitha kursimeve, marreveshja e heshtur midis popullit dhe qeverise qe "kompensonte" me keto para shkeljet dhe formen e

¹⁸ Leter nga Pellumb Fortuna dhe Marcel Cortiade, *Rromani Baxt Albania* ne *Le Monde*, 2 Janar, 1997, e papublikuar.

¹⁹ Interviste e ERRC me Ali Sadiku-n, Dhjetor 9, 1996, Korçë.

²⁰ *Human Rights Project*, interviste me Demir X., Shkurt 2, 1996, Korçë.

²¹ *Human Rights Project*; interviste me Kimet Fetahu-n, 5 shkurt 1996, Tirana. Sipas Elizabeth and Jean-Paul Champseix (te cilët i quajne te dy grupet arixinj), jevgjit jane me pak te integruar se romet ne Shqiperi: "Shqiptaret bejne dallimin midis gabeleve dhe jevgjeve, i cili mund te nenkuptoje "egjiptiane". Te paret, qe kane mundur te ruajne gjuhen e tyre dhe strukturen sociale, jane relativisht te integruar. Grupi i dyte konsiderohet me i keqi dhe sipas nje zakoni, gjaku i tyre prej arixhiu eshte perzier me gjakun e sklleverve afrikane te bejlereve otomane. Perqindja e kriminalitetit eshte shume e larte ne kete grup.[...] Shume shqiptare qe i quajne arixinjte "te zinjte", i akuzojne ata se po e cojne shoqerine ne regres. Ata (arixinjte) konsiderohen si te paasimilueshem, dhe lindshmeria e larte e tyre i frikeson [shqiptaret]. [...] Ne nje menyre te papritur, Enver Hoxha denoi vuajtjet e tyre (arixinjve) per shkak te inferioritetit dhe kontribuoi ne permesimin e imazhit te tyre. Ne vepren e tij *Vite te femijerise, Dhurate per Gjirokastrin*, Hoxha kujtonte me ngrohtesi te cuditshme se e jema e tij, e cila nuk kishte qumesht te mjaftueshem, theriti nje arixheshke ti jape gjj atij." Shiko Champseix, Elisabeth and Jean-Paul, *L'Albanie ou la logique de desespoir*, Paris: editions la Decouverte, 1992, p.136.

saj autoritare u prish, dhe vendi filloi te zhytej drejt anarkise. Rendi dhe ligji u shkatëruan në përgjithësi. Kushtet ekstreme të tanishme kanë keqësuar më tej situatën e pasigurt të romëve në Shqipëri. Sipas informacionit që i është ofruar ERRC nga organizata joqeveritare lokale, që nga fillimi i këtij viti ka ndodhur të paktën një akt vandal serioz në një komunitet rom; në bazë të Grupit shqiptar për të drejtat e njeriut (*Albanian Human Rights Group*) 18 persona (shumica e tyre jo-romë) u vranë në komunitetin rom të Levanit më 26 mars 1997. Akoma nuk është e qartë në ç'përmasa motivet raciale kanë influencuar në këtë akt violent, për më tepër, sic tregohet në këtë raport, ka patur një rast konflikti etnik në komunitetin e Levanit i cili është i dokumentuar nga ERRC. Shqipëria është "vendi më i varfër i Evropës", sikundër agjencive perëndimore të lajmeve ju pëlqente ta quanin atë gjatë trazirave që filluan në fillim të 1997-es. Sidoqoftë, shumë shqiptarë besojnë që romët kanë përfitur nga ndryshimet shoqërore pas përmbyesjes së komunizmit në Shqipëri në 1991-in. Shkurt, si kudo në Ballkan, edhe në Shqipëri ekziston një bindje popullore që "romët janë të pasur."²² Ky opinion ekziston edhe mes shumë nëpunësve publikë. Për shembull, kryetari i bashkisë të Fushë-Krujës, një qytet që gjendet 25 km në veri të Tiranës, i tha ERRC:

Në periudhën e katër viteve të fundit të demokracisë, romët kanë ndërtuar shtëpitë e tyre. Ata jetojnë në kushte shumë të mira. Romët jetojnë në kushte më të mira se mesatarja e shqiptarëve në Fushë-Krujë. Dhe romët kanë hequr dorë nga hedhja e fallit; sot ata merren me tregëtinë me pakicë të mallërave elektronike, veshjeve dhe ushqimeve. Jeta e romëve me të vërtetë ka ndryshuar shumë.²³

Bindja se romët janë të pasur u përforcua më shumë gjatë valës së kolapsit të firmave piramidale e cila nisi rrëmujën e madhe në fillim të 1997-ës. Një nga firmat e para që falimentoi ishte skema e Sudes, e cila filloi të rënohej në fund të 1996-ës. Kjo firmë drejtohej nga një femër me origjinë jevge e quajtur Maksude Kademi ose "Sude jevga". Pas premtimit për t'ju kthyer kapitalet investitorëve për disa javë, Sudja u arrestua bashkë me 18 bashkëpunëtorët e saj më të ngushtë më 15 janar 1997. Sipas Marcel Cortiade i *Rromani Baxt*, pasqyrimi në media i skandalit të Sudes "i paraqiste romët si pasanikët e rinj, pavarësisht nga fakti që shumica e tyre jetojnë në kushte mizerabël dhe çnjerëzore." Si rezultat, sipas Cortiade, kriza e tanishme pa dyshim do të shkaktojë një numër të konsiderueshëm episodesh violence ndaj romëve të Shqipërisë.²⁴

Romët e pasur, të vërtetë apo imagjinare, përbëjnë një fyerje për gjendjen e papëlqyer të shqiptarëve. Romët mund të akuzohen lehtë nga jo-romët për akte violente dhe grabitje, meqënëse kjo korrigjon opinionin e përhapur që kjo ishte një lajthitje, dhe njëkohësisht, është një metodë e menjëhershme për perhapjen e asaj që shumë shqiptarë e konsiderojnë si përfitim të pandershëm.

Historia e romëve të pasur, ashtu siç ndodh shpesh në universin e paqëndrueshëm të opinionit publik, bashkëekziston me pranimin e faktit që romët, natyrisht, janë të varfër. Të dy përgjithësimet, qofshin ato rreth varfërisë apo pasurisë, presupozojnë që "romët janë ndryshe nga ne", "të tjerë", jo te njëjta me shqiptarët.

Shqiptarët kanë vuajtur shumë në historinë e tyre dhe, si rezultat, ka shumë zemerim dhe agresion të brendshëm, i cili shpesh bie mbi "të tjerët". Studimet sociologjike të fundit tregojnë që shqiptarët etnikë shfaqin ndjenja të forta mospelqimi ndaj arumunëve (të njohur gjithashtu si "vllahë"), grekëve, çifutëve, dhe në mënyrën më të dukshme, romëve. Në antipatinë e tyre ndaj romëve, shqiptarët qëndrojnë më lart se maqedonasit, bullgarët, dhe grekët. Në çdo katër shqiptarë ka të ngjarë që tre prej tyre të shprehin antipati ndaj romëve, dhe më pak se 10% pretendojnë të kenë simpati për ta.²⁵

Antipatia ndaj romëve ka rrënjë historike. Në 1938ën, Margaret Haskuck ka shkruar në *the Journal of the Gypsy Lore Society*:

Duhet të jetë e qartë tashmë që shqiptarët i urrejnë të gjithë arixinjtë [...] "Me nder, po vijmë arixinjtë," u shpreh një mik gjatë një martese në një fshat të Dumresë. "Me nder, si një mëhallë jevgjish," tha një amvisë Tiranase për një fshat të mbajtur keq. "A duhet prituri ndonjë gjë prej arixinjtëve?" Pyeti një diبران. Një frikacak përshkruhet si të jetë "një arixhi në shtatë breza." Një shprehje që përdoret për plakat nomade është "Të hangërt i pjekmi (d.m.th. djalli) zembrën". Vrasja e një arixhiu nuk është theksuar ndonjëherë: dikush mund të vriste njësoj një grua; pas një krimi të tillë të shëmtuar, pamvarësisht nga shkalla e provokimit, asnjë shqiptar nga Luma nuk do të të thoshte "Si ja con?"²⁶

Ndërsa normat se kush ka të drejtë të vrasë janë dobësuar disi qysh nga 1938, ndjenjat popullore ndaj romëve kanë mbijetuar të pandryshuara në rrugën unike të shqiptarëve drejt modernizmit; romët jetojnë të mbërthyer në shkallën e fundit sociale.

²² shiko Champseix, cituar me pare, p. 135.

²³ European Roma Rights Center (ERRC), interviste me Kryetarin e Bashkisë Monder Salaku, 18 Korrik 1996, Fushe- Kruje.

²⁴ Cortiade, Marcel, "Schutz für die Roma Albanies: offener brief an das Europarlament" [Mbrojtje per romet e Shqiperise: leter e hapur drejtuar Parlamentit Europian], *Romano Lil*, March, 1997, p. 3.

²⁵ Shiko Kanev, Krasmir, " Dynamics of Inter-Ethnic Tensions in Bulgaria and the Balkans" [Dinamika e tensioneve nder-etnike ne Bullgari dhe Ballkan]. *The Balkan Forum* (Skopje), Vol. 4, No.2 (15), June 1996. Vetem rumunet shprehin nje qendrim anti-rom me te forte se shqiptaret.

²⁶ Hasluc, Margaret, "The Gypsies of Albania, Part III" [Arixinjte e Shqiperise, pjesa III], *Journal of the Gypsy Lore Society*, Vol.XVII, No.4, 1938, p.110. Shiko shtojcën 2 për me shume detaje.

ERRC është e shqetësuar se dhuna raciale, si edhe dhuna në përgjithësi, ngelen në një shkallë të gjerë të padenuara. Gjendja e papërcaktuar e sundimit të ligjit dhe rregullit në Shqipëri është rënduar nga mungesa e një kushtetutë, dhe gjendja ekzistuese e marrëdhënieve që prej kushtetutës së 1976 u rishikua vetëm më 1991.

Në 1993, u adoptua një paketë ligjesh që garantojnë të drejtat themelore civile dhe politike. Në të janë përfshirë edhe disa parime të tjera bazë që përmbaheshin në paketën e ligjeve kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, të cilat kanë hyrë në fuqi qysh në prill 1991. Megjithëse ligji kushtetues kërkonte miratimin nga dy të tretat e parlamentit për tu aprovuar, presidenti Berisha ju shmang procedurës duke nxjerrë një dekret në të cilin kërkohej mbajtja e një referendumi popullor në favor të versionit të tij të projekt kushtetutës. Në atë kohë Berisha vuajti humbjen dramatike të refuzimit të draftit të tij nga votuesit në nëntor 1994. Akoma sot e kësaj dite, vazhdon të mungojë kontrolli kushtetues mbi pushtetin. Presidenti Berisha ka vazhduar të udhëheqë nëpërmjet dekreteve dhe parlamenti duke mos qenë transparent ka favorizuar abuzimet.²⁷

Sidoqoftë, problemi kryesor nuk është mungesa e kushtetutës, por mosrespektimi i plotë i ligjit nga qeveria. Garancitë për të drejtat e njeriut ekzistojnë në letër, por nuk respektohen. Organizatat për të drejtat e njeriut kanë kritikuar manipulimet politike në gjykata, korrupsionin, dhe dhunimin e të drejtave të njeriut nga zyrtarët që zbatojnë ligjin.

Shqipëria ka dalë nga një sistem represiv dhe akoma nuk ka instaluar institucionet dhe praktikat demokratike, sundimin e ligjit ose respektin për të drejtat e njeriut. Në fakt situata e të drejtave të njeriut është keqësuar ndjeshëm qëkur Sali Berisha erdhi në pushtet më 1992. Të gjithë qytetarët shqiptarë, pavarësisht nga etniciteti, kanë qenë subjekt i dhunimit të të drejtave të njeriut, të të njejtit lloj me ato që përshkruhen në këtë raport për romët. Korrupsioni, përjashtimet, abuzimi policor dhe manipulimet e jashtëligjshme politike janë një problem i zakonshëm. Është e rëndësishme të kihet parasysh gjata leximit të këtij raporti, se në një shoqëri me një demokraci të konsoliduar si Shqipëria, të gjithë qytetarët vuajnë nga dhunimi i të drejtave të njeriut. Megjithatë, minoritetet janë veçanërisht të prekura nga abuzimet.

Ky raport eksploron aspekte të ndryshme të situatës së të drejtave të njeriut të romëve shqiptarë. Para së gjithash, romët trajtohen me prioritet nga policët, të cilët i arrestojnë ata arbitrarisht dhe ju marrin para nëpërmjet gjobave të mëdha, shpesh duke abuzuar fizikisht me romët dhe jevgjit gjatë kohës që ata janë të ndaluar. Abuzimet ekstreme kanë shkaktuar vdekje në dy raste të shqyrtuara nga ERRC. Së dyti, qytetarët shqiptarë jo romë shfrytëzojnë dobësinë e romëve shqiptarë duke i përzënë ata nga shtëpitë e tyre, rrëmbyer femra të reja romë për prostitucion, ose thjesht duke i sulmuar ata në rrugë për para. Së treti, romët - në fund të shoqërisë shqiptare - nuk janë në gjendje të mbrojnë vetveten nga diskriminimet e autoriteteve vendase dhe ambasadave të huaja ku ata kërkojnë viza. Për më tepër, ERRC dokumentoi raste të mohimit të të drejtave politike të romëve, veçanërisht në Shqipërinë e Jugut, ku romët janë vënë nën presion për të mos u bashkuar me partinë politike të minoritetit grek. Qendra Europiane e të Drejtave të Romëve (ERRC) e mbyll raportin e saj mbi romët e Shqipërisë me një seri rekomandimesh që synojnë të përmirësojnë situatën e të drejtave ligjore të romëve në Shqipërisë.

²⁷ Shiko Rekosh, Edvin, ed., *In the Public Eye: Parliamentary Transparency in Europe and North America* [Ne syte e publikut: transparencja parlamentare në Europë dhe Amerikën e Veriut], Washington D.C.: International Human Rights Law Group, 1995, p.11

2. NJE KRIM I URRYER: VRASJA E FATMIR HAXHIUT

Një i ri rom 17 vjeçar u lye me benzinë dhe u dogj nga katër të rinj shqiptarë etnikë në Tiranë më 17 Korrik 1996. Mbas sulmit, 55% e trupit të tij kishte djegie të gradës së tretë. Ai vdiq shumë shpejt si rezultat i plagëve.

Sips dëshmisë që Fatmir Haxhiu i dha ERRC para vdekjes, rreth orës 6 të mbasdites të dates 17 Korrik, ai, vëllai i tij 13 vjeçar Lulëzim Haxhiu dhe shoku i tyre Flamur Hida shkuan të takojnë një shok për të parë një motoçiklete të cilën mund ta blinin. Fatmiri ishte duke mbajtur një pagure plastike 1 litër e gjysëm të mbushur me benzinë dhe 2000lekë (afërsisht 22 US\$ në atë kohë). Fatmiri i tregoi ERRC:

Në një rrugë të ngushtë pranë stacionit të trenit, një kamion na zuri rrugën. Sapo ndaloj, unë e kuptova që do kishim probleme. Unë u frikësova dhe flaka tutje kuletën si dhe shishen e benzinës. Tre të rinj shqiptarë të armatosur me hanxharë mishi dhe kosa këcyen nga makina dhe na kërkuan para.²⁸

Lulëzim Haxhiu u tha përfaqësuesve të ERRC se djemtë i quajtën ata arixhinj dhe ju kërkuan para:

Kur ju thamë që s'kishim asnjë lek, ata na thanë që po gënjenim. Ata gjithashtu kërkonin të dinin nëse në kishim punuar në Turqi apo Greqi kohët e fundit²⁹.

Të rinjtë e detyruan Fatmirin dhe dy djemtë e tjerë të hypin në karrocerinë e furgonit. Ndërsa po i jepnin makinës, të rinjtë ushtruan dhunë mbi tre romët. Pastaj të rinjtë ndaluan furgonin dhe i detyruan të dilnin prej tij. Ata ishin në një fushë të shkretë. Lulëzimi i tregoi ERRC:

Dy prej të rinjve më mbanin mua dhe Flamurin me anën e armëve kështu që në nuk mund të lëviznim. Nga një distancë e afërt në mundëm të shohim të riun e tretë që po kërcënonte Fatmirin. Ai i vuri Fatmirit kosën në fytyrë dhe i tha, "më jep paratë." Fatmiri i tha atij që në nuk kishim asnjë lek, gjë që ishte e vërtetë, meqenëse Fatmiri e kishte hedhur tutje kuletën kur pamë që furgoni ndaloj.³⁰

I riu donte rrobat e Fatmirit. Ai e detyroi Fatmirin ti zhvishte ato dhe ti ndërronte me ato të tij:

Ai më shau mua disa herë dhe më quajti "arixhi i qelbur" (gabel).³¹ Pastaj ai më detyroi të heq pantallonat dhe këmbishën. Ata bënë të njëjtën gjë me Lulëzimin dhe Flamurin, por ata vetëm sa do hiqnin këmbishat. Pastaj ata veshën rrobat tona.³²

Një makinë tjetër arriti mbas pak kohë dhe një i katërt u bashkua me grupin e sulmuesve, duke sjellë me vetë shishen e benzinës që djemtë e kishin flakur tutje. Kur ata zbuluan që shishja kishte benzinë, të rinjtë filluan të akuzojnë djemtë se kishin ndërmend tu vinin zjarrin shtëpive të qytetit. Ata përsëri e quajtën Fatmirin "arixhi i qelbur" dhe e akuzuan atë se donte të vidhte. Pasi i rrahen dhe i kërcënuan se do ti qëllonin me një armë të cilën ata pretendonin se e kishin në makinë, njëri prej të rinjve derdhi benzinë mbi kokën e Fatmirit ndërsa një tjetër i vuri zjarrin. Të katër të rinjtë u zhdukën me të katra. Fatmiri vazhdoi të digej për disa minuta derisa ai dhe dy djemtë e tjerë mundën të shuajnë flakën. Një kalimtar i rastit i solli të tre djemtë në spital. Fatmiri vdiq si pasojë e plagëve në orën 4 të mëngjesit të datës 21 korrik, 1996.

ERRC i dërgoi një letër në të cilën shprehte shqetësimet e saj, Prokurorit të Përgjithshëm të Shqipërisë, duke i sugjeruar atij të niste hetimet e plota dhe të paanshme rreth vdekjes së Fatmir Haxhiut. Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm u përgjigj me letren e 2 Shtatorit 1996, në të cilën thuhej se hetimet ishin në proces dhe njëri prej kriminelëve, Zoti F. C. Ishte arrestuar.³³

Zoti Nuhi Koldashi i zyrës së Prokurorisë të Rrethit të Tiranës, hetuesi i ngarkuar për këtë çështje, në Tetor 1996 deklaroi se zoti F. C. Fillimisht ishte akuzuar për akt të rëndë me paramendim në bashkëpunim me persona të tjerë sipas Nenit 88, paragrafi 1 dhe Nenit 25 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, por meqë dëmtimi kishte çuar në vdekjen e viktimës, akuzat ishte modifikuar në akt të rëndë me paramendim që shkakton vdekje, sipas nenit 88, paragrafi 2, të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.³⁴ Sipas Zotit Koldashi, Zoti F. C. Ndodhej në paraburgim, por meqë ai refuzoi të tregojë emrat e tre të tjerëve të përfshirë në këtë akt, ata ishin akoma të lirë.

²⁸ *European Roma Rights Center*, interviste me Fatmir Haxhiun, 19 Korrik 1996, Tirana.

²⁹ *European Roma Rights Center*, interviste me Lulezim Haxhiun, 19 Korrik 1996, Tirana.

³⁰ *European Roma Rights Center*, interviste me Lulezim Haxhiun, 19 Korrik 1996, Tirana

³¹ Shqiptaret shpesh fjalën "jevçji" e perkthejne "arixhi", meqenese ata jane te nje gjaku. Dy terma tipike nenvlestesus per romet ne Shqiperi jane "arixhi" (qe do te thote "shites arinjsh", "ari" nga shqipja dhe " agjent (shites) " nga turqishtja) dhe "gabel".

³² *European Roma Rights Center*, interviste me Fatmir Haxhiun, 19 Korrik 1996, Tirana.

³³ Leter drejtuar Prokurorit te Pergjithshem te Shqiperise Alush Dragoshi, me daten 2 Shtator 1996. ERRC e ruan emrin e kriminelit te arrestuar.

³⁴ Interviste e kryer ne emer te ERRC nga zoti Artan Puto me Zotin Nuhi Koldashi, hetues ne zyren e Prokurorise te Rrethit te Tiranes, 3 Tetor 1996, Tirane. Artikulli 88, paragrafi 1, i Kodit Penal parashikon nje denim maksimal prej 10 vjetesh burgim, ndersa paragrafi 2 lejon nje denim maksimal deri ne 15 vjet burg.

Gjatë kerkimeve në terren në Shqipëri në Dhjetor të 1996-es, ERRC beri përpjekje për të sqaruar statusin ligjor të këtij rasti, por nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm në Tiranë ju tha që vetëm pyetjet me shkrim mund të merreshin në konsideratë.³⁵ Kohët e fundit ERRC i dërgoi një letër zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, në të cilën kërkohet të informohet rreth statusit ligjor të rastit të Fatmir Haxhiut. Akoma nuk është marrë përgjigje për këtë letër.

Fatmir Haxhiu ishte viktimë e një krimi të urreyer e të eger në të cilin u shpreh nëveria e fortë e shqiptarëve ndaj romëve. Sidoqoftë, drejtësia shqiptare duket që nuk e konsideron rastin si të tillë. Sipas hetuesit Koldashi, sulmi ndaj Fatmir Haxhiut ishte "një zënkë midis adoleshentëve" dhe një "vjedhje klasike".³⁶ ERRC nuk e konsideron këtë sulm as si "klasik" dhe as si "zënkë mes adoleshentëve", por si një rast ekstrem të dhunes raciale mbi romet në shoqërinë shqiptarë.

³⁵ *European Roma Rights Center* interviste me drejtorin Edison Heba dhe specialistin Robert Kote të studimeve për drejtësinë të zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe seksionit të marrëdhënieve me jashtë, Dhjetor, 1996, Tirana.

³⁶ Interviste e kryer në emer të ERRC nga zoti Artan Puto me Zotin Nuhi Koldashi, hetues në zyrën e Prokurorisë të Rrethit të Tiranës, 3 Tetor 1996, Tirane.

3. ABUZIMI POLICOR NDAJ ROMËVE NË SHQIPËRI

Në Shqipëri, në rastet kur romët kanë qenë viktime të keqtrajtimit fizike ose krimeve të tjera, përgjithësisht ata nuk shkojnë në polici, tek "ruajtesit" e rendit publik. Kjo ndodh ngaqë, policia shqiptare në vetvetë, është në një shkallë të konsiderueshme, një problem i të drejtave të njeriut.³⁷

Organizatrat për të drejtat e njeriut si Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut, *Amnesty International*, *Human Rights Watch* dhe Federata Ndërkombëtare e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, kanë kritikuar vazhdimisht qeverinë shqiptare që nuk kontrollon abuzimin policor në përgjithësi. ERRC ka konstatuar se romët kanë qenë më të prekur nga keqtrajtimet policore se jo-romët. Me këtë ERRC nënkupton që (i) ndërsa të gjithë qytetarët shqiptarë janë të prekur nga brutaliteti policor, një rom mund të bëhet më lehtë viktimë e policisë se një jo-rom: është vrotuar që inspektimet policore në komunitetet romë si dhe pasojat e tyre janë ngjarje shumë të parashikueshme, ndërsa për jo-romët procesi është më arbitrar dhe më pak i rregullt; (ii) të njëjtat forma tipike të keqtrajtimit policor në Shqipëri janë më të rënda për romët se për të tjerët: p.sh. Romët duhet të paguajnë më shumë për tu liruar kur arrestohen arbitrarisht, dhe rrihen më rëndë gjatë mbajtjes nën arrest; (iii) romët raportojnë disa forma të brutalitetit policor të cilat nuk janë raportuar për popullatën në përgjithësi, si p.sh. Inspektime masive të shtëpive në të gjithë zonën përreth, dhe arrestimi i pjesëtarëve të familjes të të dyshuarve.

Romët në një numër komunitetesh të vizituara nga ERRC raportuan provokime, rrëmbime dhe arrestime të paligjshme nga policia. Një skenar i zakonshëm i përshkruar nga viktimat dhe dëshmitarë të abuzimeve policore është që grupe policore lokale hyjnë rregullisht në vendbanimet romë, dhe pa lajmëruar banorët se çfarë kanë bërë kundër ligjit, i detyrojnë të paguajnë në shkëmbim të mos marrjes në rajonin e policisë. Në të kundërt, ata merren në rajonin e policisë-- në realitet, edhe pse jo ligjrisht, duke i futur nën arrest ku ata duhet të paguajnë mirë për tu liruar. Këto akte ndalimi shpesh shoqërohen me violencë fizike, gjatë arrestimit ose më vonë në paraburgim.

ERRC ka dokumentuar gjithashtu forma më të stërholluara të abuzimit policor kundër romëve, si p.sh. Ndalimi i anëtarëve të familjes të të dyshuarit kur policia nuk mund ta gjeje atë. Dy raste të tilla të arrestimit të paligjshëm janë përshkruar më poshtë. Në njërin rast, tre persona u morën nga shtëpitë e tyre në Fier dhe u sollën në qytetin bregdetar të Durrësit, ku u mbajtën nën arrest për një periudhë më të gjatë se një vit, për arsyen e vetme që familjet e tyre kishin lidhje me një burrë të akuzuar për kryerjen e një krimi. Në rastin e dytë, dy anëtarë të familjes së një personi i cili akuzohet për vjedhje, u arrestuan në shtëpinë e tyre në fshatin Levan, afërsisht 10 km në jug të Fierit, dhe u mbajtën nën arrest në Fier për tre muaj pa u fajësuar. Në të dy rastet, madje edhe kur i dyshuari i vërtetë ishte arrestuar, personat e marrë peng nga policia vazhdonin të mbeteshin nën arrest.

Përveç provokimeve, rrahjeve dhe arrestimeve të paligjshme, ERRC ka dokumentuar edhe dy raste të vrasjeve nga policia të romëve dhe jevgëve në Shqipëri. Në Korrik 1992, një jevg 32 vjeçar i quajtur Seran Sadiku u rrah derisa vdiq dhe pastaj vëllai i tij 21 vjeçar Gazmir Sadiku u keqtrajtoi seriozisht nga policët në Korçë në Juglindje të Shqipërisë. Edhe sot e kësaj dite, policët që kanë abuzuar nuk janë arrestuar, aq më pak që të jene gjykuar apo dënuar nga organet e drejtësisë. Në Shkurt 1994, një polic jashtë orarit të shërbimit në lirim qëlloi me armë duke i shkakuar vdekjen një 22 vjeçar rom të quajtur Agim Shatipi në lagjen romë të Zinxhirajve në periferi të Gjirokastrës, në Jug të Shqipërisë. Vrasësi ngelet një oficer policie.

3.1. RRAHJET, PERVETESIMET E PARAVE DHE ARRESTIME TË PALIGJSHME

Besimi që romët janë të pasur bën që ata të vihen lehtë në shënjestër të oficerëve të policisë të cilët abuzojnë me pushtetin e tyre. Njihët shumë mirë në Shqipëri që romët punojnë sezonalisht në Greqi dhe për rrjedhojë me raste ata kanë edhe valute. Romët në të gjithë Shqipërinë kanë raportuar raste të atakimeve policore me qëllim që t'ju zhvasin para. Në shumicën e rasteve të dokumentuara nga ERRC, romët pretendonin që atyre nuk u është dhënë asnjë spjegim nga policia për

³⁷ Per raportet e koheve te fundit te te drejtave te njeriut ne pergjithesi shiko Amnesty International, "AI Concerns in Europe: July- December 1996", March 1997; Amnesty International, *Albania: Detention and Ill-Treatment of Government Opponents- The Elections of May 1996* [Shqiperia: Ndalimi dhe keqtrajtimi i kundershtareve te qeverise- zgjedhjet e majit 1996], London, September 1996; Amnesty International, *Albania: A Call for the release of Prisoners of Conscience* [Thirrje per lirimin e te burgosurve te ndergjegjes], London: November 1996; Human Rights Watch, *Human Rights Watch World Report 1996* [Raporti boteror per te drejtat e njeriut nga Human Rights Watch], December 1995; Human Rights Watch, *Human Rights Watch World Report 1997*, December 1996; International Helsinki Federation of Human Rights, *Annual Report 1995* [raporti vjetor, 1995], Vienna 1995; International Helsinki Federation of Human Rights, *Annual Report 1996*, Vienna 1996; U.S. Department of State, *Country reports on Human Rights Practices for 1995* [Raporte mbi praktikat per te drejtat e njeriut per vende te ndryshme per 1995], Washington: U.S. Government Printing Office, April 1996; U.S. Department of State, *Country reports on Human Rights Practices for 1996*, Washington: U.S. Government Printing Office, January 30, 1997; Departamenti i Shtetit te Shteteve te Bashkuara raporton dy raste vdekjesh nen arrestin policor ne vitet e fundit; Komiteti Nderkombetar i Helsinkit raporton tre vrasje nga policet.

gjobat shumë të larta.

Një komunitet rom i cili ka përjetuar shqetësime nga policia dhe grabitje parash është ai i Zinxhiraj, i ndodhur në periferi të Gjirokastrës, në Shqipërinë Jugore. Këtu, romët vendas i treguan ERRC se një grup prej rreth 10 policësh - gjithmonë e njëjta 10-she - vijjnë rregullisht për t'ju rrembyer banoreve para. Sipas zonjës 32 vjeçare R.X.:

Një grup policësh me uniformë dhe me armë e shkopinj gome vijjnë këtu gjatë gjithë kohës. Ata u japin makinave të tyre dhe fillojnë të sulmojnë shtëpitë. Ata arrestojnë të gjithë burrat që mund të gjejnë, i marrin në rajonin e policisë dhe i detyrojnë të paguajnë për tu liruar. Nganjëherë, nëse në i paguajmë ata menjëherë, ata na lenë rehat. Njëherë ata zunë burrin tim. Ata e goditën atë në të gjithë trupin. Ai ishte kaq i frikësuar sa që u pagoi atyre menjëherë 200 US\$.

Zakonisht, në duhet t'j paguajmë atyre midis 100 dhe 400 US\$. Ata kanë ardhur këtu çdo javë, por që pas udhëtimit tonë për në Greqi rreth dy muaj më parë, ata s'kanë qenë më. Ndoshta, nuk e dinë akoma që në jemi kthyer.³⁸

E njëjta grua i tha ERRC:

Nuk besoj se ka ligje që do na mbrojnë neve. Këtu nuk ka ligje të cilave të bardhët ju binden. Unë isha më mirë gjatë komunizmit.³⁹

Një mbrëmje rreth orës 9 të darkës në janar 1996, 44 vjeçari zoti K.Q., banor i Zinxhiraj, ishte duke luajtur bilardo me disa shokët e tij në një bar aty pranë kur një grup prej gjashtë apo shtatë policësh hyri në bar dhe ju afrua atyre, duke i pyetur në mënyrë agresive se çfarë po bënin aty:

Shokët e mi mundën t'ja mbathin, por ata më kapën mua dhe filluan të më rrahin. Pastaj ata më morën me vete në rajon të policisë. Atje, ata vazhduan të më rrahin. Ata më tërhiqnin nga flokët dhe më zhysnin në ujë të ftohtë. Ata më qëlluan në kokë, në shpinë, në këmbë, dhe në gjoks - në të gjithë trupin. Unë i pyeta se ç'kisha bërë, por ata nuk mu përgjigjën. Ata nuk më pyetën dhe nuk më akuzuan për asgjë. Pas afërsisht një ore që po më rrihnin, ata më lanë vetëm. Pastaj, pas pak, një nga policët erdhi dhe më tha "Nëse paguani diçka, në do të të lemë të shkosh." Unë i dhashë atij 10.000Lekë [afërsisht 100 US\$] dhe ata më liruan.⁴⁰

Sulme policore për të rrembyer e përvetësuar para janë raportuar edhe nga romët e Delvinës, të cilët i thanë ERRC që edhe pse policët nuk i bezdisin ata në lagjen e tyre, çdo rom që nget një makinë do tërheqë vëmendjen e një polici dhe ata zakonisht ju paguajnë para policëve në rrugë.⁴¹

Për 40 vjeçaren Zonjën X. S. Nga Tirana, arrestimet arbitrare për të marre para janë bërë një element shumë i njohur në jetën e saj të përditëshme:

Nuk ka asnjë mënyrë për në që të mund të shmangim të paguarit. Ata [policet] e dinë që ne do të paguajmë. Kur dikush arrestohet, familja shkon në polici për të marrë vesh arsyen pse është arrestuar dhe të bjerë në ujdë për kushtet e lirim. Nëse ne refuzojmë të paguajmë, ata kërcënojnë se do të rrahin personin e arrestuar. Policët gjithmonë thonë gjëra si "Mos thoni që s'keni para! Ju gabelët jeni të gjithë bosa. Ju mund të bleni të gjithë vendin."⁴²

Policët zakonisht i kontrollojnë natën romët e Fushë-Krujës, në veri të Tiranës. Edhe pse policët justifikohen me faktin që ata duhet të kapin individët që i shmangen shërbimit ushtarak ose kanë dezertuar nga ushtria, procedurat e bastisjes sugjerojnë që ato kryhen kryesisht me qëllimin për të përvetësuar para. Sipas 29 vjeçarit zotit N.:

Ndodh mjaft shpesh që policët vijjnë këtu gjatë natës, ose shumë herët në mëngjes, për të marrë njerëz për në rajonin e policisë. Ata thonë se po i këkojnë ngaqë duhet të shkojnë në ushtri. Ata kanë një listë dhe vijjnë ti arrestojnë dhe ti marrin me vete këta persona. Ata që kapen nga policët çohen në rajonin e policisë, ku u jepet një kohë prej dy ditësh për të paguar. Nëse ata paguajnë 20 US\$, ata lihen rehat për një muaj. Nëse paguajnë afërsisht 300 US\$, policët nuk i ngacmojnë kurrë më.

³⁸ *European Roma Rights Center*, interviste me zonjen R. X., 5 Dhjetor 1996, Gjirokastrë. Ne raste kur na eshte kerkuar, ose ERRC beson qe publiciteti i emrit mund te demtoje viktimen ose deshmitaret, ne vend te tij jane perdorur inicialet.

³⁹ *European Roma Rights Center*, interviste me zonjen R. X., 5 Dhjetor 1996, Gjirokastrë.

⁴⁰ *European Roma Rights Center*, interviste me zotin K. Q., 5 Dhjetor 1996, Gjirokastrë.

⁴¹ *European Roma Rights Center*, interviste me zotin M. M., 4 Dhjetor 1996, Delvine.

⁴² *European Roma Rights Center*, interviste me zonjen X. S., 14 Korrik 1996, Tirane.

Tani, ata po kërkojnë për mua, kështu që unë nuk fle në shtëpi. Kur isha 19 vjeç, unë doja të regjistrohesh, por kur shkova atje ata nuk më morën. Tani ata duan që unë të paraqitem vetë. Por unë kam pesë kalamaj për të cilët duhet të kujdesem, dhe derisa nuk kam para më duhet të fshihem.⁴³

Shërbimi ushtarak në Shqipëri është i detyrueshëm. Këtij shërbimi nuk mund ti shmangesh me vetëdije për asnjë arsye, edhe pse lirin nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak mund ta blesh për 4000 US\$. Kjo marrëveshje ka nxitur kritikizmin e *Amnesty International*.⁴⁴ Si pothuaj kudo në botë, qytetarët që refuzojnë të paraqiten kur ju vjen thirrja për ushtri konsiderohen si dezertorë dhe në Shqipëri ata dënohen me gjoba të rënda ose nga gjashtë muaj në katër vjetë burgim. Sipas oficerit X., Shef i Policisë së Fushë-Krujës, policët thjesht po kryejnë detyrën e tyre kur kërkojnë nëpër shtëpitë e atyre që kanë refuzuar të paraqiten për shërbimin ushtarak:

Shumica e romëve nuk duan të shkojnë ushtarë. Derisa ata nuk punojnë, unë me të vërtetë nuk mund ta kuptoj pse ata refuzojnë të shkojnë. Cfare do që te jete arsyeja, detyra jone eshte qe te kapim ata persona te cilet refuzojne te shkojne.⁴⁵

ERRC intervistoi pesë romë meshkuj, të cilët ishin kapur disa herë nga policia e Fushë-Krujës ngaqë nuk donin të shkonin ushtar. Asnjëri prej tyre nuk ishte gjobitur për dezertim, megjithatë ata të gjithë kishin paguar gjoba të mëdha.

Romët e Maliqit, një komunitet që ndodhet afërsisht 25 km në veri të Korçës, në Juglindje të Shqipërisë, jetojnë në apartamente midis shqiptarëve etnikë. Romët e Maliqit thanë që ata shkojnë relativisht mirë me popullsinë lokale jo-romë. Përveç faktit që ata nuk jetojnë të ndarë nga jo romët, ata gjithashtu ankoreshin se kishin qenë subjekt i trajtimeve të veçanta abuzive, të cilat përfundonin me përvetësim parash nga policia lokale:

Dy ditë më parë, në po rrinim jashtë një bari dhe hymë në sherr me një grup shqiptarësh. Sherri nisi ngaqë ata na ofenduan neve dhe thanë sharje të rënda për gratë tona. Fare pak minuta pasi kishte nisur sherri, erdhi policia e cila na arrestoi nëve por jo të bardhët. Ata thjesht i pyetën ata për emrat e tyre dhe i lanë të shkojnë. Megjithatë që të katërt ne u çuam në rajonin e policisë. Atje u mbajtëm për 12 orë. Më së fundi, erdhi një polic i cili tha që nëse në do të paguanim 10 US\$ secili, ai do të na linte të iknim. Ne paguam dhe mbas kësaj u liruam.⁴⁶

30 vjeçari Petrit Rexha i shpjegoi ERRC marrëdhëniet romë-policë në Maliq:

Sa herë që këtu në fshat ndodh ndonjë vjedhje, policët vijnë menjëherë këtu dhe na akuzojnë në. Kjo ndodh gjithmonë. Ata nuk hyjnë brenda në shtëpitë tona, por vijnë dhe rrinë vërdallë, duke vëzhguar hyrjen dhe presin për në që të kthehemi nga diku. Nëse ata na zënë nëve, na çojnë në polici ku na detyrojnë të paguajmë. Ata gjithashtu, na ofendojnë dhe na rrahin Romët gjithmonë rrihen nga policët.⁴⁷

Romët e Ures Vajguore kanë raportuar gjithashtu përvetësim parash. Zonja R.K., 30 vjeç, i shpjegoi ERRC se, për shkak të rrahjeve dhe grabitjeve sistematike të policisë, në komunitetin që dikur ishte i përzier me popullsinë vendase pak në veri të Beratit në Shqipërinë e Jugut, kanë mbetur vetëm katër familje romë:

Ne kemi qenë 19 familje, por një vit më parë, 15 prej tyre u larguan për në Elbasan (afërsisht 50 km në veri të Ures Vajguore). Ata u larguan ngaqë kishin probleme me policinë. Ata kishin probleme ngaqë kishin para. Ata merreshin nga policët vazhdimisht dhe detyroheshin të paguanin për tu liruam.⁴⁸

Dëshmia e zonjës R.K. tregon së paku që në marrëdhëniet e tyre me romët, policët sillen si të ishin imunë ndaj kufizimeve ligjore, ndërsa romët shijojnë dobësinë e tyre në mënyrë të menjëhershme:

Qe kur erdhi demokracia, romët janë rrahur nga policët. Nganjëherë rrahja ndodh në lagje në sytë e çdokujt që gjendet aty rastësisht, ndonjëherë ata na marrin në polici dhe na rrahin atje. Deri tani, vetëm romët e pasur kanë patur probleme me policinë, por në i kemi parë këto rrahje dhe jetojmë me një frikë të përhershme nga policia, edhe pse në jemi të varfër. Nëse do ta merrnin vesh se në jemi duke biseduar me

⁴³ *European Roma Rights Center*, interviste me zotin N., 18 Korrik 1996, Fushe-Kruje.

⁴⁴ *Shiko AI Concerns in Europe, July -December 1996* [Shqetësimet e Amnesty International ne Europe], London, Amnesty International, March 1997.

⁴⁵ *European Roma Rights Center*, interviste me oficerin e policisë X., shef i policisë së Fushe-Krujës, 18 Korrik 1996, Fushe-Kruje. Personi refuzoi të japë emrin e tij për ERRC.

⁴⁶ *European Roma Rights Center*, interviste me 28 vjeçarin Agron Rexha, 8 Dhjetor 1996, Maliq.

⁴⁷ *European Roma Rights Center*, interviste me 30 vjeçarin Petrit Rexha, 8 Dhjetor 1996, Maliq.

⁴⁸ *European Roma Rights Center*, interviste me zonjen R.K., 7 Dhjetor 1996, Ura Vajguore.

ju tani, ata mund të vinin dhe të na rrihnin nëve.⁴⁹

Nëse romët janë shumë të preکشëm nga abuzimet policore, ata bëhen dyfish të tillë, kur policët veprojnë nën bindjen se ka bazë ligjore për ndalimet që ata bëjnë. ERRC ka dokumentuar shumë raste kur, ndërsa po kryenin arrestin - vete dhe mbi baza ligjore të dyshimita - policët kanë keqtrajtuar të ndaluarit në kundërshtim të plotë me standartet juridike të vendit dhe ato nderkombëtare. Në raste të tilla policët kanë kryer gjithashtu përvetësime parash.

Në dimrin e 1995-ës, një grup me afërsisht pesë policë të policisë lokale erdhën në shtëpinë e 28 vjeçarit zotit H.R. në komunitetin rom të Levanit, afërsisht 10 km në jug të Fierit, në Jug - Perëndim të Shqipërisë:

Ata më akuzuan se mbaja pushke pneumatike. Ata hynë brenda në shtëpi, më tërhoqën për flokësh dhe më nxorën jashtë. Pastaj së bashku me babanë na çuan në rajonin e policisë, ku u rrahëm me grushta dhe u goditëm me shqelma. Unë ju thashë që i kisha të gjitha dokumentet për armën, por ata as që e çanë kokën. Ata na mbajtën aty për 24 orë. Neve na duhej të paguanim 600 US\$ sejcili për t'u liruar.⁵⁰

Mbajtja e armëve ka qenë gjithashtu justifikimi për bastisjen e kryer nga ana e policisë në familjen Z. Në Tiranë gjatë një natë duke gdhirë 23 Shkurti 1996:

Më 23 Shkurt 1996, në orën 2 të mëngjesit, policët erdhën në shtëpinë time. Të gjithë ishin duke fjetur kur erdhën ata. Unë shkova të hap derën. Jashtë ishin tre fugonë policie me të paktën 30 policë. Ata hynë brenda dhe filluan të kërkojnë. E kthyen çdo gjë përmbys dhe bënë një rrëmujë të madhe. Nuk na treguan asnjë dokument. Ata hynë brenda, na shtynë tutje dhe filluan ti flaknin sendet poshtë e lartë. Ata thanë se ishin duke kërkuar burrin tim dhe armët e fshehura.

Pasi kërkuan gjithandej dhe nuk i gjetën armët, ata urdhëruan burrin tim ti shoqëronte ata për në shtëpinë e vëllait të tij - burri im ka tre vëllezër të cilët jetojnë në këtë lagje. Ata kontrolluan çdo shtëpi dhe pastaj i morrën burrin dhe tre vëllezërit e tij në rajonin e policisë, ku u mbajtën të gjithë ditën tjetër. Policët i akuzonin ata për armëmbajtje pa leje, dhe u përpoqën t'ju bënin presion që të pranonin. Vëllai i madh i burrit ishte goditur në këmbë, por përpara se ta lironin ata i kërkuan atij që të firmoste një letër në të cilën thuhej se nuk ishte rrahur nga policia.⁵¹

27 vjeçari Zoti H.D. nga Pojani, një komunitet tjetër pak në veri të Korçës, gjithashtu raportoi se romët janë rregullisht në shënjestër të trajtime të veçanta të policisë lokale.

Nëse ka ndonjë problem në qytet, ata gjithmonë vijnë tek ne. Ata hyjnë në shtëpitë tona dhe kontrollojnë gjithçka. Hyjnë në shtëpi dhe na rrahin neve - burrave - me shkopinj, dhe u thonë fjalë të ndyra femrave. Ndonjëherë, at rrahin edhe gratë me fëmijët. Pastaj ata na marrin të gjithë burrat në polici dhe na mbajnë aty derisa paguajmë. Ata kanë qenë në shtëpinë time, rregullisht.

Nëse unë do të shkoj në lokal sonte dhe zihem me ndonjë shqiptar, policia do të më arrestojë vetëm mua por jo atë. Kështu shkojnë punët këtu.⁵²

Incidenti i fundit i abuzimit policor që komuniteti rom i ka raportuar ERRC, ka ndodhur në mes të nëntorit 1996. Zoti H.D. u arrestua nga dy policë dhe u çua në rajonin e policisë, ku u rrah dhe u mbajt nën arrest për tre orë. Ai u leshua vetëm pasi u pagoi policëve 10 US\$:

Unë isha duke nxjerrë kalin në fushë kur dy policë më ndaluan në rrugë dhe më thanë që kali kishte hyrë në token e një tjetri. Ata donin që unë t'ju paguaja atyre 50 US\$, por unë refuzova, kështu që ata më arrestuan dhe më çuan në rajonin e policisë.

Atje ata morën një shkop dhe filluan të më godasin në të gjithë trupin. Unë duhej ti mbaja duart para dhe një polic i godiste ato me shkopin e tij. Më mbajtën në rajonin e policisë për tre orë. Pastaj u pagova atyre 10 US\$ dhe ata më liruan.⁵³

Zonja R.D., 33 vjeç, kunata e zotit H.D., i tha ERRC se policët në Pojan i kanë rrahur gjithmonë romët, por sipas saj, gjatë komunizmit, kjo ndodhte vetëm kur ata bënin ndonjë gjë kundër ligjit, Ndërsa sot ata i rrahin romët pa asnjë arsye:

Policët e Pojanit janë bërë vërtet të çmendur në këto vitet e fundit. Njëherë ata morën burrin tim. Ai kishte

⁴⁹ European Roma Rights Center, interviste me zonjen R.K., 7 Dhjetor 1996, Ura Vajgurore.

⁵⁰ European Roma Rights Center, interviste me H. R., 6 Dhjetor 1996, Levan.

⁵¹ European Roma Rights Center, interviste me zonjen Z., 14 Korrik 1996, Tirane. Zonja Z. refuzoi që ti tregojme emrin për shkak të frikes.

⁵² European Roma Rights Center, interviste me zotit H.D., 8 Dhjetor 1996, Pojan.

⁵³ European Roma Rights Center, interviste me zotit H.D., 8 Dhjetor 1996, Pojan.

shkuar për vizitë tek i vëllai dhe doli të ushqejë kuajt kur një polic e sulmoi atë dhe filloi ta godasë dhe shqelmojë gjithandej. Kjo ka ndodhur një vit më parë, në dimrin e kaluar. Polici ishte i dehur. Ai tha: "Do ta vras racën tuaj." Për fat të mirë, ai polic nuk punon më këtej. Kam dëgjuar që tani ai punon në doganë në kufirin me Maqedoninë.⁵⁴

Në pjesën më të madhe të rasteve, romët e Shqipërisë jo vetëm që nuk preferojnë të përfitojnë kompensim ligjor kur të drejtat e tyre dhunohen, por për më tepër ata përpiqen të evitojnë çdo kontakt me autoritetet ligjore. Mosbesimi dhe frika nga policët janë rrënjësorë thellë në mendjen e qytetarëve shqiptarë në përgjithësi. Në rastin e romëve, megjithatë, ky mosbesim është përforcuar nga rrethanat e jetës së tyre të përditshme. Duket që romët janë të destinuar për trajtim special nga policia. Zonja R.D. i tha ERRC:

Të gjithë romët në Pojan kanë këto probleme me policinë. Zakonisht ata rrahin vetëm burrat, por nganjëherë edhe pleq. Të bardhët jetojnë më mirë se në. Ata janë në një pozitë më të mirë, por në nuk kemi probleme me ta. Ne kemi probleme me policinë, por jo me *gadjet*⁵⁵. Fëmijët tanë luajnë së bashku me të tyret. *Gadjet* këtu në Pojan nganjëherë kanë vetë probleme me policinë, por ata nuk rrihen siç bejnë me në romët.⁵⁶

Një rast i tillë i diskriminimit racial ndaj romëve nga policia ndodhi në Tiranë më 1995; zoti P.F., 40 vjeç, ishte dëshmitar i goditjes së një vajze romë 5 vjeçe nga një makinë. Meqë makina nuk ndaloi, zoti P.F. e çoi vajzën në spital. Ai i tregoi ERRC çfare i ndodhi ngaqë u gjet i përzier në ngjarje:

Spitali është ngjitur me stacionin e policisë. Pak kohë mbas arrijtes sonë në spital, shoferi u shfaq së bashku me një polic dhe erdhi drejt meje. Polici mu hakërrua mua, "Çfarë i keni bërë kësaj çupe të gjorë?", Dhe më goditi me grusht në fytyrë. Kur unë u orvata ti përgjigjem atij, ai më goditi përsëri dhe më quajti "arixhi i qelbur" Unë u çova në rajonin e policisë ku polic i më tha që do të më mbanin në arrest dhe se nuk do ta shikoja kurrë më makinën time. Pas pak, unë u lirova falë një polici me post më të lartë të cilin e njihja personalisht.⁵⁷

Sipas zotit P.F., asnjë procedurë ligjore nuk filloi pas aksidentit, dhe ndaj policit nuk u mor asnjë masë për shkeljen e normave:

Shoferi nuk u dënua fare ngaqë ai u pagoi para prindërve të vajzës së vogël. Ata nënshkruan një lloj marëveshje, sipas së cilës ata nuk do të nisnin asnjë procedurë legale kundër tij. Unë për vetë, nuk depozitova ndonjë ankesë kundër policit, para së gjithash, sepse goditja nuk ishte shumë serioze dhe sepse asnjë nuk do të arrija edhe po ta bëja. Gjithsesi, atij nuk do ti ndodhte asgjë.⁵⁸

ERRC vërejtë që romët e Shqipërisë nuk i shikojnë marrëdhëniet e tyre me policinë si me një institucion shtetëror. Viktimat romë dhe dëshmitarët e keqtrajtimit policore shpesh e shikojnë fenomenin si një problem të disa personave negative brenda forcave të policisë. Selman Musta, udhëheqës i komunitetit lokal të romëve të Delvinës në Shqipërinë jugore, i tha ERRC:

Policët nuk shkaktojnë probleme. Disa herë ata dhunojnë të drejtat tona, por nuk është policia që e bën këtë, por individë brenda policisë. Nëse një polic nuk ju pëlqen si person, ai mund të të detyrojë të paguash ose perndryshe të rreh.⁵⁹

Në kundërshtim me këtë bindje, ERRC vrojtoi që problemi i policëve brutale është i në të gjithë sistemin dhe endemik. Instrumentet legale që mund të ekzistojnë për të kufizuar si duhet policët përgjithësisht nuk përdoren. Jashtë kontrollit institucional të vërtetë, "policët e mirë" janë të mirë para së gjithash prej rastësisë, meqenëse ekziston vetëm një presion i vogël i jashtëm që do ti pengonte ata të bëheshin të policë të këqinj. Ndryshe nga çdo vend tjetër në Europën Lindore, romët e Shqipërisë nuk janë bërë subjekt i "masave speciale" famëkeqe për arrixhinjtë. Megjithatë, ERRC është e shqetësuar se shumë elementë që kontribuojnë në zhvillimin e të ashtuquajturave "politika parandaluese"⁶⁰ - midis të cilave bastisjet policore të lagjeve romë - janë tashmë një realitet në Shqipëri. Rrahjet, arrestimet arbitrare dhe format e korrupsionit nga

⁵⁴ *European Roma Rights Center*, interviste me zonjen R.D., 8 Dhjetor 1996, Pojan.

⁵⁵ Fjala rome për jo-romet.

⁵⁶ *European Roma Rights Center*, interviste me zonjen R.D., 8 Dhjetor 1996, Pojan.

⁵⁷ *European Roma Rights Center*, interviste me zotën P.E., 11 Korrik 1996, Tirane.

⁵⁸ *European Roma Rights Center*, interviste me zotën P.E., 11 Korrik 1996, Tirane.

⁵⁹ *European Roma Rights Center*, interviste me 45 vjecarin Selman Musta, 4 Dhjetor 1996, Delvine.

⁶⁰ Shiko, për shembull, raportin e ERRC, *The Misery of Law: The Rights of Roma in the Transcarpathian Region of Ukraine* [Varferia e ligjit, të Drejtat e Romeve në Rajonin e Trans Karpateve në Ukrainë], Aprill, 1997.

nëpunësit publikë janë në kundërshtim flagrant me ligjet shqiptare dhe ndërkombëtare.⁶¹ ERRC nuk është në dijeni të ndonjë dënimi nga ana e shtetit kundër policisë për këto abuzime.

3.2. KONFISKIMET E PALIGJSHME

Policët dukej që kërkonin për armë të vjedhura nga një repart ushtarak në Gjirokastër kur ata kthyen përmbys një shtëpi në një zonë të Delvinës të quajtur Corro. Një kontroll destruktiv nga katër policë, njëri prej të cilëve nuk ishte me uniformë, nuk rezultoi në gjetjen e asnjë arme. Policët, sidoqofte, gjetën një kuti që përmbante 7.000 US\$ kartemonëdha. Per rjedhoje ata akuzuan romët se ishin shpërndares droge. Kur nje burre rom e kundërshtoi këtë, njëri prej policëve i vuri pistoletën tek koka dhe ju tha të tjerëve, " Hajdeni, le të shkojmë. Nuk ka asgjë për ne ketu." Ata u larguan , duke marrë 7.000 dollarët me vete. Asnjëri nuk u çua në gjyq në lidhje me paratë, shpërndarjen e drogës apo armët e vjedhura, dhe romët nuk i panë më paratë e tyre.⁶²

Në qytetin e Fushë-Krujës, në veri të Tiranës, romët raportuan bastisje të rregullta nga policët. Sipas zotit S.B., 35 vjec, grupe policësh në shumë raste kanë hyrë në shtëpitë e romëve pa treguar flete - kontrollin dhe kanë marrë "çfarë ju ka dashur qejfi."⁶³ Për shembull, në Janar 1996, televizori i zotit S.B.u konfiskua nga policia.

Të pyetur për të komentuar aktivitetin e konfiskimeve të paligjshme, shefi i policisë të Fushë-Krujës, i cili refuzoi të japë emrin e tij për ERRC, deklaroi që ndërhyrje të tilla janë ndërmarë vetëm në rastet kur janë raportuar vjedhje. Ai nuk e sqaroi se si policët mund të vendosin cilët objekte janë vjedhur ose të spjegonte pse policët rrallë hyjnë në shtëpitë e banorëve për të kërkuar një mall të veçantë, por në vend të kësaj, zhvatin gjithcka që ju bie në dorë. Polici X. Shtoi se gjatë këtyre operacioneve, policët nuk i arrestojnë romët, por janë të kënaqur "vetëm të marrin mallrat e vjedhura."⁶⁴ ERRC nuk ka gjetur asnjë bazë ligjore për këto akte të konfiskimit nga ana e policisë. Përkundrazi, ato shkelin Kapitullin e VII, Nenin 16 të Ligjit Kushtetues të Republikës së Shqipërisë, e garanton paprekshmërinë e personit dhe të pronës private, si dhe Nenin 254 të Kodit Penal të Shqipërisë.⁶⁵

3.3. MBAJTJA E PALIGJSHME NGA ANA E POLICISE DHE E DREJTA PER NJE PROCES GJYQESOR LEGJITIM

Në disa raste të shqyrtuara nga ERRC, praktikat brutale hetimore kanë çuar në ndalimin e paligjshëm të romëve të afërmit e të cilëve kanë qenë të dyshuar. Në një rast të tillë, dy anëtarë të një familjeje u arrestuan, rrahën dhe burgosën nga

⁶¹ Kapitulli 7, Neni 3 i Ligjeve Kushtetuese te Republikës se Shqiperise thote, " Askush nuk mund ti nenshtrohet tortures, denimit apo trajtimit cnjerezor ose poshterues". Shiko gjithashtu International Covenant on Civil and Political Rights [Konventa Nderkombetare mbi te Drejtat Politike dhe Civile] (ICCPR, e ratifikuar nga Shqiperia me 1992.), Neni 7; European Convention on Human Rights and Fundamental Freedoms [Konventa Europiane e te Drejtave dhe Lirive Themelore te Njeriut] (ECHR, ratifikuar nga Shqiperia ne Nentor 1996), Neni 3 (ndalimi i trajtimeve poshteruese ose cnjerezore); UN Code of Conduct for Law Enforcement Officials (1979) [Kodi i sjelljes i Kombeve te Bashkuara per zyrtaret e pushtetit ekzekutiv (1979)] dhe principet baze te implementimit te tyre te adoptuara nga ECOSOC ne 1989, si dhe Rezoluta 690 (1969) e Asamblese Parlamentare te Keshillit te Europes. Arrestimet e paligjshme - te ndemara ne mungese te nje dyshimi te mjaftueshem qe i akuzuari ka kryer nje krim ose eshte duke e kryer ate - nuk eshte ne perputhje me normat nderkombetare dhe ato te vendit. Shiko Kodin e Procedures Penale te Shqiperise, nenet 244-246 te cilat specifikojne udhezimet proceduriale per leshimin e urdher arrestit nga nje gjykate kompetente; nenet 251-259 te cilet parashikojne normat proceduriale per arrestimin e te dyshuarve te kapur gjate kryerjes se nje krimi, si dhe procedurat vleresuese ne te cilat te dyshuarit e kapur duke kryer nje krim mbahen ne arrest per nje periudhe jo me te gjate se 24 ore. Perkthimi jo zyrtar per ERRC eshte bere nga Andi Dobrush. Shiko gjithashtu ICCPR, Neni (9)1; ECHR, Neni 5(1) (c). Neni 250 i Kodit Penal te Republikës se Shqiperise garanton: " Kryerja e veprimeve ose dhenia e urdherave arbitrare, nga ana e punonjesit qe kryen nje funksion shteteror ose nje sherbim publik gjate gjate ushtrimit te detyres se tij, te cilat prekin lirine e shtetasve, denohet me gjobe ose me burgim deri ne 7 vjet." Neni 259 garanton: "Kryerja e veprimeve nga punonjesi i ngarkuar me funksion shteteror apo ne sherbim publik, per te kerkuar ose urdheruar dhenien e shperblimeve qe nuk i takojne ose me shume ngfa sa i takojne sipas ligjit, denohet me gjobe ose me burgim gjer ne 7 vjet." Perkthimi jo zyrtar ne anglisht nga Kathleen Imholz.

⁶² European Roma Rights Center, interviste me 16 vjecarin zotin Q.M., 4 Dhjetor 1996, Delvine, dhe European Roma Rights Center, interviste me 22 vjecarin zotin L.M., 4 Dhjetor 1996, Delvine

⁶³ European Roma Rights Center, interviste me zotin S.B., 18 korrik 1996, Fushe-Kruje.

⁶⁴ European Roma Rights Center, interviste me policin X., shefi i policise se Fushe-Krujes, 18 korrik 1996, Fushe-Kruje. Shefi refuzoi te jape emrin per ERRC.

⁶⁵ Kapitulli 7, Neni 16 i Ligjit Nr. 7692, dt. 31.3.1993 "Per nje shtojce ne Ligjin Nr. 7491, dt. 29.04.1991 "Per Dispozitat Kryesore Kushtetuese" garanton "paprekshmerine e banese dhe te personit". Ai parashikon : (1) " Banesa eshte e padhunueshme"; (2) "Hyrja ne banese mund te behet pa pelqimin e personit qe banon ne te, vetem me vendim gjyqesor ne rastet e parashikuara me ligj ose per te shmangur nje rrezik te atyperatyshem per jeten, shendetin e njerezve, per pasurine ose kur eshte ne kryerje e siper te nje krimi ose menjehere pas kryerjes se tij"; (3) "Askujt nuk mund ti behet kontroll personal, me perjashtim te rasteve te hyrjes ne territorin e shtetit dhe te daljes prej tij ose per te menjanuar nje rrezik te atyperatyshem qe i kanoset sigurimit publik." Perkthimi jozyrtar [per ERRC] eshte bere nga Agron Alibali. Neni 254 i Kodit Penal te Shqiperise thote, "Hyrja ne banese pa pelqimin e personit qe banon ne te, prrej punonjesit te te ngarkuar me nje funksion shteteror apo ne sherbim publik gjate ushtrimit te detyres se tij , vec rasteve kur lejohet nga ligji, denohet me gjobe ose me burgim gjer ne 5 vjet." perkthimi jozyrtar [per ERRC] nga Kathleen Imholtz. Shkelja arbitrare ose e paligjshme e lirise se individit apo baneses cenojne standartet nderkombetare. Shiko ICCPR, Neni 17 and ECHR, Neni 8.

tre muaj sejcili, dhe pastaj u liruan pa u akuzuar apo provuar fajin. Në një tjetër, anëtarët e familjes u arrestuan, akuzuan dhe dënuan nën pretekstin se ata vetë ishin përfshirë në krim, edhe pse sipas nënit që ata ishin akuzuar, anëtarët e familjes përjashtoheshin nga të qenit fajtor ose keqbërës.

Arrestime me pretekste të tilla kanë ndodhur në komunitetin e Levanit, afërsisht 10 km në jug të Fierit, në prill 1996. Sipas dëshmitarëve, incidenti filloi kur rreth 20 policë po inspektonin komunitetin rom. Policët qëlluan në ajër dhe hynë forcërisht në disa familje romë:

Njerëzit u trembën për vdekje. Ata po qëllonin në ajër dhe bërtisnin që çdokush duhej të dilte jashtë. Gjithashtu, ata qëlluan dhe goditën disa njerëz. Njerëzit rriheshin nëse nuk dilnin jashtë nga shtëpitë e tyre. Së fundi, ata na treguan që donin të arrestonin dy hajdutë, por meqë ata nuk ishin në shtëpi, policët morën vëllain dhe djalin e njërit në vend të tyre. Neve na u desh të paguajmë 450 US\$ për ti liruar ata.⁶⁶

23 vjecari E.S. ishte njëri nga të arrestuarit gjatë këtij aksioni:

Vëllai im ishte njëri prej atyre për të cilët policia kishte ardhur. Ai dhe një rom tjetër kishin vjedhur një lopë. Ata e shitën atë dhe ikën në Greqi. Unë isha në shtëpinë e vëllait kur erdhën policët. Një polic me rroba civile më tha, "Hajde me mua. Ne duhet të sqarojmë ca gjëra." Së pari u cova në rajonin e policisë në Levan, dhe pastaj në një të madh në Fier. U rraha për tre ditë me radhë. Ata më rrahën në krahë dhe shpinë me këmbët e karriges. Pas asaj nuk munda të eci për një javë të tërë. Pastaj më çuan në burgun e Fierit ku më mbajtën tre muaj. Nuk u zhvillua ndonjë gjyq kundër meje. Pas tre muajsh unë pagova dhe ata më liruan.⁶⁷

Dy burrat që kishin kryer vjedhjen u kthyen nga Greqia një muaj pasi ishte kryer bastisja dhe u arrestuan menjëherë. Megjithatë, dy të pafajshmit nuk ishin liruar akoma. Sipas zotit R.D. dy hajdutët u dënuan respektivisht me gjashtë dhe tetë muaj heqje lirie sejcili, por ata paguan shëfën e policisë për lopën e vjedhur dhe u liruan pas pak muajsh.⁶⁸

Një rast i dytë i ndalimit pretekstual - i cili mund të ketë qenë bazuar në stereotipet e vjetra raciste ndaj romëve - turbulloi jetën e një familjeje romësh nga Fieri për afërsisht dy vjet. Më 10 Gusht 1995, një grup me pesë policë nga qyteti bregdetar i Durrësit erdhi në ngulmimin rom të lagjes *Azotik* në qytetin e Fierit (afërsisht 75 km në jug të Durrësit) për të kërkuar një rom, të quajtur Flamur Dino, i cili dyshohej të kishte marrë pjesë në shitjen e një fëmije. Duke mos qenë në gjendje të gjejnë Flamur Dinon, ata arrestojnë në vend të tij të vjehrrin e tij, Hassan Hysenaj, të vjehrën Esmë Hysenaj, dhe të kumatën Luljeta Lefterjadhi. Pa u tregua fare urdhër arrestin, të tre u rrasën në makinat e policisë, u çuan në rajonin e policisë të Durrësit ku u futën në arrest. Hasan Hysenaj raportoi dhunë fizike si gjatë kohës së arrestit ashtu edhe gjatë mbajtjes në burgim:

Ishte një mbasdite me diell dhe në ishim duke ndenjur të gjithë përpara shtëpisë. Dy makina me pesë policë ndaluan përpara nësh. Ata më pyetën se kush isha dhe unë u tregova emrin. Ata më thanë që ishin duke kërkuar dhëndërin tim. U thashë që ai nuk ndodhej në shtëpi. Kështu që ata thanë, "atëherë ju do të vini me në." Ata më tërhoqën nga shpatullat dhe më shtynë në një nga makinat. Pastaj ata panë nga gruaja dhe bija dhe ju thanë atyre të hipnin në makinën tjetër. Unë mendova se do na çonin në Rajonin e Policisë në Fier, por ata na çuan në Durrës. Ata nuk më thanë asgjë pse dhe ku po na çonin. Vetëm sa i jepnin makinës. Në Durrës, ata na futën në dhoma të veçanta. Fillimisht erdhën ca policë dhe më goditën me grushta disa herë. Pastaj ata më torturuan për 24 orë: Unë u detyrova të rri me një këmbë për një kohë të gjatë.⁶⁹

Dhëndri i Hassan Hysenaj, Flamur Dino mbeti i akuzuar se kishte blerë një fëmijë i cili më parë ishte grabitur. Në kohën që fëmija kishte humbur, Flamuri dhe gruaja e tij Flora kishin qenë në Greqi për mëse dy muaj; Dinot shkuan në Greqi më 7 maj, ndërsa fëmija u zhduk më 4 korrik 1995.⁷⁰

Çifti Dino ishte akoma në Greqi kur policët erdhën ti arrestojnë ata në Fier në 10 gusht 1995. Për të detyruar Dinot të kthehen nga Greqia ata vendosën të arrestojnë ata pjesëtarë të familjes që gjetën aty.

Flora dhe Flamur Dino u kthyen nga Greqia respektivisht më 14 gusht dhe 7 shtator dhe u arrestuan. Megjithatë, Hassan Hysenaj, Esmë Hysenaj dhe Luljeta Lefterjadhi akoma nuk ishin liruar edhe pas kapjes së Dinove. Ata mbaheshin akoma në arrest për më shumë se pesë muaj, pa u informuar për akuzën që u bëhej dhe pa i lejuar të kontaktonin një avokat. Zoti Hysenaj i tregoi ERRC:

⁶⁶ *European Roma Rights Center*, interviste me zotit R.D dhe I.D., 6 Dhjetor 1996, Levan.

⁶⁷ *European Roma Rights Center*, interviste me E.S., 6 Dhjetor 1996, Levan.

⁶⁸ *European Roma Rights Center*, interviste me R.D., 6 dhjetor 1996, Levan.

⁶⁹ *European Roma Rights Center*, interviste me Hassan Hysenaj., 5 Dhjetor 1996, Fier.

⁷⁰ *European Roma Rights Center*, interviste me avokatin Kristaq Profka., 6 Dhjetor 1996, Fier.

Asnjë avokat nuk erdhi të më takojë mua. Unë kërkoja një avokat, por hetuesi thoshte, "Unë jam avokati yt." Ai donte që unë të nënshkruaja ca letra, por unë i thashë që nuk dija as të shkruaja, as të lexoja. Ai mi vuri letrat përpara dhe më mori shenjat e gishtërinjve në fund të tyre. Një ditë në janar, një burrë të cilin nuk e njihja erdhi tek unë dhe më tha që ishte avokati im. Ai tha, "Familja jote më ka dërguar tek ty." Ai tha se së shpejti do të bëhej një gjyq dhe se unë akuzohesha që nuk tregoja të vërtetën rreth fëmijëve të mi. I tregova që nuk kisha për të fshehur gjë. Unë fola me të në burg, por ai nuk erdhi në gjyq. Më vonë, mësova që asnjëri nga familja ime nuk kishte dërguar ndonjë avokat tek unë.⁷¹

Ndërkohë i biri i Hassan Hysenaj, Besniku, i tregoi ERRC se u përpoq të pajtonte një avokat që do të përfaqësonte familjen, por as ai dhe as avokati nuk u lanë të takohen me të ndaluarit:

Unë shkova në Durrës të marr vesh pse policët më kishin marrë prindërit dhe motrën. Më thanë që, "Çdo gjë është në rregull, ata do të lirohen së shpejti." Unë doja të zija një avokat por hetuesi më tha se nuk ishte nevoja ngaqë ata do ti lironin shumë shpejt. Por koha kalonte dhe ata nuk po liroheshin. Së fundi, unë zura një avokat dhe shkova bashkë me të në Durrës, por hetuesi e refuzoi atë. Ai nuk u lejua të takojë prindërit e mi, gjithashtu. Unë nuk i pashë prindërit deri në ditën e gjyqit. Unë shkoja vazhdimisht në Durrës, por nuk më linin ti takoja ata.⁷²

Çështja kundër pesë të akuzuarve - dy Dinot dhe tre të afërmit - u çua në Gjykatën e Durrësit më 26 Janar 1996. Kristaq Profka, avokati i zënë nga familja, i tha ERRC se ai u lejua të shqyrtojë këtë rast vetëm një javë para gjyqit, më 19 Janar 1996.⁷³ Sipas vendimit të Gjykatës së Durrësit Nr. 43 të datës 24 Shkurt 1996, Flamur Dino u deklarua fajtor për grabitje femijesh sipas nënit 109, paragrafi 2 dhe u dënua me burgim të përjetshëm. Flora Dino u dënua me 23 vjet burgim si bashkëfajtorë, sipas nënit 25 të Kodit Penal.⁷⁴

Në të njëjtin gjyq, Hassani, Esmë dhe Luljeta u fajësuan për pengimin e drejtësisë nëpërmjet mosdenoncimit të krimit sipas Nenit 300 të Kodit Penal; ata u shpallën fajtorë dhe vuajtën dënime që varionin nga dy muaj e gjysëm në tetë muaj burgim. Esmë u lirua në 10 Prill, Hassani në 26 Korrik dhe Luljeta në 29 Shtator 1996.⁷⁵

Të dënuarit apeluan Vendimin e Gjykatës dhe një tjetër gjyq u mbajt më 3 Maj 1996, në Gjykatën e Apelit në Tiranë. Vendimi Nr. 316 i datës 3 Maj 1996, afirmoi Vendimin e parë të gjyqit të Shkurtit. Familja apeloj përsëri dhe kjo përkoj me ekspeditën e ERRC në Dhjetor 1996, duke pritur vendimin final nga Gjykata e Kasacionit, shkalla e tretë dhe më e larta në hierarkinë e sistemit gjyqësor.

Të afërmit e Flamur Dinos kanë qenë subjekt i dhunimeve të rënda të të drejtave të tyre për një proces gjyqësor të drejtë e sic percaktohet nga kapitulli 7, nenet 5, 7 dhe 8 të paketës së Ligjeve Kushtetuese të Shqipërisë.⁷⁶ ERRC i ka dërguar një letër Prokurorit të Përgjithshëm të Shqipërisë, në të cilën i kërkohet informacion për këtë rast. Deri tani, letra jonë mbetet pa përgjigje.

⁷¹ *European Roma Rights Center*, interviste me Hassan Hysenaj., 5 Dhjetor 1996, Fier

⁷² *European Roma Rights Center*, interviste me Besnik Hysenaj., 5 Dhjetor 1996, Fier.

⁷³ *European Roma Rights Center*, interviste me avokatin Kristaq Profkaj., 6 Dhjetor 1996, Fier.

⁷⁴ Neni 109, paragrafi 2 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë thote, " Rrembimi i femijes nen moshen katermbedhete vjec, fshehja ose zevendesimi me nje tjetër, denohet jo me pak se 20 vjet ose me burgim te perjeshem ose me vdekje." Ky nen qe atehere eshte permiresuar. Neni 25 thote, "Bashkepunimi eshte kryerja e nje akti penal nga dy apo me shume persona me marrveshje midis tyre." Perkthimi jozyrtar nga Kathleen Imholz. Avokati Profka i tha ERRC se babai i femijes se blere nga Flamur Dino deklaroi ne gjyq se i kishte shitur Dinos dy femije: njeri ne ngarkimin e Flamur Dinos dhe tjetri i cili ishte grabitur. Nga fundi i gjyqit, babai e terhoqi deshmine e tij, duke thene qe ishte detyruar ta bente nen presionin e hetuesit. Sidoqofte, ky fakt nuk u morr ne konsiderate nga gjykatesi i gjyqit i cili do te pezullonte vendimin ne kete rast. Avokati Profka shtoi se ai beson qe autoritetet ishin nen presionin qe te kapnin dike qe merrej me grabitjen e femijeve ne vend (*European Roma Rights Center*, interviste me avokatin Kristaq Profkaj., 6 Dhjetor 1996, Fier).

⁷⁵ Neni 300, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë thote, "moskallzimi ne organet e ndjekjes penale, ne gjykate, ne organet e rendit publik, te pushtetit ose te administrates, i nje krimi qe eshte duke u kryer apo qe eshte kryer, denohet me gjobe ose me burgim gjer ne 3 vjet." Perkthimi jozyrtar nga Kathleen Imholz.

⁷⁶ kapitulli 7, Neni 5 i Ligjit nr. 7692, dt. 31.03.1993 "Per nje shtojce ne ne Ligjin nr. 7491, dt.29.04.1991 "Per dispozitat Kryesore Kushtetuese" thote: " (1) liria dhe siguria e njeriut eshte e padhunueshme; (2) Askush nuk mund te ndalohet pa te dhena te mjaftueshme; (3) i ndaluar duhet te njoftohet menjehere per shkakun e ndalimit dhe brenda nje kohe te arsyeshme te paraqitet para nje gjyqtari; (4) Askush nuk mund te mbahet i ndaluar per me teper se 48 ore; (5) Çdo person i ndaluar ose i arrestuar duhet te njoftohet se ai nuk ka asnje detyrim te beje ndonje deklarate dhe se ka te drejten te komunikojë menjehere me avokatin; (6) I arrestuari ka te drejte te ankohet ne gjykate kunder arrestimit te tij. Neni 7 thote, "Askush nuk mund te quhet fajtor perderisa nuk i eshte provuar fajesia me vendim te gjykates te formes se prere." Neni 8 mbi garancite procedurale penale thote: "Gjate procesit penal, askujt nuk mund t'i hiqet e drejta: a) te vihet ne dijeni menjehere dhe hollesisht per akuzen qe i behet; b) te kete kohen dhe lehtesine e mjaftueshme per te pregatitur mbrojtjen e vet; c) te mbrohet vete ose me ndihmen e nje mbrojtësi ligjor te zgjedhur prej tij, te komunikojë lirish dhe privatisht me te, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas me ane te nje avokati kur nuk ka mjete te mjaftueshme; d) t'u beje pyetje deshmitareve te pranishem dhe te kerkoje paraqitjen e deshmitareve, te eksperteve dhe personave te tjere te cilet mund te sqarojne faktet." Shiko gjithashtu ICCPR, nenet 9 dhe 14; ECHR, te ratifikuar nga Shqiperia ne Nentor 1996, nenet 5 dhe 6. Edhe pse parashikimet e ECHR nuk kane fuqi prapaveprueses, duke i ratifikuar ato Shqiperia ka shprehur interesin e saj per t'ju permbajtur atyre. *Amnesty International* ka kritikuar se fundi qeverine shqiptare per kontakte te kufizuara te avokateve me klientet e tyre; shiko *Amnesty International, AI Concerns in Europe July-December 1996*, London: March 1997, p.2.

Miti i rrëmbimit të fëmijëve është një akuzim shpifës i lashtë dhe i përsëritshëm.⁷⁷ Ai është kaq i vjetër sa edhe ardhja e romëve në Evropë dhe duket se është endur thellë në paragjykimet folklorike europiane. Edhe në ditët tona, romëve të vërtetë, ju është dashur të përballojnë legjendën popullore që, si shpirtërat dhe zanat, ata vjedhin fëmijët e bardhë duke ja mbathur menjëherë për qëllime djallëzore. Kapitalizmi i çthurur i lindjes së egër i Shqipërisë e ka shndëruar rrëmbimin e fëmijëve në një temë kombëtare, derisa fëmijët aktualisht rrëmben shpesh. Sipas Hivzi Bushatit, Shef i Policisë së Beratit, objekti i këtyre grabitjeve është, para së gjithash, vajza ose nuse të reja të cilat rrëmben për tu detyruar të punojnë si prostituta në Itali dhe, së dyti, fëmijët e të dy seksëve, për vjedhjen dhe shitjen e organëve të tyre.⁷⁸ Shtypi vendas e ka shfrytëzuar këtë fenomen të ri për të rritur shitjet, duke rritur kështu presionin popullor mbi autoritetet shqiptare që të vepronjë. ERRC është e shqetësuar se e gjithë procedura e paligjshme kundër familjes së Flamur Dinos mund të ketë qenë motivuar nga një presion i tillë mbi-legal, që lidhet me një përrallë të vjetër raciste.

3.4. VRASJET POLICORE

Së fundi, dy raste të dokumentuara nga ERRC tregojnë që policët shqiptarë janë në gjendje të ushtrojnë brutalitet në mënyrë të tepëruar në rrethana plotësisht të pajustificuara nga ndonjë objektiv legjitim i zbatimit të ligjit. Më 4 Korrik 1992, Seran Sadiku, një jevg 31 vjeçar, u rrah derisa vdiq gjatë arrestit nga policia në Korçë, Juglindje të Shqipërisë. Ai u arrestua së bashku me të vëllanë 21 vjeçar Gazmir Sadiku, i cili gjithashtu ju nënshtrua keqtrajtimit të rënda nga policët.

Sipas Gazmirit, ai dhe vëllai i tij ishin duke ndenjur në një bar në pazarin lokal bashkë me dy shokë të tyre rrotull orës 2 pasdite të datës 4 korrik 1992, kur tre policë të veshur civilë erdhën dhe ndenjen në një tavolinë ngjitur me ta. Policët filluan ti ofendonin qëllimisht të dy vëllezërit, mes të tjerave duke ju thënë "arixhinj" dhe epitete të tjera raciale. Gazmir Sadiku thotë që ata ishin të vetmit romë / jevg në lokal, dhe se policët filluan t'ju bien në qafë për shkak të ngjyrës së lëkurës së tyre. Kur Seran Sadiku ju kërkoi të pushonin së shari dhe ofenduari, ata e zvarritën jashtë lokalit dhe filluan ta rrihnin. Njëri nga policët, oficeri i policisë I.S. e goditi Seranin në kokë me qytën e armës së tij.

Policët ndaluan rrahjen e vëllezërve Sadiku vetëm kur aty ishte mbledhur një turmë njerëzish që po bënin sehir. Shumë shpejt pas kësaj, në treg mbëritën dy makina të tjera të policisë me afërsisht 20 policë. Policët rrethuan vëllezërit dhe filluan ti rrihnin me shkop. Pastaj ata i futën brenda në makina dhe i çuan në rajonin e policisë. Sipas Gazmir Sadikut, policët vazhduan ti rrahin të dy gjatë gjithë rrugës për në rajonin e policisë. Me të mbërritur në rajon, sipas Gazmir Sadikut,

Ne u futëm në qeli të veçanta ngjitur me njëra-tjetrën. Vendi për tu ulur në qelinë tme ishte prej betoni. Ata më detyruan të ulem me duart e lidhura me pranga mbrapa shpinë. Tetë policë erdhën dhe filluan të më rrahin në të gjithë trupin. Tre policët e lokalit ishin më të këqinjët. Ata më rrahën me këmbët e karrigeve dhe më goditën gjithandej. Ata më çanë daullet e veshit dhe gjaku filloi të rrjedhë nga veshët dhe më thyen brinjët. Midis ulërimave të mia unë dëgjoja vëllanë që po ulërinte matanë murit.⁷⁹

Gazmir Sadiku thotë se u rrah në rajonin e policisë për dy orë dhe se policët ndaluan së rrahuri atë vetëm kur ai, papritur, nuk mund ta dëgjonte më të vëllanë:

Pastaj dera e qelisë tme u hap, dhe unë pash policët që vraponin sa nga njëra qeli në tjetrën. Përmes derës së hapur të qelisë tme unë pashë që po nxirrnin jashtë diçka të mbështjellë në një batanije. Unë i pyeta çfarë kishte në atë batanije dhe ata më thanë që vëllait i kishte rënë të fikët dhe po e çonin në spital. Shumë shpejt pas kësaj edhe unë u çova në spital. Kjo ndodhi rreth orës 6 të mbrëmjes. Polici që më çoi tek doktori i tha atij; "Ky njeri u përpoq të vriste një polic, kështu që mos u kujdes shumë për të." Doktori më vuri ca jod në plagë dhe pastaj më çuan prapë në rajon të policisë.⁸⁰

Babai i vëllezërve Sadiku, Ali Sadiku, i tha ERRC se shokët e djemve të tij erdhën më 5 Korrik 1992 ti thonë që i biri Serani kishte vdekur, dhe e shoqëruan atë në spital. Sipas zotit Sadiku, koka e Seranit ishte e shtypur, trupi ishte i tëri i mavjësuar, dhe dhëmbët ishin të thyer.⁸¹ Çertifikata e vdekjes e lëshuar nga Dr. Robert Bicolli i Institutit të Mjekësisë ligjore të Korçës më 5 Korrik 1992, thotë që Serani vdiq si pasojë e "hemorragjisë së brendshme të një natyre traumatike." Koha e saktë e vdekjes së Seran Sadikut nuk është specifikuar në çertifikatën e vdekjes.

⁷⁷ ketu linja jevgjit / rome behet e qarte. Nje shqiptar etnik i cili kerkoi ti ruhet anonimiteti i tha ERRC, "Me kujtohet qe kur isha femije dhe beja dicka te keqe gjyshja me thoshte: 'Nese nuk me degjon, romet do vijne dhe do te vjedhin!' ju e dini, shqiptaret bejne dallim mes romeve dhe jevgjeve. Te dy grupet shikohen si te keqinj, por jevgjit nuk rembejne femije, edhe pse ata mund te vjedhin si romet (arixhinjte)."

⁷⁸ *European Roma Rights Center*, interviste me Hivzi Bushatit, shef i policise se Beratit, 7 Dhjetor 1996, Berat.

⁷⁹ *European Roma Rights Center*, interviste me Gazmir Sadikun, 9 Dhjetor 1996, Korçe.

⁸⁰ *European Roma Rights Center*, interviste me Gazmir Sadikun, 9 Dhjetor 1996, Korçe.

⁸¹ *European Roma Rights Center*, interviste me Ali Sadikun, 9 Dhjetor 1996, Korçe.

Gazmiri u lëshua nga policia më 6 Korrik, kur funerali i vëllait të tij, i cili ishte mbajtur atë ditë, u shndërua në një protestë në të cilën arkivoli i tij u shëtit fillimisht para rajonit të policisë dhe më pastaj para zyrave të Partisë Demokratike në pushtet. Gazmiri i tregoi ERRC:

Pasi e vranë vëllain tim, ata nuk më prekën më, por unë nuk e dija që ai ishte i vdekur deri dy ditë më vonë kur njerëzit erdhën të protestojnë përpara rajonit të policisë. Pas kësaj unë u lirova.⁸²

Përveç përpjekjeve për të kërkuar kompensim ligjor nga familja e Sadikut, asnjë nuk është çuar para drejtësisë për vrasjen e Seranit dhe keqtrajtimit të Gazmirit. Familja i dërgoi një letër proteste Presidentit të Republikës Sali Berisha, në përgjigje të së cilës ata morën një telegram të datës 7 Korrik 1992, ku thuhej se letra ishte drejtuar për tek ministri i atëhershëm i rendit publik zoti Bashkim Kopliku. Deri më 9 Dhjetor 1996, familja nuk kishte marrë asnjë përgjigje nga ministria e rendit publik.

Familja bëri gjithashtu një ankesë dhe i tregoi ERRC se zoti Azis Roshi i zyrës së Prokurorisë së Korçës kishte urdhëruar të bëheshin hetime. Dy muaj më vonë, në shtator 1992, zoti Roshi informoi familjen se hetimi ishte mbyllur dhe policia nuk ishte gjetur fajtorë për vrasjen e Seranit.⁸³

Në zyrën e Prokurorisë së Korçës, ERRC ju tha që nuk kishte njeri në atë zyrë i cili mund të fliste me kompetencë mbi këtë çështje. Megjithatë, sipas burimeve që kishin kontakt me dokumentat juridike, kjo ngjarje nuk është e regjistruar në regjistrë. ERRC mësoi gjithashtu se, "për shkak të reformës" zoti Azis Roshi ishte pushuar nga puna në Prill 1996.

Të gjitha përpjekjet e bëra nga ERRC për të marrë një dëshmi zyrtare nga policia janë kundërshtuar fuqimisht. Jozyrtarisht, jashtë rajonit të policisë, oficeri i policisë Qamil Cani, shefi i seksionit të rendit publik të policisë së Korçës, i tha ERRC se Seran Sadiku ishte vrarë gjatë një përleshjeje midis gangsterëve rivalë dhe se kriminelë ishte në burg që prej katër vjetësh. Oficer Cani i tha gjithashtu ERRC se oficeri i policisë I.S. ishte përzënë në Korrik 1996, pas një akuze për përdhunim.⁸⁴ Në muret përreth rajonit të policisë, një slogan i shkruar qartë në blu deklamonte, "Demokracia arrihet nëpërmjet ligjit."

ERRC ka arsye të forta të besojë se vrasja e Seran Sadikut dhe keqtrajtimi i Gazmir Sadikut nuk janë ndëshkuar si rezultat i një sistemi liberal të kontrollit nga ana e autoriteteve juridike dhe ekzekutive shqiptare. ERRC i ka dërguar një letër prokurorit të përgjithshëm zotit Alush Dragoshi ku shpreh shqetësimet e saj në shkurt 1997. Deri tani, letra jonë ka ngelur pa përgjigje.

Relativisht më vonë, në shkurt 1994, një rom 22 vjeç i quajtur Agim Shatipi u qëllua për vdekje nga një polic jashtë orarit të punës në komunitetin rom të Zinxhiraj në periferi të Gjirokastrës në Jug të Shqipërisë.

Sipas informacionit të ERRC, incidenti që çoi në vdekjen e Agimit ishte paraprirë nga një debat në një lokal ku Agimi punonte dhe që frekuentohej regullisht si nga romët e lagjes, ashtu edhe nga policët. Polici, i njohur me emrin "Mondi", ishte shok i një romi që kishte banuar në Zinxhiraj. Polici dhe shoku i tij rom ishin duke pirë në bar në mbasditen e asaj dite. Shumë shpejt pasi polici u largua nga lokali, plasi një grindje midis Agimit dhe romit që ishte shok me policin. Sipas dëshmimeve të dëshmitarëve, romi e la lokalin i tërbuar, duke bërëtur dhe kërcënuar Agimin.

Afërsisht një orë më vonë, romi u kthye në bar bashkë me policin, i cili mbante një armë të mbushur. Të dy burrat filluan të ngacmonin babain e Agimit i cili po rrinte në bar. Kur Agimi ndërhyri të mbrojë të jatën, polici vrapoi jashtë barit dhe filloi të gjuajë në drejtim të lokalit. Zoti K.Q. një dëshmitar i ngjarjes i tregoi ERRC:

Kur filloi të gjuajë, në të frikësuar u futëm poshtë tavolinave. Ishim afërsisht gjashtë njerëz në bar. Pas nja pesë apo gjashtë të shtënash, polici i tha Agimit të dalë jashtë nga lokali. Kur Agimi u shfaq tek dera, polici e qëlloi atë. Ai vdiq në vend. Ishte qëlluar drejt e në zemër.⁸⁵

Sipas informacionit që ka në dispozicion ERRC, policët erdhën afërsisht 10 minuta pas të shtënave dhe arrestuan polic "Mondin", i cili ja kishte mbathur për në një repart ushtarak ngjitur me lagjen e romëve. Disa romë nga Zinxhiraj u thirrën si dëshmitarë në gjyq, dhe polici u dënua me 15 vjet burgim. Ai u lirua pas dy vjetësh dhe është akoma polic. ERRC i ka dërguar një letër zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Shqipërisë në të cilën kërkon informacion për administrimin e çështjes së drejtësisë për këtë rast. Deri tani, letra ka ngelur pa përgjigje.

Raportet për të drejtat e njeriut në përgjithësi në Shqipëri përmendin disa incidente të vrasjeve policore në pesë vitet e

⁸² *European Roma Rights Center*, interviste me Gazmir Sadikun, 9 Dhjetor 1996, Korçe.

⁸³ *European Roma Rights Center*, interviste me Ali Sadikun, 9 Dhjetor 1996, Korçe.

⁸⁴ *European Roma Rights Center*, interviste me oficerin e policisë Qemak Cani në rajonin e policisë të Korçës, 9 Dhjetor 1996, Korçe.

⁸⁵ *European Roma Rights Center*, interviste me K.Q., 5 Dhjetor 1996, Gjirokastrë.

fundit dhe përdorimi i dhunës ekstremë nuk ka prekur vetëm romët. Megjithatë, në vrasjen e Seran Sadikut në 1992-in, dëshmitë e viktimave dhe dëshmitarëve tregojnë që urrejtja raciale luajti një rol vendimtar në sjelljen e policëve. Vrasja arbitrare është një shkelje ligji sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë (Neni 76) dhe një dhunim i të drejtës së jetës të garantuar nga Neni 6 i *International Covenant on Civil and Political Rights* [Mareveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike] si dhe Neni 2 i *European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms* [Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore]. Tortura dhe trajtimet poshtëruese përshkruhen në kapitullin 7, Neni 3 i Ligjit Kushtetues të Shqipërisë. Ato, gjithashtu janë në kundërshtim me frymën dhe përmbajtjen e ligjeve ndërkombëtare, veçanërisht Neni 3 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive themelore, dhe Neni 7 i Marëveshjes Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, sipas të cilës, "asnjë nuk duhet ti nënshtrohet tortures ose trajtimit brutal, poshtërues ose çnjerëzor ose dënimit."

4. DHUNA NË KOMUNITET

Problemet me jo-romët lokalë përbëjnë një tjetër fushë kryesore vështirësish për shumë komunitete dhe individë romë të Shqipërisë. Një skenar shumë i përsëritur është përzënia e romëve nga jo-romët nga vendi ku romët banojnë. Proçesi kaotik i privatizimit dhe rikthimit të tokës dhe pronave menjëherë pas fundit të regjimit komunist ka qenë shkaku i një numri të madh përzëniesh të paligjshme të romëve të dokumentuara nga ERRC.

Romët e intervistuar nga ERRC raportuan gjithashtu sulme të dhunëshme nga qytetarë jo-romë të cilat nuk ishin të lidhura direkt me çeshtje kombëtare si rikthimi i pasurisë. Një kërcënim i tillë ndaj romëve shqiptarë është grabitja e fëmijëve e llojit të përshkruar më sipër. Një lloj tjetër dhunë që s'ka lidhje direkte me ndryshimet sociale në Shqipëri është sulmi dhe violenca e cila favorizohet nga mungesa relative e mbrojtjes policore të romëve. Shpesh gangsterë hyjnë në komunitetin rom dhe terrorizojnë banorët e tij.

4.1. SHPËRNGULJET PËR SHKAK TË NDARJES SË TOKËS

Në gjashtë vitet e fundit, ligjet shqiptare që rregullojnë çeshtjen e pronësisë kanë ndryshuar rrënjësisht. Një rezultat i këtyre ndryshimeve është se romët të cilët më parë gjatë regjimit komunist jetonin në tokë shtetërore, së fundi janë detyruar të shpërngulen, ngaqë toka është kërkuar si nga njerëz të cilëve u është dhënë po ashtu edhe nga pronarët e para luftës ose pasardhësit e tyre. Hetimet e kryera nga ERRC zbuluan që proçesi i përzënies së romëve është kryer arbitrarisht dhe pa plan, dhe është shoqëruar me akte dhunë.

Si rezultat i transformimeve post - komuniste të pushtetit dhe ligjit, një pjesë e madhe e pasurisë në Shqipëri ndryshoi pronarin në kushte kaotike.⁸⁶ Shqipëria e para luftës karakterizohej nga pasuri të mëdha të patundshme, pronarët e të cilave dominonin jetën politike. Si kudo në Evropën Lindore, komunizmi ndermori kolektivizimin e plote të tokës. Kjo epokë përfundoi me ligjin e privatizimit të Korrikut 1991 i cili i shpërndau tokën që zotërohej nga ish kooperativat bujqesore anëtarve të saj.

Ligji i privatizimit nxiti një reaksion armiqësor të menjëhershëm nga organizata e pronarëve të shpronësuar para vendosjes së komunizmit "Shoqata kombëtare Pronësi me Drejtësi". Në 1993, si rrjedhojë e presionit mbi qeverinë u miratua ligji mbi kompensimet, Ligji nr. 7698, dt. 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronareve". Ky ligj, mes të tjerave, u siguronte kthimin e plotë pronarëve të dikurshëm të sipërfaqeve më të vogla se 15 hektarë, shumica e të cilave ishin privatizuar dy vjet më parë. Ligji i ri e zbehtë statusin ligjor të individëve të cilët kishin marrë tokë ose pasuri të tjera nëpërmjet privatizimit. Me qëllim që të pengonin paqartësitë e mëtejshme në lidhje me pronësinë e tokës, Ligji nr. 7698 ndaloi shit - blerjen e tokës derisa të zgjidhej statusi i pronësisë mbi tokën.

Më 8 prill 1994, Gjykata Kushtetuese deklaroi Nenin 12, paragrafi 1 dhe Nenin 17 të Ligjit nr. 7698 si jokushtetues. Neni 12 parashikonte rikthimin e tokës që ishte e privatizuar, ndërsa Neni 17 parashikonte bashkëpronësi private midis pronarëve të vjetër dhe të rinj. Konfuzioni dhe mungesa e qartësisë në lidhje me pronësinë mbi tokën gjatë tranzicionit drejt pronës private vetëm sa ka nxitur përdorimin e mjeteve kërcënuese, përfshi dhunën, për zgjidhjen e konflikteve mbi tokën. Sipas kapitenit të parë të komisarariatit të policisë të Fierit - Egerem Vrenozi:

Kur shteti i shpërndau kooperativat, ata që ishin në pushtet i dhanë tokë njerëzve të tyre. Kjo shkaktoi shumë konflikte. Unë fillova të punoj për komisarariatin e policisë në 1991, dhe mund t'ju them që vitet 1991-92 ishin shumë të vështira për policinë.⁸⁷

Romët, etnikisht të huaj dhe pa përfaqësi klanesh⁸⁸ në pushtet, janë jo vetëm në disavantazh kur kërkojnë tokë të punëshme, por shpesh kërcënohen me përzënie. Kjo dobësi është shfrytëzuar në qytetin jugor të Delvinës, ku incidentet e sulmeve të dhunëshme nga banorët lokalë jo romë mbajnë afërsisht 800 banorët romë të atjeshëm në një gjendje tensioni dhe frike të vazhdueshme. Sulmet kanë shkaktuar shpërnguljen me forcë të dy familjeve romë. Sipas 55 vjeçarit zotit M.M.,

⁸⁶ Shiko Hall, cituar me pare, pp 241-251; Vendimi nr. 4, date 8 prill 1994 i Gjykes Kushtetuese të Shqipërisë; si dhe *European Roma Rights Center*, intervisten me Altin Harizaj, 6 dhjetor 1996, Fier.

⁸⁷ *European Roma Rights Center*, interviste me kapitenin e pare Egerem Vrenozi, 6 Dhjetor 1996, Fier.

⁸⁸ Pjesa dermuese e jetes se shqiptareve akoma influencohet nga maredheniet farefisnore dhe solidariteti tradicional fisnor (tarafet). Si rezultat, kapitali dhe burimet e tjera shpemdahen sipas linjave te maredhenieve farefisnore dhe hateri eshte i pafrenueshem. Ne kete sistem, romet jane plotesisht te huaj. Per me teper, duek shoqeruar solidaritetin klanor, tradita e hakmarjes ka mbijetuar ne vend, vecanerisht ne Shqiperine e veriut. I ashtuquajtur "Kanuni i Leke Dukagjinit" i mesit te shekullit te 15te ka vendosur kode qe kerkonin nder, mikpritje dhe vazhdimin e hakmarjes permes "gjakmarjes". Edhe pse komunistet pretendonin se e kishin zhdukur kete tradite, ajo mbeti gjalle tek minoriteti shqiptar ne Jugosllavi, dhe u kthye me vrull ne atmosferen e hakmarjeve post-komuniste. Shiko Hall, cituar me larte, pp. 26-28 dhe Krasztev, peter, "Vériszák", *Beszéló*, Vol. III, No. 4, april, 1997, pp. 58-65.

sulmet sistematike nga jo-romët lokalë të cilët synojnë të përzënë romët dhe të marrin shtëpitë e tyre filluan në 1992:

Grupe njerëzish vijnë në komunitetin tonë, zakonisht gjatë natës. Ata vijnë të na frikësojnë sepse duan që në të largohemi. Janë njerëz nga këtu, nga Delvina, dhe gjithmonë të njëjtët njerëz. Gjatë tre vjetëve të fundit kanë ndodhur të paktën 12 sulme. Provokuesit vijnë zakonisht në grupe nga 4 në 6, të maskuar dhe të armatosur. Ata gjuajnë në ajër dhe bërtasin, "Dilni jashtë nga shtëpitë, ato nuk janë për ju!" Ne mendojmë që disa nga këta njerëz janë nga të policisë, gjykuar nga armët që ata mbajnë. Herën e fundit kjo ndodhi në tetor 1996.⁸⁹

Nga fundi i 1992-it, sipas zotit M.M., afërsisht 15 vetë shpërthyen shtëpinë e tij, shkallmuan një derë dhe rrahën gruan e tij. Personat gjithashtu shkatërruan makinën e tij me gurë dhe goditën me thikë një rom tjetër komshi. Sipas zotit M.M., policët erdhën morën ca shënime dhe pastaj s'bënë asgjë. Zoti M.M. i tha ERRC:

Asnjëri nuk ka mbron neve këtu në Delvinë. Nëse ne shkojmë dhe kërkojmë të drejtat tona, ata do të na rrahin. Ne jetojmë të frikësuar këtu.⁹⁰

Pas një sulmi të dhunshëm të ngjashëm në Dhjetor 1995, banorët shkuan në rajonin e policisë për të protestuar. Sipas Selamet Musta, udhëheqës lokal i komunitetit rom,

Ne shkuam në polici të ankohe mi, por policët na thanë të largohemi. Ata na thanë, "Çfarë doni ju që të bëjmë ne? Ata ishin të dehur. Ne s'mund të bëjmë asgjë."

Qysh atëherë, ne nuk kemi marrë mundimin të shkojmë në polici. Asnjë nuk na mbron neve këtu në Delvinë. Ne romët votuam për demokraci në 1991, por kjo nuk është ajo që neve prisnim nga demokracia. Ne jetonim më mirë në komunizëm. Ne jetonim në paqe.⁹¹

Sipas Selamet Musta, romët e Delvinës janë përpjekur shumë herë tek autoritetet e qytetit për të blerë tokë, por janë refuzuar vazhdimisht.

Berati është një nga qytetet më të vjetra të Shqipërisë, i vendosur në një shpat mali të mprehtë. Romët e Beratit, megjithatë, jetojnë jashtë qytetit, në një geto të zhytur në varfëri, pa ujë të rrjedhshëm. Sipas romëve të Beratit, ata kanë jetuar të padiferencuar nga pjesa tjetër e qytetit, por që nga ndryshimet politike të 1991-it, janë detyruar forcërisht të largohen në periferinë plot me baltë. Procesi i largimit me forcë të romëve në Berat ka qenë shumë i dhunshëm; shumë romë kanë raportuar një numër të konsiderueshëm rastesh dhunë fizike nga banorët lokalë dhe policët. Lagjia tani përbëhet nga jo më shumë se 200-300 romë, ngaqë grupe të mëdha u larguan nga ky qytet në kërkim të mundësive më të mira në pjesë të tjera të vendit.

40 vjeçarja Aishi X., Nënë e 12 fëmijëve, përshkroi ngjarjet që kanë ndodhur në Berat në këto vitet e fundit:

Ne gjithmonë kemi patur shokë *gadje* (te bardhet). Para pak vitesh, disa prej tyre ndryshuan dhe erdhën jo për miqësi, por për të na marrë tokën dhe shtëpitë. Tani në romët jetojmë në kushte shumë të këqija; disa nga ne nuk kanë shtëpi të tyre dhe duhet të jetojnë me të afërmit.

Unë kam jetuar brenda qytetit [Berat] në një apartament, por u largova sepse ata ma shkatërruan shtëpinë. Kjo ndodhi një muaj më parë, në nëntor 1996. Unë isha në shtëpi me familjen time kur kjo ndodhi, por në gjendeshim jashtë saj. Ishte errësirë kështu që unë s'munda të shikoj kush ishte. Ata hodhën gurë dhe thyen të gjithë xhamat e dritareve. Unë nuk raportova në polici, sepse nuk doja t'ju hapja telashe djemve të mi. Përkundrazi, erdha këtu. Unë nuk dua që fëmijët të më rrihen nga *gadjet*.

Ky problem lindi me ndryshimin e pushtetit. Grupe me nga 10-15 *gadje* kanë ardhur këtu disa herë në këto vitet e fundit. Ata thonë fjalë të pista dhe na rrahin. Vijnë me thika, gurë, shufra hekuri, nganjëherë në mëngjes, nganjëherë natën. Shumë njerëz janë rrahur keq. Ata nuk bëjnë ndonjë dallim midis burave dhe grave, ata s'e çajnë kokën nëse jeni i ri apo plak. Ata godasin të moshuarit. Ata janë si sërëbët në Kosovë.⁹²

N.Z. dhe familja e saj janë përzënë dy herë. Ne kohen kur ERRC i vizitoi, në Dhjetor 1996, familja prej gjashtë anëtarësh jetonte në një kolibe prej afërsisht 9 m² të cilën familja e kishte ngritur vete para një muaji:

Ne kemi jetuar në qendër të Beratit. Disa vite më parë në u detyruam të lëvizim në periferi të qytetit, sepse

⁸⁹ European Roma Rights Center, interviste me M.M., 4 Dhjetor 1996, Delvine.

⁹⁰ European Roma Rights Center, interviste me M.M., 4 Dhjetor 1996, Delvine.

⁹¹ European Roma Rights Center, interviste me Selamet Musta, 4 Dhjetor 1996, Delvine.

⁹² European Roma Rights Center, interviste me Aishi X., 7 Dhjetor 1996, Berat.

pronari i ri i shtëpisë na tha që nuk mund të rrinim më aty. Por një muaj më parë, ne u detyruam të shpërngulemi përsëri. *Gadjet* erdhën dhe na e shkatëruan shtëpinë. Ata na thanë se ajo ishte toka e tyre dhe se ne nuk kishim të drejtë të jetonim aty.

Kjo kasolle është një muajshe, por ne përsëri nuk ndihemi të sigurt këtu. *Gadjet* kanë ardhur këtu më shumë se dhjetë herë në këto tre ose katër vitet e fundit. Janë njerëz të ndryshëm që vijnë, të rinj dhe në moshë të thyer. Ata vijnë në orë të ndryshme të ditës. Në më të shumtën e rasteve ata vijnë natën, kur janë të dehur, por ndonjëherë edhe në mes të ditës. Ndonjëherë hyjnë brenda në shtëpi, por shumicën e rasteve qëndrojnë në grup jashtë shtëpisë. Ata kërkojnë sherr; ata gjithmonë kanë thika dhe ndonjëherë edhe armë. Ata gjuajnë në ajër dhe provokojnë konflikte me burrat tanë. Disa herë ata kanë zënë disa nga meshkujt tanë, i kanë lidhur dhe ju kanë prerë flokët.

Romët nuk kanë të drejta. Shumica nga ne kanë jetuar në të gjithë Beratin, por qëkur na shkatëruan shtëpitë ose na detyruan ti lëmë ato, ne u zhvendosëm këtu. Disa njerëz e lanë fare Beratin dhe u shpërngulën për në Fier ose në Elbasan.⁹³

Në Dhjetor 1995, shtëpia e 60 vjeçarit X.J. u shkatërua nga një grup shqiptarësh etnikë, e udhëhequr nga një familje e quajtur Q. Ngaqë anëtarët e familjes Q. Ishin policë, tendencat më të këqija të skenës bashkëkohore sociale shqiptare u implikuan për ta bërë jetën e zotit X.J. mizerabël. Ai i tregoi ERRC:

Ata u përpoqën të më nxjerrin nga shtëpia ime për gjashtë muaj të tërë përpara se ta shkatëronin atë, por unë nuk kisha ku të shkoja, kështu që qëndrova. Ata erdhën më shumë se 20 herë. Ata hynë brenda në shtëpi dhe më rrahën me grushta dhe me shqelma. Ata nuk treguan asnjë dokument ose diçka tjetër për të provuar se ajo ishte e tyre. Ata thjesht erdhën dhe më thanë se duhej të largohesha. Ishin të gjithë të familjes Q. Kjo është një familje e madhe *gadje* këtu në Berat. Këta ishin bosët e policisë në Berat, kështu që unë nuk mund të shkoja atje për ndihmë. Njëherë shkova në polici, por ata më thanë të zhdukem. Së fundi, një vit më parë, ata më shkatëruan shtëpinë. Ata e shëmbën atë duke i hedhur gurë.⁹⁴

Megjithatë, zoti X.J. ishte detyruar të vuajë më shumë se sa përzënia:

Pasi më shkatëruan shtëpinë, unë u arrestova nga policët ngaqë nuk i kisha lënë ata të merrnin tokën. U mbajta në gjykatë për pesë ditë dhe ata më rrahën gjatë gjithë kohës. Sapo hynin në qelinë time, fillonin të më rrihnin. Më gjuanin me shkelma dhe me shkopinj në të gjithë trupin. U rraha sepse nuk i lashë të merrnin shtëpinë time. Q. Ishte në rajonin e policisë. Ai më tha, " Nëse i tregon ndonjërit për këto, unë do të të vras." Tani Q. Nuk punon më në polici. Kam marrë vesh se është një shef i ri i policisë tani, por unë kam akoma frikë të shkoj atje.⁹⁵

Tani zoti X.J. banon në një shtëpi të vogël bashkë me 14 romë të tjerë.

Hivzi Bushati nga qyteti i Shqipërisë Veriore - Shkodër, Shef i Policisë së Beratit në kohën që ERRC po kryente misionin e saj në Dhjetor 1996, konfirmoi që ai zëvendësoi një person të quajtur S.Q. i cili ishte arrestuar pas dëshmive për korrupsion dhe aktivitet kriminal:

Unë u emërova këtu që më 1 Tetor 1996. Detyra ime është të vë rregull në Berat. Berati është një qytet me probleme të mëdha. Ai ishte një lloj qendre për një grup të mirë-organizuar të përfshirë në aktivitet kriminal me lidhje në Itali dhe Greqi. Policët këtu ishin inaktivë para ardhjes time, dhe shumë policë ishin përfshirë në këto krime. Shumica e udhëheqësve të këtij grupi tashmë janë arrestuar. Unë jam duke reformuar stafin e policisë, dhe po përjashtoj ata kundër të cilëve ka prova të mjaftueshme. Krimi është zvogëluar ndjeshëm që kur unë fillova punë. Njerëzit në Berat ishin të trembur nga policia, por ne ju kemi kthyer besimin.⁹⁶

I pyetur rreth shpërnguljeve me force të romëve në Berat, shefi Bushati u përgjigj:

Kam dëgjuar që romët këtu në Berat janë ankuar rreth rishpërndarjes së pasurisë, por me sa di unë, policët nuk janë implikuar në këte proces. Ne përpiqemi ti mbrojmë romët nga dhunimi i të drejtave dhe ju garantojmë sigurinë në të njëjtën mënyrë si edhe pjesës tjetër të popullatës.⁹⁷

⁹³ *European Roma Rights Center*, interviste me 29 vjeçarit N.Z., 7 Dhjetor 1996, Berat.

⁹⁴ *European Roma Rights Center*, interviste me X.J., 7 Dhjetor 1996, Berat.

⁹⁵ *European Roma Rights Center*, interviste me X.J., 7 Dhjetor 1996, Berat.

⁹⁶ *European Roma Rights Center*, interviste me Hivzi Bushati, shef i policisë së Beratit, 7 Dhjetor 1996, Berat.

⁹⁷ *European Roma Rights Center*, interviste me Hivzi Bushati, shef i policisë së Beratit, 7 Dhjetor 1996, Berat.

Në kundërshtim me pohimet e zotit Bushati, në Berat, kompetencat e dhëna policisë për të mbajtur rendin publik duket se janë keqpërdorur nga familje të caktuara lokale për të plaçkitur popullsinë lokale. Romët, veçanërisht të pambrojtur, ranë viktimë e këtij abuzimi të madh ndaj personave. Në Shqipëri, devocioni i policisë ndaj mandatit të tyre duket se varet më shumë nga dëshira e mirë e policëve sesa nga ndonjë kufizim i fuqisë së tyre.

Romët në zonën rrotull Bilishtit në Juglindje të Shqipërisë gjithashtu janë përzënë nga shtëpitë e tyre gjatë procesit të kthimit të tokës. Sipas udhëheqësit lokal të romëve zotit Mohammed Xhambazi,

Shumica e romëve në Shqipëri kanë shtëpi, por meqë ata nuk i kanë në pronësi të tyre, ata mund të përzihen nga to. Kështu ka ndodhur në Devoll në rrethin e Bilishtit pak kohë më parë. Nuk ka patur dhunë gjatë këtyre shpërnguljeve. Pronarët e vjetër-të rinj erdhën me dokumenta dhe romët që jetonin aty thjesht duhej të largoheshin.⁹⁸

Ndërsa përzënie nuk kanë qenë të tipit që ndodhën në Berat, risistemimi i individëve dhe familjeve të prekura nga ky proces, është bërë, siç përshkruhet nga zoti Xhambazi, në një mënyrë diskriminuuese. Për familjet e shpërngulura si pasojë e privatizimit të banesave ose rikthimit pronarit të dikurshëm, ka patur alternativa për të strehuar. Megjithatë, përveç një rasti të vetëm, këto mundësi alternative për strehim, sipas zotit Xhambazi, u janë ofruar vetëm shqiptarëve etnikë. Zoti Xhambazi i tregoi ERRC:

Unë shkova tek autoritetet e bashkisë njëherë për të ndihmuar 20 familje romë. Ata nuk kishin shtëpi, dhe unë shkova të takoj zëvendës kryetarin e bashkisë të Bilishtit për të kërkuar ndihmë. Ata do të shpërndanin shtëpi atë ditë. Ai ndihmoi vetëm një familje, dhe vetëm pasi në dhame rryshfet. Gjithë të tjerët që morën shtëpi ishin *gadje*.⁹⁹

Një grup romësh të cilët nuk kanë qenë përzënë, por që jeta e të cilëve u bë shumë më e komplikuar si pasojë e privatizimit dhe rindarjes së tokës, janë romët e Halilaj. Romët u vendosën në Halilaj në periferi të Fushë-Krujës, që gjendet afërsisht 20 km në veri të Tiranës, afërsisht 25 vjet më parë. Sot, në Halilaj banojnë afërsisht 1.200 romë. Ngulmimi rom i Halilaj është i ndarë nga pjesa tjetër e Fushë -Krujës nga një hapësirë e madhe fushe. Një nga fermerët lokalë aktualisht zotëron një pjesë të madhe të tokës së punuar si dhe tokën në të cilën romët ndërton Halilajn. Romët raportojnë se ai ka përdorur një seri taktikash për të detyruar ata të largohen. 30 vjeçari zoti N.K. i tregoi ERRC:

Kur në arritëm këtu, s'kishte asgjë tjetër veç shkurreve dhe pemëve. Ne pastruam të gjithë vendin dhe u sistemua. Asnjëri nuk erdhi këtu të na pyesë se kush ishim dhe për se erdhëm. Ne ngritëm *plasma*¹⁰⁰ dhe jetuam në paqe deri pak vjet më parë, kur disa nga ne filluan të shkojnë për punë në Greqi dhe mundën të fillojnë të ndërtojnë shtëpi të vërteta.

Pas kësaj, filluan problemet. U shfaq një burrë dhe tha se kjo ishte toka e tij dhe ju kërkoi familjeve me shtëpi të paguanin atij 70-80 US\$ sejcili si qera për copën e tokës së zënë nga një shtëpi ose *plasma*. Herën e parë që erdhi në paguam ngaqë kishim frikë se po të mos paguanim ai do të na i prishte shtëpitë.¹⁰¹

Fermeri që pretendonte të ishte i zoti i tokës i informoi gjithashtu romët e Halilaj se për çdo shtëpi të re ose *plasma* që ata do të ndërtonin ata duhej të paguanin afërsisht 5.000 US\$ për blerjen e afërsisht 16 m² truall të zënë nga shtëpia. Sipas zotit N.K., kjo ishte ideuar vetëm që të detyronte romët të iknin, dhe se shumica e metodave të përdorura nga fermerët kundër tyre synojnë të detyrojnë ata të largohen, ngaqë banorët vendas nuk duan arrixhinj përreth. Zoti N.K. i tregoi ERRC:

Fermeri vjen përherë e më shpesh për të mbledhur para nga ne. Nuk ka periudhë të rregullt. Ai vjen dhe kërkon qeranë kur ti teket.

Sot asnjëri nga ne nuk guxon të ndërtojë një shtëpi të re këtu. Sigurisht, asnjëri nuk ka 5.000 US\$ të paguajë, por sidoqoftë në dyshojmë që ai thjesht po luan me ne për të na detyruar të largohemi nga Halilaj.¹⁰²

Shfrytëzimi i romëve të Shqipërisë është ndoshta më i dukshëm atje ku ka interesa mbi pronësine mbi token. Në garën për të fituar pasuri e cila u ofrua papritur ndërsa Shqipëria po kalonte nga komunizmi në shoqërinë e tregut të lirë, romët janë përzënë nga ngulmimet të cilat ata i kanë populluar për dekada, ose janë detyruar të paguajnë gjoba tejet të larta për privilegjin e të qëndruarit. Romët paguajnë përherë e më tepër, sepse në çdo rast ata janë të padëshiruar, dhe qellimi i vërtetë është për ti

⁹⁸ European Roma Rights Center, interviste me Mohammed Xhambazin, 8 Dhjetor 1996, Bilisht.

⁹⁹ European Roma Rights Center, interviste me Mohammed Xhambazin, 7 Dhjetor 1996, Bilisht.

¹⁰⁰ Nje plasma eshte nje lloj tende e ngritur me copa hekuri dhe druri dhe e mbuluar me plasmas.

¹⁰¹ European Roma Rights Center, interviste me zotin N.K., 18 Korrik 1996, Fushe-Kruje.

¹⁰² European Roma Rights Center, interviste me zotin N.K., 18 Korrik 1996, Fushe -Kruje.

dëbuar ata.

4.2. ROMËT SI QYTETARË TË PAMBROJTUR

ERRC dokumentoi raste të ngacmimeve të romëve nga komunitete intolerante perreth, si dhe raste në të cilat romët ishin viktimë e sulmeve kriminale. Tipike për raste të tilla është që policia nuk është prezantuar si një institucion i zbatimit të ligjit dhe mbrojtës i qytetarëve.

Romët që sot jetojnë në Urën Vajgurore, një komunitet rural afërsisht 15 km në veri perëndim të Beratit në Shqipërinë e Mesme, u bënë gjithashtu viktimë e shpërnguljeve me forcë, edhe pse ata nuk i shikojnë sulmet e dhunshme të cilave ata u janë ushtruar në vendin e tyre të origjinës të lidhura me atë të rindarjes së tokës. 30 familje romë kanë jetuar në fshatin malor Guri i Bardhë, afërsisht 30 km në jugperëndim të Korçës në juglindje të Shqipërisë. Megjithatë vite më parë ata u shpërngulën prej aty. 19 nga familjet e shpërngulura erdhën në Urën Vajgurore. 55 vjeçarja zonja L.B. i tregoi ERRC:

Ne kemi jetuar në male në një fshat të vogël të quajtur Guri i Bardhë, por kishim probleme me *gadjet* kështu që na u desh të largohemi. Gangsterë të pirë vinin të na sulmonin shtëpitë dhe të na përzenin. Ata do të hynin në shtëpitë tona dhe do të na vidhnin rroba, batanije, çfarëdo që mund të gjenin. Më në fund vendosëm të largohemi. Kështu që romët u larguan. Ishim 30 familje që jetonin atje. Atje kishim jetuar për mëse 40 vjet.¹⁰³

Romët në qytetin Berat të Shqipërisë së Mesme gjithashtu kanë raportuar sulme dhe provokime nga shqiptarët etnikë. Përveç që janë bërë objekt i sulmeve violente nga grupe jo-romë lokale që hynin në getot romë, romët e rinj janë sulmuar regullisht nga gangsterë shqiptarë etnikë kur ishin jashtë lagjes së tyre dhe veçanërisht në rrugën për në ose nga tregu. 40 vjeçari Aishi X. i tregoi ERRC:

Ata donin para dhe mendonin se në kishim shumë. Kur fëmijët tanë shkojnë në Berat, njerëzit e bardhë i sulmojnë ata me thika dhe ju kërkojnë para. Ata na kanë sulmuar kaq shumë herë sa që tani në kemi frikë të shëtisim nëpër qytet. Rreth një javë më parë sulmuan djalin tim. Ai shkoi në pazar dhe në rrugën e kthimit, tre burra i zunë rrugën dhe donin parate e tij. Ai tha që nuk kishte dhe ata e rrahën.¹⁰⁴

Përveç sulmeve të rastit në rrugë, romët e Beratit raportojnë gjithashtu zhdukje të vajzave dhe nuseve të reja. Banorët vlerësojnë që të paktën tetë vajza të reja dhe adoleshente janë zhdukur nga komuniteti rom i Beratit në 12 muajt e fundit. E bija 17 vjeçare e zonjës P.K. u zhduk pasi kishte shkuar në tregun lokal një mëngjes të korrikut 1996.¹⁰⁵ Nga frika e policëve dhe mosbesimi zonja P.K. nuk raportoi se e bija mungonte.

Tashti vonë, në fillim të dhjetorit 1996, një javë para se ERRC të vizitonte komunitetin rom të Beratit, mbesa 11 vjeçarë e zonjës X.J. ishte rrëmbyer nga një grup burrash. Këta njerëz u kapën bashkë me vajzën nga policët në Elbasan po atë ditë vonë. Në këtë rast keqbërësit ishin romë.¹⁰⁶ Hivzi Bushati, shef i policisë së Beratit, i tha ERRC se përveç rastit të vajzës 11 vjeçare e cila ishte vjedhur një javë më parë, romët e Beratit nuk kishin bërë ndonjë denoncim në polici për zhdukjen e vajzave, por shtoi se ai shpresonte se ata do ta bënin në të ardhmen, duke premtuar se do të bënte gjithçka ishte e mundur për ti gjetur ato. Shefi Bushati shpjegoi gjithashtu që policia shqiptare kishte vendosur së fundi një bashkëpunim efektiv me policinë italiane dhe se kjo kishte mundësuar kthimin e një numri vajzash të cilat ishin grabitur dhe detyruar të punonin si prostituta në Itali.¹⁰⁷ ERRC është e shqetësuar se për shkak të mosbesimit të theksuar dhe frikës nga policia, romët nuk raportojnë humbjen e vajzave. Si rezultat i kësaj distance sociale, romët në të vërtetë privohen nga zhvillimet pozitive të ligjit të përshkuara nga shefi Bushati.

Incidente serioze dhunë kanë ndodhur së fundi në komunitetin rom të Levanit në Jugperëndim të Shqipërisë, afër qytetit të Fierit. Një mbasdite vonë në tetor 1996, 28 vjeçari zoti H.R pa tre burra të panjohur që po merrnin të bijën e tij tre vjeçare në rrugën kryesore të lagjes romë:

Kur i pashë ata me vajzën time, unë rrëmbeva një hu të madh dhe renda pas tyre për t'ju marrë vajzën. Unë u ndihmova nga të tjerë aty rrotull dhe pas disa përleshjesh, munda t'ua marrë bijën.¹⁰⁸

Sipas dëshmitarëve, tre burrat ishin të dehur dhe kishin armë. 23 vjeçari zoti I.D. i tregoi ERRC:

¹⁰³ *European Roma Rights Center*, interviste me L.B., 7 Dhjetor 1996, Ura Vajgurore.

¹⁰⁴ *European Roma Rights Center*, interviste me Aishi X., 7 Dhjetor 1996, Berat.

¹⁰⁵ *European Roma Rights Center*, interviste me 38 vjeçaren P.K., 7 Dhjetor 1996, Berat.

¹⁰⁶ *European Roma Rights Center*, interviste X.J., 7 Dhjetor 1996, Berat.

¹⁰⁷ *European Roma Rights Center*, interviste me Hivzi Bushatin, shef i policisë së Beratit, 7 Dhjetor 1996, Berat.

¹⁰⁸ *European Roma Rights Center*, interviste me zotin H.R., 6 Dhjetor 1996, Levan.

Ata u përpoqën të vjedhin një fëmijë për ta shitur në Itali. Ata e rrëmbyen atë dhe po kalonin nga kjo shtëpia këtu. Ne i pamë ata nga atje, nga oborri. Tre njerëz dhe një fëmijë. Ne vrapuam pas tyre dhe u përleshëm me ta. Ne i rrahëm dhe ata ja mbathën.¹⁰⁹

Por romët nuk u lanë të qetë pasi kishin penguar rrëmbimin e fëmijës. 35 vjeçari zoti I.O. i tregoi ERRC:

Ata u kthyen në mbrëmje rreth orës tetë, duke sjellë me vete 15 ose 20 njerëz. Ata erdhën në lokalim ngjitur dhe po kërkonin të merrnin hak. Unë u përzejva përsëri ngaqë kalova përpara barit në kohën e gabuar. Kisha klarinetën me vete - unë jam muzikant dhe isha rrugës për në punë. Ndërsa po kaloja barin vura re se brenda në bar po ziheshin. Pastaj dy shqiptarë dolën jashtë menjëherë dhe njëri mori një gur dhe më qëlloi në fytyrë. Gjithçka ndodhi kaq shpejt. Unë nuk e di pse e bënë këtë. Nuk i kisha parë asnjëherë më parë në jetën timë. Dy nga në u dëmtuan dhe duhej të shkonin në spital. Unë isha goditur në kokë, dhe tjetri, babai i fëmijës së vjedhur, ishte çarë me thikë poshtë syrit.¹¹⁰

Dëshmitarët i treguan ERRC se dikush nga komuniteti thërriti policinë gjatë përleshjes dhe se dhjetë policë arritën afërsisht pas gjysmë ore. Policët arrestuan dy shqiptarë etnikë, të cilët më vonë paguan policët dhe u liruan.

Zoti I.O. i tregoi ERRC se shqiptarët e arrestuar janë kthyer përsëri në Levan dhe kanë kërcënuar të vrasin romët. Gjatë kohës së vizitës së ERRC në dhjetor, romët meshkuj në Levan nuk mund të linin gratë dhe motrat të shkonin të pashoqëruara në qendër të Levanit për shkak të frikës së hakmarrjes nga popullsia lokale jo-romë:

Herën e fundit që ata erdhën ishte afërsisht tre javë më parë. Ata kaluan në rrugë, shumica me makina, dhe thërritën, "arixhinj të qelbur, në do t'ju vrasim!". Ne nuk duam probleme me asnjë. Ne duam të na lënë rehat por njerëz të tjerë gjithmonë na nxjerrin probleme. Tani në kemi frikë të shkojmë në qendër të Levanit me gratë dhe fëmijët tanë, sepse ka njerëz atje që duan të na dëmtojnë. Ne rrimë në komunitet dhe nuk dalim jashtë tij shumë shpesh.¹¹¹

Romët lokalë dëshmojnë të kenë qenë sulmuar nga jo romët disa herë përpara orvatjes për të vjedhur fëmijën dhe të nisnin tensionët. 45 vjeçari zoti R.D., një banor i ngulimit rom të Levanit, i tregoi ERRC:

Ndodh nganjëherë që *gadjet* vijnë këtu të bëjnë rrëmujë. Ata vijnë me thika dhe armë dhe provokojnë sherrin me në. Kjo ka ndodhur disa herë. Dimrin e kaluar, një grup shqiptarësh nga veriu¹¹² erdhën këtu, u dehën në barin e këtushëm dhe po vërdalloseshin në lagje duke sharë vajzat tona. Së fundi, i gjithë komuniteti doli jashtë nga shtëpitë dhe nisi sherrin. Megjithatë, unë munda të vë rregull mes tyre, dhe pastaj dikush këtu thirri policinë, e cila erdhi dhe arrestoi shqiptarët.¹¹³

Përveç incidentit me shqiptarët veriorë, zoti R.D. i tregoi ERRC:

Banorë nga zona të tjera jo larg Levanit vijnë gjithashtu ndonjëherë, zakonisht gjatë natës. Ata vijnë me thika, leva hekuri dhe hanxharë dhe duan të na rrahin. Si romë, në nuk kemi mbështetjen e jo-romëve. Ka shume njerëz që nuk na duan neve.¹¹⁴

Në përgjigje të këtyre sulmeve romët nuk e thërrasin policinë po qe se situata nuk mund të zgjidhet ndryshe.

Si rregull, në duam të rrojmë në paqe kështu që në përpiqemi të biem në ujdi me ata që vijnë dhe provokojnë sherr, por në situatat që nuk ka zgjidhje të tilla, nëve na duhet të tharrasim policinë sikundër bëjmë me shqiptarët e dehur nga veriu. Por problemi është që s policët nuk na duan neve. Nganjëherë kur ata vijnë, na rrahin, duke thenë që ishim në të cilët nisëm sherrin.¹¹⁵

¹⁰⁹ European Roma Rights Center, interviste me zotin I.D., 6 Dhjetor 1996, Levan

¹¹⁰ European Roma Rights Center, interviste me zotin I.O., 6 Dhjetor 1996, Levan.

¹¹¹ European Roma Rights Center, interviste me zotin I.O., 6 Dhjetor 1996, Levan.

¹¹² ndoshta shprehje e një natyre që nenkupton "vrasës"; stereotipi i verioreve në Shqipëri dhe Jugut është që ata janë brutale dhe të trashë (jo inteligjente).

¹¹³ European Roma Rights Center, interviste me R.D., 6 Dhjetor 1996, Levan.

¹¹⁴ European Roma Rights Center, interviste me R.D., 6 Dhjetor 1996, Levan.

¹¹⁵ European Roma Rights Center, interviste me R.D., 6 Dhjetor 1996, Levan.

5. TRAJTIMI DISKRIMINUES I ROMËVE

Në të gjithë Evropën Lindore dhe Qëndrore, romët janë detyruar të luftojnë me diskriminimin dhe racizmin. Shpesh në vende të tilla si Bullgaria, Republika Çeke, Rumania¹¹⁶ dhe Sllovakia¹¹⁷, ekziston një opinion popullor negativ predominues rreth të qënurit arixhi. Shumë shqiptarë jo-romë, megjithatë, kundërshtojnë idenë se në vendin e tyre ekziston racizëm kundër romëve. Një shef policie i cili donte të ngelej anonim i spjegoi ERRC arsyet e tij pse romët bëjnë një jetë të mirë në Shqipëri:

Nuk ka probleme racizmi në Shqipëri. Romët jetojnë në lagje të veçanta në periferi, gjë që është gjithashtu e mirë nga pikëpamja e sigurisë së tyre. Romët aktualisht janë shumë të varfër, të pistë dhe rëmujaxhinj, kështu që ata kanë më pak probleme nëse jetojnë të veçuar.¹¹⁸

Shumë shqiptarë me të cilët foli ERRC pretendojnë që, të paktën për një gjë ata e admirojnë "shpirtin e lirë" të romëve dhe suksesin me të cilin ata e kanë prezantuar kulturën e tyre tradicionale. Marcel Cortiade (i shqiptuar gjithashtu Kurtiade), një ekspert i romëve në Shqipëri thotë që ekziston një balancë e mirë midis armiqësisë dhe tolerancës në Shqipëri dhe se shumë shqiptarë tregohen shumë miqësorë dhe të gjendur me romët, megjithëse ai tërheq vëmendjen që keqësimi i gjendjes se tyre drejt një përjashtimi me të madh nga shoqëria shqiptareka shume te ngjare te ndodhe.¹¹⁹

Derisa "ruajtja e kulturës së tyre" shikohet si një cilësi pozitive për romët nga pjesa dërmuese e shoqërisë shqiptare, romët e Shqipërisë shpesh kënaqen me një lloj trajtimi diskriminues i cili ndryshon nga ai i provuar në shumë vende të tjera të rajonit: orvatja për ti detyruar ata të vazhdojnë të jetojnë "në mënyrë tradicionale". Shumë romë i raportuan ERRC se atyre shpesh u mohoheshin të drejtat bazë dhe shërbimet, ngaqë atyre u thuhej, "që nuk janë për ju" ose "mbahuni në mënyrat tuaja romë". Justifikimet e këtij lloji formuan bazën e një lloj trajtimi të veçantë, nga diskriminimi në ushtri deri tek mohimi i ujit të pijshëm të mjaftueshëm.

Sigurisht, jo të gjitha trajtimet diskriminuese nga ana e autoriteteve shqiptare e kanë bazën në këtë kënaqje të pranuar nga jo-romët. Romët në Shqipëri u janë nënshtruar gjithashtu trajtimeve armiqësore nga institucionet publike si ushtria, spitalet, shkollat, dhe autoritetet bashkiake. Këto ju mohojnë shpesh të drejtat bazë pa e justifikuar këtë lloj trajtimi me asnjë argument të rremë që romët meritojnë dhe gëzojnë përjashtimin.

Dëmi i vërtetë i shkaktuar nga qëndrimet diskriminuese vepron në mënyra tinzare, qetësisht, në marrëdhëniet midis njerëzve nga dita në ditë. Megjithatë, romët e dinë si shikohen nga shoqëria shqiptare dhe reagojnë në përputhje me të. Një i ri rom në Baltëz, afër Fierit, i tregoi ERRC:

Romët trajtohen njësoj nga shqiptarët. Ata nuk e thonë atë, por ata veprojnë si të jemi inferiorë. Është shumë e vështirë të kesh shokë të mirë ose të martohesh me një shqiptarë. Ata mendojnë që në nuk jemi të pastër.¹²⁰

Dyshimi që romët nuk pranohen nga jo-romët në Shqipëri u mbështet nga një burrë shqiptar nga Tirana, zoti A.K., i cili i tregoi *the Human Rights Project*, se në opinionin e shumicës së shqiptarëve,

Romët nuk janë në nivelin e shqiptarëve, as në aspektin material e as në atë shpirtëror. Ka edhe diçka tjetër që i ndan romët nga shqiptarët. Është morali i tyre, ose më mirë mungesa e moralit të tyre. Shqiptarët nuk pëlqojnë të kenë martesë të përziera me romët, sepse moraliteti i tyre është shumë i ulët. Ata nuk janë të qëndrueshëm në familje, ata nuk kanë rregulla.¹²¹

Dhe, në opinionin e një sociologu nga Tirana, Nëse romët kanë para, ata i prishin ato për budallallëqe.¹²²

5.1 DISKRIMINIMI NGA AUTORITETET LOKALE

Neni 253 i Kodit Penal të Shqipërisë e cileson si kriminale "dhunimin e barazisë së qytetarëve".¹²³ Megjithatë, romët në

¹¹⁶ Shiko raportin e *European Roma Rights Center, Sudden Rage at Dawn: Violence Against Roma in Romania* September, 1996.

¹¹⁷ Shiko raportin e *European Roma Rights Center, Time of Skinheads: Denial and Exclusion of Roma in Slovakia*

¹¹⁸ *European Roma Rights Center*, interviste me oficerin e police X, shef i policisë së Fushe-Krujes, 18 Korrik 1996, Fushe-Kruje.

¹¹⁹ Kutiade, cituar me pare, pp. 10-14.

¹²⁰ *European Roma Rights Center*, interviste me L.K., 13 Korrik 1996, Baltez.

¹²¹ *European Roma Rights Center*, interviste me zotin A.K., një burrë shqiptar nga Tirana, Janar 1996, Tirane.

¹²² *European Roma Rights Center*, interviste me zotin Z.D., sociolog, 20 Korrik 1996, Tirane.

shumë komunitete të vizituara nga ERRC raportuan trajtime diskriminuuese ose praktika arbitrare nga ana e autoriteteve përgjegjëse për shërbimet sociale si p.sh. Zyra e assistencës sociale, infrastrukturës bashkiake, dhe kujdesit shëndetësor.

Romët në Delvinë, për shembull, jetojnë në një lagje të veçuar në të tatëpjetët të qytetit. Një problem kryesor për romët e Delvinës është mungesa e ujit. Udhëheqësi lokal Selamet Musta i tregoi ERRC:

Pjesa dërmuese e romëve këtu jetojnë pa patur ujë. Është një tubacion që vjen për këtu, por *gadjet* e fshatit e thyejnë atë rregullisht. Ata e bllokojnë linjën. Unë e di kush janë ata, por autoritet nuk ndërmarin asnjë veprim. Ata më thanë, " Të bardhët kanë të drejtë, por jo juve. Ju duhet të jetoni në tenda, si nomadët, dhe të merrni ujë nga lumi, siç keni bërë gjithmonë."

Ne shkuam në një ndërmarje private për t'ju thënë të na sjellin ujin këtu lart, por ata donin 5.000 US\$ për të. Ne jetojmë si në kohën e luftës; në nuk shpresojmë për ujë. Ata duan para, por në nuk i kemi ato.¹²⁴

Në një rast tjetër, një përfaqësues i Këshillit Bashkiak të Delvinës i tha zotit Musta, "Ju duhet të jetoni në tenda , sepse kjo është menyra juaj. Ju nuk keni të drejta si qytetare."¹²⁵

Nje problem tjetër i ngjashem me të cilin ERRC u ndesh, ishte ai i katër familjeve romë në Urën Vajguore të përzëna nga Guri i Bardhë. Në kohën e vizitës së ERRC, 55 vjeçarja zonja L.B. dhe nusja 30 vjeçare e djalit të saj R.K. banoni bashkë me disa fëmijë të tyre dhe disa kafshë, në një tendë që ata e kishin ndërtuar në një shesh plot baltë afër fshatit të tyre Ura Vajguore. Ata ishin detyruar ta linin shtëpinë me gjithë ç'kishin ngaqë lumi kishte dale nga shtrati. Përveç faktit që shtëpia e tyre përmbitej nga lumi çdo vit, autoritetet lokale nuk i lenë ata të largohen nga lumi:

Jemi këtu që prej një jave. Kjo ndodh çdo vit. Ne ju kemi kërkuar autoriteteve lokale të na japin një vend larg lumit, por ata thanë që nëve duhet të rrimë tek lumi. Ata nuk na konsiderojnë nëve qenie njerëzore. Ata thonë, "Rrini aty ku jeni."

Ne nuk kemi as punë, as para, as ndihmë, por të paktën këtu në Urën Vajguore në nuk kemi problemet që kishim me *gadjet* në Gurin e Bardhë. *Gadjet* këtu na lenë rehat, edhe pse nuk na pranojnë në qendër të fshatit.¹²⁶

Romët i janë nënshtruar gjithashtu trajtimeve diskriminuuese në grup në rrethinat e Halilaj në Fushë-Krujë kur, në përgjigje të pamundësisë së disa familjeve për të paguar faturat e energjisë elektrike, autoritetet ndërprejnë furnizimin me energji elektrike të të gjithë komunitetit. Gjatë kohës që ERRC vizitoi Halilaj në korrik 1996, energjia elektrike ishte prerë prej një muaji. 30 vjeçarja zonja X. Ju rrëfye ERRC:

Çdo muaj, në duhej të paguanim 500 lekë [afërsisht 5 US\$] për familje për elektricitetin. Nuk ka sahatë, kështu që nuk ka fare rëndësi sa shumë konsumojmë. Ne gjithmonë paguanim të njëjtën kuotë. Muajin e fundit, kur disa nga familjet tona nuk kishin para të paguanin, ata vendosën të na e presin korentin të gjithëve.¹²⁷

Romët e Halilaj i treguan ERRC se ata kishin kërkuar ndihmë tek autoritetet lokale, por ata s'ju kishin ofruar asgjë. Sipas kryetarit të bashkisë së Fushë-Krujës, zotit Salaku, kushtet e banimit të romëve ishin mjaft më të mira se e përgjithshmja e të gjithë qytetit. Në lidhje me romët e Halilaj ai u shpreh, "Ata gëzojnë barazi dhe në standarte të caktuara ata janë të privilegjuar."¹²⁸

Për një vrojtues të jashtëm romët e Halilaj jane shume larg te qenurit te privilegjuar. Është e vështirë të imagjinosh se si një popullatë e privilegjuar mund të ndëshkohet në mënyrë kolektive për disa fatura energjie të papaguara nga disa individë. Në të gjithë Shqipërinë, ERRC verejt qe mungon infrastruktura bazë dhe shërbimet publike në rrethinat ku jetojnë romët. Romët duhet të paguajnë për shërbimet publike bazë dhe shumë besojnë që ata duhet të paguajnë më shumë se jo-romët. Sipas zonjës 36 vjeçare F.X., në Bilisht në përgjithësi, kur ke punë me autoritetet:

¹²³ Neni 253 thote: " Berja e dallimeve, per arsye detyre ose gjate ushtrimit te saj, nga nje i punesuar ne funksion shteteror ose ne sherbim publik, ne baze te origjines, seksit, kushteve shendetesore, besimit fetar, bindjeve politike, aktivitetit sindikalist ose perkatesise se tij ne nje grup te vecante etnik, nacional, racial ose fetar, i cili rezulton ne privilegje te paligjshme ose ne refuzimin e nje te drejte ose perfitimt qe rrjedh nga ligji, denihet me deri ne pese vjet burgim. Perkthimi jozyrar ne Anglisht nga Kathleen Imholz. Shiko gjithashtu ICCPR, Neni 2(1) dhe 26.

¹²⁴ *European Roma Rights Center*, interviste me Selamet Musta, 4 Dhjetor 1996, Delvine.

¹²⁵ *European Roma Rights Center*, interviste me Selamet Musta, 4 Dhjetor 1996, Delvine.

¹²⁶ *European Roma Rights Center*, interviste me R.K., 7 Dhjetor 1996, Ura Vajguore.

¹²⁷ *European Roma Rights Center*, interviste me zonjen X., 18 Korrik 1996, Fushe-Kruje.

¹²⁸ *European Roma Rights Center*, interviste me Kryetarin e Bashkise Monder Salaku, 18 Korrik 1996, Fushe-Kruje.

Kudo që të shkosh, ata duan para. Në bashki, në polici, kudo. Nuk mund të bësh asgjë pa para. Në spital, po nuk pagove, ata ta lenë fëmijën të vdesë. Ata nuk bëjnë asgjë pa para. Djali im kishte probleme me apandisitën dhe duhej të operohej. Unë pagova 400 US\$ për operacionin, doktorët, infermieret, për këdo. Zyrtarisht, supozohet të jetë pa pagesë.¹²⁹

Në Maliq, afër Korçës, romët i thanë ERRC se është e pamundur të përfitosh kujdes shëndetësor pa paguar rryshfete. Gruaja e 30 vjeçarit Fatmir Rexha, Lindita, u operua tre herë nga stomaku gjë që i kushtoi familjes 1.000 US\$ në dhjetor 1996.¹³⁰ Zonja Rexha i tregoi ERRC se "që nga demokracia", shqiptarët etnikë përfitojnë asistencë sociale, ndërsa romët jo:

Në zyrën e asistencës sociale ata na thonë, "Ju keni pak tokë, kështu që ju nuk përfitoni asgjë." Ka shumë korrupsion këtu. Ne madje kemi pushuar së prituri ndihmë.¹³¹

Disa romë raportuan gjithashtu se ata nuk merrnin asistencë sociale për të cilin ju ishte dhënë e drejta. Në lagjen *Azotik*, vendbanim i afërsisht 1400 romëve, banorët ankoheshin se ata nuk kishin marrë asnjë asistencë sociale nga shteti që prej 1993. Ata nuk kishin punë dhe e vetmja mënyrë për të mbijetuar siç thanë ata, ishte të shkonin për punë sezonale në Greqi ose Itali. Hekuran Zoto, udhëheqës i komunitetit, i tha ERRC se ai kishte qenë tek autoritetet lokale administrative disa herë për të pyetur për asistencën sociale, ku i kishin thënë se ndihma sociale ishte prerë për të gjithë dhe se romët duhej të ndihmonin veten.¹³² Megjithatë, në zona të tjera të Fierit, ERRC zbuloi se asistencë sociale nuk ishte ndërprerë, gjë që sugjeron një diskriminim të mundshëm të këtij komuniteti nga autoritetet lokale. Për më tepër, gjithandej nëpër Shqipëri ERRC ju tha që pagesat e ndihmës sociale ishin midis 1800 dhe 2500 lekë (në atë kohë afërsisht 18 deri 25 US\$) për muaj.

Statusi i asistencës sociale të romëve të Beratit është akoma i paqartë. Romët atje marrin asistencë sociale, por shuma e lekëve që ju japin ndryshon arbitrarisht çdo muaj dhe kështu i qytetit ju tha atyre se së shpejti ndihma do të ndërpritet plotësisht:

Ne marrim asistencë sociale në fund të muajit, por ajo ndryshon çdo muaj. Herën e fundit, ajo ishte vetëm 5-6 US\$ për familje. Pak kohë më parë, ajo ishte 11 US\$, por kurrë nuk ka qenë më shumë se kaq. Nganjëherë ata më thonë se nuk do na japin më para, por të paktën deri tani unë kam marrë diçka çdo muaj. Por ama ta dini, kjo nuk prish asnjë punë sepse unë kam 12 fëmijë dhe më duhet të blej 10 bukë në ditë, kështu që për mua, kuota e ndihmës sociale më del vetëm për një ditë.¹³³

Në opinionin e Kryetarit të Bashkisë Monder Salaku, problemi kryesor i romëve është "jo strehimi, por edukimi dhe papunësia. Do të ishte më mirë për ta nëse ata binin dakord të jetonin mes shqiptarëve sepse ata mund të integroheshin shumë më lehtë në këtë mënyrë, por ata nuk duan kështu."¹³⁴

5.2. DISKRIMINIMI NË USHTRI

Romët me të cilët foli ERRC raportuan abuzime dhe trajtime poshtëruese në ushtrinë shqiptare. Në disa raste, ky trajtim poshtëruese ka qenë në formën e përjashtimeve të romëve nga detyra të vështira dhe rregjimi i shërbimit të regullt ushtarak mbi baza etnike, me motivin që romët nuk janë të përshtatshëm për to. Sidoqoftë, trajtime të tilla janë arbitrare. ERRC dokumentoi raste shqetësuese në të cilat romët u janë nënshtruar abuzimeve fizike dhe torturës në ushtri. 23 vjeçari Vladimir Majko dhe 19 vjeçari Petrit Musta, të dy banorë të Delvinës në Shqipërinë e jugut, raportuan tortura sistematike dhe poshtërimet nga shokët ushtarë dhe eprorët ndërsa po kryenin shërbimin ushtarak në ushtrinë shqiptare në Sarandë, afërsisht 15 km më në jug të Delvinës. Vladimir Majko i tregoi ERRC eksperiencën e tij në ushtri:

Ne ishim të vetmit romë midis 600 ushtarëve. Ka qenë shumë keq në ushtri. Ushtarët e reparitit tonë na rrihnin dhe na quanin "zezakë" dhe "arixhinj të qelbur". Çdo ditë gjatë vakteve të ushqimit, të tjerët pështynin në ushqimin tonë dhe na detyronin ta hanim. Ne duhej të flinim në dhoma të veçanta dhe gjithmonë na duhej të bënim punët më të pista. Nuk është se punonim të veçuar, por të tjerët na urdhëronin të bënim edhe punën e tyre. Nëse në refuzonim, ata do të na rrihnin.

Kur erdhën ushtarët e rinj, ata gjithashtu filluan të na rrihnin. Kur në ankoheshim për mënyrën si na trajtonin ushtarët e tjerë, na fushnin në izolim. Unë jam futur në izolim pesë herë. Ne kishim marëdhënie të

¹²⁹ *European Roma Rights Center*, interviste me zonjen F.X., 8 Dhjetor 1996, Bilisht.

¹³⁰ *European Roma Rights Center*, interviste me Fatmir Rexha, 8 Dhjetor 1996, Maliq.

¹³¹ *European Roma Rights Center*, interviste me Lindita Rexha, 8 Dhjetor 1996, Maliq.

¹³² *European Roma Rights Center*, interviste me Hekuran Zoto, 5 Dhjetor 1996, Lagja Azotik, Fier.

¹³³ *European Roma Rights Center*, interviste me Aishi X., nje grua rome 40 vjece, 7 Dhjetor 1996, Berat.

¹³⁴ *European Roma Rights Center*, interviste me kryetarin e bashkisë Monder Salaku, 18 Korrik 1996, Fushe-Kruje.

mira me njërin nga oficerët, por të tjerët ishin të gjithë të këqinj. Shumica e oficerëve gjithashtu na rrihte. Ata na quanin "arixhi". Ndihehim kaq keq atje sa që donim të transferoheshim, kështu që shkuam të takojmë shefin e bazës dhe i treguam atij gjithçka. Ai u përgjigj, "Ju jeni arixhinj, në nuk e çajmë kokën si ndiheni ju."¹³⁵

Pas një muaji në ushtri, ushtarëve të repartit u jepej dy ditë leje të shkonin në shtëpi, por Vladimiri dhe Petriti i thanë ERRC se ata nuk ishin lejuan të shkojnë pa i paguar 15,000 dhrahmi greke sejcili shefit të tyre. I njëjti oficer i tha njëherë Vladimirit kur ky ishte sëmurë, "Edhe po të vdesësh në rregull jemi, ti arixhi je." Ai u lejua të shkojë në shtëpi pas gjashtë muajsh shërbim, në shtator 1995.¹³⁶

Vladimir Majko dhe Petrit Musta dezertuan nga ushtria pas dhjetë muajsh shërbim në Shkurt 1996, dy muaj përpara se të liroheshin. Vendimi i tyre për t'ja mbathur është marrë menjëherë pas një incidenti gjatë të cilit një ushtar sulmoi Vladimirin dhe i drejtoi armën e mbushur:

Në Shkurt 1996, unë pothuajse u vrava nga një ushtar i repartit tonë. Ai më kishte rënë në qafë më parë, por atë ditë, ai më ngacmoi përsëri. Në mëngjes ai më rrahu pasi kishim marrë detyrat e ditës- thjesht më rrahu. Dhe pastaj më vonë më drejtoi armën në fytyrë. Unë jam i sigurt që ai donte të më vriste por një komandant e pa se ç'po ndodhte dhe ndërhyri. Unë shkova tek oficeri im dhe i tregova çfarë ndodhi, por ai tha që isha unë ai që nisi sherrin dhe mori një shkop dhe më rrahu në shpinë.

Pastaj më vunë në izolim. Shefi i bazës donte të më takonte kështu që ata më sollën tek ai për të biseduar. Unë i tregova historinë, por ai tha që ishte faji im dhe më futi përsëri në izolim për 20 ditë. Në qelinë e izolimit kishte vetëm një krevat pa mbulesë. Rrallë më jepnin ndonjë gjë për të ngrënë dhe për të pirë për të 20 ditët. Pasi më nxorën, unë dhe Petriti vendosëm që kishim duruar mjaft. Ne u larguam pas pak kohe dhe shkuam në shtëpi në Delvinë.¹³⁷

Pak ditë pasi dy djemtë ishin larguar nga ushtria, dy oficerë të policisë ushtarake erdhën të marrin vesh arsyen e mungesës së tyre. Pasi ju shpjeguan dy oficerëve pse ishin larguar, ata i thanë Vladimirit dhe Petritit se nëse kjo ishte e vërteta, ata nuk do të ndëshkoheshin nga asnjë lloj mase disiplinore.¹³⁸

Megjithatë, dy djemtë u akuzuan për dezertim dhe u dënuan me nga 7 muaj burgim. Asnjë nga djemtë nuk ishte në gjyqin që u zhvillua në Delvinë në tetor 1996. Të dy thonë që nuk ishin lajmëruar për gjyqin, madje as për akuzën që ishte ngritur kundër tyre. Ata i thanë ERRC se morën një telegram tre ditë më vonë pas gjyqit në të cilin thuhej se ata ishin gjetur fajtorë për dezertim dhe për të cilin ata ishin dënuar me shtatë muaj burgim.¹³⁹

Dy djemtë pajtuan një avokat dhe apeluan kundër vendimit të gjyqit. Në seancën e dytë që u mbajt në 2 Dhjetor 1996, trupë gjykues i Tiranës e hodhi poshte apelin, dhe gjatë kohës që ERRC po shqyrtonte rastin, apeli i tyre i dytë po shqyrtohej nga Gjykata e Kasacionit e Tiranës.

Sipas Petrit Musta, kur ata ishin në ushtri, 20 ushtarë jo-romë e lanë ushtrinë pa leje dhe asnjëri prej tyre nuk pati probleme disiplinore:

Ne ishim të vetmit dezertorë që u dënuam. Ndërkohë që në ishim në ushtri, 20 njerëz u larguan pa leje, por asgjë nuk u ndodhi, përveç që ata duhej të ktheheshin prapë për të mbaruar ushtrinë. Kur ikëm në nga ushtria, çështja shkoi në gjyq.¹⁴⁰

Ai i tregoi ERRC gjithashtu që ai u kthye në repart në Sarandë për të mbaruar shërbimin, por nuk u pranua:

Ata nuk më pranuan përsëri. Ata më thanë që meqë ishim arixhinj, ata nuk na donin përsëri. Ata thanë që do të përpiqeshin të na kthenin prapë në burg, siç e meritonim.¹⁴¹

ERRC i ka dërguar një letër ku shpreh shqetësimin e saj Prokurorit të Përgjithshëm të Shqipërisë, duke i kërkuar komente për këtë rast. Deri sot, ERRC nuk ka marrë asnjë përgjigje nga prokurori i përgjithshëm.

¹³⁵ *European Roma Rights Center*, interviste me Vladimir Majko, 4 Dhjetor 1996, Delvine.

¹³⁶ *European Roma Rights Center*, interviste me Vladimir Majko, 4 Dhjetor 1996, Delvine.

¹³⁷ *European Roma Rights Center*, interviste me Vladimir Majko, 4 Dhjetor 1996, Delvine.

¹³⁸ *European Roma Rights Center*, interviste me Petrit Musta, 4 Dhjetor 1996, Delvine.

¹³⁹ *European Roma Rights Center*, interviste me Vladimir Majko dhe Petrit Musta, 4 Dhjetor 1996, Delvine.

¹⁴⁰ *European Roma Rights Center*, interviste me Petrit Musta, 4 Dhjetor 1996, Delvine.

¹⁴¹ *European Roma Rights Center*, interviste me Petrit Musta, 4 Dhjetor 1996, Delvine.

5.3. DISKRIMINIMI NË SISTEMIN ARSIMOR

Në një pjesë të madhe të komuniteteve romë të vizituara nga ERRC, fëmijët nuk shkojnë në shkollë. Prindërit pretendonin që fëmijët e tyre rriheshin dhe poshtëroheshin nga fëmijët jo-romë dhe kishin frikë të shkonin në shkollë. Ata gjithashtu raportuan diskriminime nga mësuesit dhe ankoheshin se shkollat ishin shumë larg dhe ishte e rrezikshme të shkoje atje.

Në të paktën dy komunitete, fëmijët përgjithësisht e linin shkollën para klasës së katërt ose menjëherë mbas mbarimit të saj. Kjo është shkurajuese, ngaqë prindërit e tyre dhe shumica e atij brezi kanë mbaruar tetëvjeçaren. Në Maliq, afër Korçës në Shqipërinë e Jugut, 25 vjeçarja Lindita Rexha i tregoi ERRC:

Fëmijët romë në shkollë tani trajtohen ndryshe nga të tjerët. Dy vjet më parë kur motra ime Lefteri ishte tetë vjeçe, ajo kishte probleme në shkollë. Ajo nuk ishte një nxënëse shumë e mirë, por në vend që ta ndihmonin ata e dërguan në shtëpi. Ajo nuk u pranua më. Ata nuk përpicën ti mësojnë fëmijët tanë. Fëmijët romë vihen në fund të klasës dhe mësuesit nuk kujdesen për ta. Rezultati i kësaj është që fëmijët tanë kurrë nuk e mbarojnë shkollën. Sot, ata zakonisht ndërpresin shkollën pas klasës së katërt, ndërsa në mbaronim të paktën tetëvjeçaren.

Tani bija ime nuk dëshiron të shkojë përsëri në shkollë. Ajo ka frikë nga fëmijët e tjerë dhe nuk u beson mësuesve. Fëmijët e tjerë në klasë e kanë rrahur ndonjëherë, dhe e thërrasin "arixhi i qelbur". Ajo ishte i vetmi fëmijë rom në klasë.¹⁴²

30 vjeçari Fatmir Rexha, i jati i Lefterisë, tha që për të njëjtat arsye, dy fëmijët e vëllait të tij kishin lënë shkollën, dhe mendonte që një shkollë e veçantë për romët në Maliq ishte e vetmja zgjidhje.¹⁴³

Ne Berat, shkolla është vetëm 200 metra nga lagjia-geto në të cilën romët e këtij qyteti janë detyruar të banojnë. Shumica e fëmijëve nuk e vazhdojnë shkollën edhe këtu, ngaqë ata kanë lidhje shumë negative me shkollat, mësuesit dhe fëmijët e tjerë. 40 vjeçarja Aishi X., Nëna e 12 fëmijëve, spjegoi:

Shumica e *gadjeve* janë të mirë kur janë të rinj, por ndërsa rriten, ata ndryshojnë, dhe zemrat e tyre shndërohen në gurë. Ka ca fëmijë *gadje* këtu që vijnë të luajnë me fëmijët tanë, por përsëri, jo të gjithë janë të mirë. Në shkollë fëmijët tanë janë rrahur, dhe tani ata nuk duan të shkojnë në shkolla. Disa nga fëmijët këtu shkojnë në shkollë, por shumica e ka lënë atë.¹⁴⁴

Situata është njësoj e zymtë në shumë zona rurale të vizituara nga ERRC. Zonja Meleqe Rainë, një mësuese e shkollës fillore me origjinë romë nga komuniteti i Moravës, afërsisht pesë km nga Berati, i spjegoi ERRC:

Në Moravë romët përbëjnë afërsisht 45% të popullatës. Përveç faktit që janë afërsisht 400 fëmijë të cilët duhet të jenë në shkollë, vetëm 250 prej tyre ndjekin shkollën. Kjo do të thotë që shumica e romëve nuk janë në shkollë.

Fëmijë romë të moshës së kopështit, gjithashtu rrinë në shtëpi. Deri në 1991, këtu në Moravë kishte dy kopështë. Njëri prej tyre ishte në lagjen romë. Ne 1991, kur kooperativa lokale, të cilës i takonin kopshtet, u mbyll, ata mbyllën edhe kopshtet. Shteti nuk bëri asgjë për të siguruar vazhdimësinë e tij, përveç faktit që mësuesit të cilët punonin atje u përpoqën ta rihapin atë për një vit. Kopështi tjetër kërcënohej nga i njëjti fat, por autoritetet gjetën një zgjidhje për ta shpëtuar atë. Problemi tani është që ky kopësht që ka mbetur është larg nga lagjia romë. Për më tepër, këtu ka shumë më tepër fëmijë nga sa mund të mbajë ky kopësht.¹⁴⁵

Fëmijët romë raportojnë se sa herë që debate të çdo lloji lindin mes fëmijëve, si mësuesit edhe fëmijët i quajnë ata "arixhinj të qelbur" ose "arixhinj budallenj". Ata thonë gjithashtu që mësuesit zakonisht përdorin dënimet fizike kundër tyre, ndërkohë që fëmijët jo-romë kurrë nuk rrihen. Sipas shumicës së fëmijëve të intervistuar nga ERRC, mësuesit janë më pak

¹⁴² *European Roma Rights Center*, interviste me Lefteri dhe Lindita Rexha, 8 Dhjetor 1996, Maliq.

¹⁴³ *European Roma Rights Center*, interviste me Fatmir Rexha, 8 Dhjetor 1996, Maliq.

¹⁴⁴ *European Roma Rights Center*, interviste me Aishi X., 7 Dhjetor 1996, Berat.

¹⁴⁵ *European Roma Rights Center*, interviste me Meleqe Raine, 13 Korrik 1996, Morave.

tolerantë me ta se me fëmijët e tjerë për shkak të origjinës së tyre etnike.¹⁴⁶ Në maj 1996 në Tiranë, 9 vjeçari Valter Duka u përjashtua nga shkolla një muaj para mbarimit të vitit shkollor sepse ai shkoi në shkollë pa libra. Ai i tregoi ERRC se një ditë më parë, ai kishte patur një grindje me motrën e tij më të vogël sepse ajo donte të luante me librat e tij të shkollës dhe nëna e Valterit e kishte zgjidhur konfliktin duke i flakur librat tutje.¹⁴⁷

Situata në komunitetin e Lagjes Azotik në Fier në Shqipërinë Jugore është tipik. Prindërit nuk duan ti dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë ngaqë shumë fëmijë janë rrahur nga nxënësit e tjerë. Ata gjithashtu ankoreshin për distancën e largët (tre km) deri tek shkolla më e afërt, dhe thanë që kishin frikë mos fëmijët e tyre shtypeshin nga makinat ose trenat rrugës për në shkollë.¹⁴⁸ Hekuran Zoto, udheheqësi i komunitetit të lagjes Azotik, u tregoi ERRC se megjithëse komuniteti i Baltezës, një tjetër komunitet i madh rom afër Fierit, ka shkollën e vet romë, ata nuk e duan një gjë të tillë në lagjen Azotik:

Ne do të donim të kishim një shkollë këtu ngjitur, por jo të ndarë nga gadjet. Ne duam një shkollë të integruar. Ne ketu jemi kundër paragjykimëve raciale.¹⁴⁹

Arsyet e frekuentimit të ulët të shkollave nga fëmijët romë në Shqipëri janë, jo gjithmonë të lidhura me mënyrën si fëmijët e tjerë dhe mësuesit i trajtojnë ata. Romët në komunitetin lokal përreth Beratit në Shqipërinë Qendrore besojnë që fëmijët e tyre do të shtypeshin nga makinat rrugës për në shkollë.¹⁵⁰ Për më tepër, ata kanë frikë gjithashtu që fëmijët e tyre mund të grabitën. Sipas mësueses së shkollës fillore Meleqe Rainë në Moravë dhe kerkimeve të ERRC, kjo frikë është e justifikuar: shumë fëmijë janë rrëmbyer rrugës për në shkollë ose duke u kthyer prej saj në këtë zonë në vitet e fundit.¹⁵¹

Në komunitetin e Zinxhiraj në periferi të Gjirokastrës, fëmijët mungojnë nga shkolla, sepse siç i spjeguan banorët ERRC, çdo vit nga prilli në tetor i gjithë komuniteti largohet për në Greqi për punë sezonale si vjelja e domateve dhe portokalleve.¹⁵² Në mënyrë të ngjashme, 16 vjeçari Kasriot Demiri e la shkollën pas klasës së katërt në komunitetin juglindor të Pojanit afër Korçës; ai preferoi të punojë me kuajt, një praktikë tradicionale romë. Motra e tij 7 vjeçare Adelina, nga ana tjetër, tha që i pëlqente shkolla dhe nuk donte ta linte atë.¹⁵³

Përveç autoritetit ligjor,¹⁵⁴ autoritetet lokale përgjegjëse për punët e arsimit duket që nuk kanë marrë masat e duhura për të ndaluar këtë fenomen në rritje të braktisjes së shkollës nga fëmijët romë. Autoritet lokale e justifikojnë pasivitetin e tyre duke argumentuar që, "Romët nuk duan të çojnë fëmijët e tyre në shkollë, kështu që pse ti detyrojmë ata?" Monder Salaku, Kryetari i Bashkisë së Fushë-Krujës, e spjegoi kështu për ERRC fenomenin e mos frekuentimit të lartë të shkollës nga fëmijët romë në komunitetin e tij: "Unë mund ti gjobitja ata, por ata janë kaq të varfër për ti paguar këto gjopa, saqë unë nuk bëj dot ndonjë gjë të madhe."¹⁵⁵

ERRC beson se ekzistojnë alternativa më frytdhënëse se gjobitja e prindërve për frekuentimin e ulët nga fëmijët e tyre. ERRC mbështet idenë që është detyrë e autoriteteve shqiptare të shqyrtojnë si shqetësimin e prindërve ashtu edhe atë të fëmijëve për trajtimin e pabarabartë dhe distancën e shkollave nga komunitetet romë, sesa t'ja atribuojnë nivelin e lartë të largimit nga shkollat urrejtes ndaj edukimit nga ana e popullsisë romë.

Jevgjit, gjithashtu, raportojnë diskriminim dhe racizëm në sistemin shkollor. Ali Sadiku, vetë me origjinë jevge, i tregoi ERRC:

Shpesh në trajtohemi si romët ngaqë e kemi lëkurën të zezë. Nganjëherë shqiptarët e tjerë na quajnë "të zinj". Gjithçka varet nga mënyra si njerëzit janë rritur. Fëmijët, prindërit e të cilëve janë të mirë, nuk bëjnë dallim midis fëmijëve tanë dhe të tyre.¹⁵⁶

¹⁴⁶ *European Roma Rights Center*, intervista me Alfredin 9 vjeçar, Eduardin 14 vjeçar, Emanuelen 11 vjeçare, Lavdien 10 vjeçare, Lencin 10 vjeçar, Romeon 12 vjeçar dhe Valterin 9 vjeçar, Korrik 1996, Tiranë.

¹⁴⁷ *European Roma Rights Center*, intervista me Valter Duka, 19 Korrik 1996, Tiranë.

¹⁴⁸ Romët kanë jetuar në lagjen Azotik që nga 1950a. 20 vjet më parë, një hekurudhe ishte ndërtuar përmes komunitetit, duke e ndarë atë në dy pjesë. Romët e Fierit raportuan që kjo ishte bërë pa marrë parasysh protestat e tyre. Disa njerëz u detyruan të shpërngulen, dhe shtëpitë e tyre u shemben, duke mos u afruar asnjë kompensim. Për më tepër, fëmijët e komunitetit duke kaluar sipër shinave janë vrarë ose demtuar rëndë prej trenave qysh atëherë.

¹⁴⁹ *European Roma Rights Center*, intervista me Hekuran Zoto, 5 Dhjetor 1996, Fier.

¹⁵⁰ Deri në vitin 1990, zoterimi i makinave private konsiderohej ilegale, dhe shumica e rugeve ishin bosh. Qysh atëherë, dëshira për të patur një Mercedes (zakonisht kaq i vjetër sa në perëndim nuk do të perdorej) është harmonizuar si me mungesën e eksperiencës së shofereve shqiptare ashtu edhe me injorancën shumë të pëhapur të rregullave të trafikut. Gjate kohës së misionit të ERRC, shumica e qyteteve në Shqipëri nuk kishin shenjat rrugore dhe semafore, dhe rregullimi i trafikut kryhë nga grupe policësh që rrinin në mes të rrugës. Fatalitetet nga trafiku janë rritur me shpejtësi si rezultat i kesaj anarkie.

¹⁵¹ *European Roma Rights Center*, intervista me Meleqe Rainë, 13 Korrik 1996, Moravë.

¹⁵² *European Roma Rights Center*, intervista me zonjen R.X., 5 Dhjetor 1996, Gjirokastrë.

¹⁵³ *European Roma Rights Center*, intervista me Kasriot dhe Adelina Demiri, 8 Dhjetor 1996, Pojan.

¹⁵⁴ Shkollimi tërëvjeçar është i detyruar në Shqipëri sipas Ligjit nr. 7952, Datë 21 .06. 1995, "Për sistemin shkollor para universitar. Neni 3 i këtij ligji garanton të drejtën e të gjithë qytetarëve të edukohen mbi baza të barabarta, një princip që buron nga ligji kushtetues shqiptar, kapitulli VII, Neni 35.

¹⁵⁵ *European Roma Rights Center*, intervista me Kryetarin e Bashkisë Monder Salaku, 18 Korrik 1996, Fushë-Krujë

¹⁵⁶ *European Roma Rights Center*, intervista me Ali Sadikun, 9 Dhjetor 1996, Korçë.

Eksperienca e jevgjeve në sistemin shkollor ndriçon ekzistencën e forcave diskriminuese në shkollat shqiptare. Jevgjit janë përpjekur të kapërcejnë këtë barrierë, bindshëm, por kanë ngecur në rrjetën e dilemës tipike të asimilimit të minoriteteve. Argumenti i zakonshëm racist rreth romëve të cilët nuk duan ti çojnë fëmijët e tyre në shkollë, apo që ata nuk duan të punojnë- nuk mund të përdoret si pretekst me jevgjit. Të mbërthyer nga perceptimi i shqiptarëve të tjerë se ata janë akoma ndryshe, pavarësisht se sa shumë duhet të përpiqen ata për tu bërë "njësoj", eksperienca e jevgjeve është një nga shenjat më të qarta që Shqipëria mbetet një shoqëri që njih grupet etnike të caktuara si më të dëshiruar se të tjerët.

6. MANIPULIMI POLITIK I ROMËVE TË SHQIPËRISË

Çështjet e minoritetit në Shqipëri në të kaluarën janë dominuar nga diskutimet mbi minoritetin grek në Shqipërinë e Jugut. Një pasqyrim i këtij debati ka qenë interesimi i Shqipërisë për shqiptarët jashtë vendit, veçanërisht në rajonet e Republikës ish - Jugosllave të Maqedonisë dhe Kosovës. Greqia, Italia dhe Jugosllavia në të kaluarën kanë lakmuar teritoret shqiptare. Për rrjedhojë, minoriteti grek në Shqipëri dhe minoritetet shqiptare jashtë kanë qenë një komponent i manovrave gjeopolitike nga të gjitha palët. Kjo nuk ka qenë e vërtetë për romët, dhe mungesa e autoriteteve përfaqësuese për romët me fuqinë dhe kredibilitetin e një shteti komb ka penguar ndjeshëm zhvillimin e një mbrojtjeje politike për romët në Shqipëri që nga koha e rënies së komunizmit.

Përlllogaritjet e numrit të minoritetit grek në Shqipëri variojnë nga 40.000 në 400.000.¹⁵⁷ Pas ndryshimeve të 1990-es, ata filluan të shpallin pretendimet për rikthimin e pronave të kishave, si dhe të drejtën e shkollimit në gjuhën greke në Shqipëri. Megjithatë, marrëdhëniet midis qeverisë shqiptare, qeverisë greke dhe minoritetit grek u keqësuan si pasojë e përzënies nga Shqipëria të udhëheqësit fetar të minoritetit grek Archimandrite Hrizostomos Maydonis të Gjyrokastres në verën e vitit 1993 dhe dëbimin e menjëhershëm të 30.000 shqiptarëve nga Greqia.

Në 10 prill 1994, persona të panjohur sulmuan postën kufitare pranë kufirit grek, duke vrarë dy ushtarë. Një javë më vonë, në 18 Prill, u arrestuan pesë anetare të minoritetit grekë, anëtarë të organizatës së minoritetit grek *Omonia*, të cilët u akuzuan për "spiunazh dhe armëmbajtje pa leje". Siç është theksuar nga shumë vërtetues, dënimi dhe gjykimi i tyre pati shumë parregullsi dhe nuk përmbushte standartet ndërkombëtare. Si kompensim, autoritetet greke dëbuan mbi 100.000 shqiptarë të cilët u shoqëruan me rrahje nga policia, ndarje diskriminuese të familjeve, grisje sistematike të dokumenteve të identifikimit nga policia, dhe grabitje nga policia.¹⁵⁸

Sidoqoftë, deri në 1996, situata e grekëve në Shqipëri, sipas *Human Rights Watch*, është përmirësuar ndjeshëm. Edhe pse rikthimi i pasurisë së kishave ngelet akoma i pazgjidhur dhe grekët etnikë raportojnë diskriminime në punë, në Gusht, qeveria shqiptare hapi tre shkolla në gjuhën greke në zonat e kërkuara nga minoriteti grek.¹⁵⁹

Romët asnjëherë nuk i janë drejtuar diplomacisë së përzënies. Në të vërtetë ata nuk mundën. Për më tepër, ata nuk mund të mbështeten në shumë forma të tjera presioni të ushtruara nga shteti komb modern. Dobësia e institucionëve që përfaqësojnë romët presupozon që e gjithë diplomacia zhvillohet mbi baza thellësisht të pabarabarta. Si rezultat, përpjekjet politike nga udhëheqësit romë në Shqipëri shpesh motivohen nga strategjia e arritjes së të voglës së mundshme, se sa nga të kërkuarit e të gjitha të drejtave që romëve ju takojnë.

Kështu për shembull, në kontrast të dukshëm me polemikën rreth udhëheqësit grek, zoti Gurali Mejdani i *Amaro Dives*¹⁶⁰ i tha *The Human Rights Project* se organizata e tij nuk është konfrontuese në strategjinë politike, sepse "në nuk fitojmë asgjë nga konfrontimi."¹⁶¹ Megjithatë, zoti Mejdani i tregoi ERRC se edhe ato pak iniciativa të premtuara nga Partia Demokratike në pushtet gjate fushatës elektorale u nëpërkëmbën menjëherë pas zgjedhjeve të Majit 1996.¹⁶²

Edhe në Partinë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ)¹⁶³ interesat e romëve nuk janë përfaqësuar siç duhet. Votat e romëve thjesht blihen me premtime boshe. Sipas zotit Esat Bastriu, romët kandiduan në zgjedhjet e 1996s për PBDNJ, kjo parti kishte një program që adresonte çështjet e romëve. Para së gjithash, kjo parti, sipas Bastriut, është e angazhuar për të njohur romët zyrtarisht si minoritet. Së dyti, partia punon për masa të cilat do të ndihmonin në ruajtjen e gjuhës dhe kulturës tradicionale romë.¹⁶⁴ Zoti Vasil Melo, udhëheqës i partisë PBDNJ, megjithatë, i tha *the Human Rights Report*,

Romet kanë pak kërkesa. Ata mbahen tek tradita e tyre. Ata nuk pretendojnë të studiojnë gjuhën e tyre të nënës në shkolla dhe nuk insistojnë për të drejtat e tyre.¹⁶⁵

¹⁵⁷ Ne regjistrimin e vitit 1989 u numeruan 58.758 greke, ndersa ne anen tjetër te spektrit, disa burime greke ne te kaluaren kane pretenduar se komuniteti grek ne Shqiperi perfaqesohet nga 400.000 kristiane ortodokse (shiko Hall, cituar me pare, p.26) Grupi per te drejtat e njeriut *Greek Helsinki Monitor* llogarit afersisht 150.000 greke ne Shqiperi. Shiko International Helsinki Federation, *Annual Report 1995* [Raporti vjetor 1995], Vienna, 1995, p.17.

¹⁵⁸ Shiko International Helsinki Federation for Human Rights, cituar me pare, 1995, pp. 16-18 dhe pp. 85-92. Per nje kritike te detajuar, shiko gjithashtu, Minnesota Advocates for Human Rights, *Trial Observation Report: The Albanian Trial of Five Ethnic Greeks for Espionage* [Raport mbi vëzhgimin gjyqësor: gjyqi shqiptar i pese grekeve etnike per spiunazh], Minneapolis: September 1994.

¹⁵⁹ Shiko Human Rights Watch, cituar me pare, 1996, p.197.

¹⁶⁰ Ka tre organizata kombetare rome qe perfaqesojne romet ne Shqiperi ne nivel kombetar, *Amaro Dives*, *Amaro Drom* dhe *Romani Baxt*.

¹⁶¹ *Human Rights Project*, interviste me zotin Gurali Mejdani, president i shoqates *Amaro Dives*, 30 Janar 1996, Tirane.

¹⁶² *European Roma Rights Center*, interviste me zotin Gurali Mejdani, president i shoqates *Amaro Dives*, 15 Korrik 1996, Tirane.

¹⁶³ Partia 'Bashkimi per te Drejtat e Njeriut' eshte nje parti koalicioni e minoriteteve ne Shqiperi. Ajo eshte kryesisht (megjithate jo plotesisht) nje parti e grekeve etnike, e bazuar ne nje platforme te pergjithshme te te drejtave te njeriut, mbas nje ligjit te vitit 1992 i cili ndalonte partite me baze etnike.

¹⁶⁴ *European Roma Rights Center*, interviste me Esat Bastriu, 16 Korrik 1996, Tirane.

¹⁶⁵ *European Roma Rights Center*, interviste me zotin Vasil Melo, Kryetar i Partise PBDNJ, 28 Janar 1996, Tirane.

Megjithatë, sipas një burri rom nga Korça, i cili donte të quhej vetëm "Gimi", PBDNJ nuk shpreh vullnetin politik të romëve, dhe është partia vetë ajo që përbën problem:

Grekët duan çdo gjë - shkolla, kisha, si i quani ju. Ata mund ti kërkojnë këto gjëra sepse ata janë të pasur. Gjatë fushatës elektorale PBDNJ tregoi interes për problemin rom, por tani ata nuk janë më të interesuar. Për mua, ata mbrojnë vetëm minoritetin grek.¹⁶⁶

ERRC është e shqetësuar se heshtja e udhëheqësve romë motivohet së pari nga mungesa e tanishme e pushtetit dhe dobësia e grupit, të cilat që të dyja perceptohen fuqishëm nga udhëheqja romë. Megjithatë, asnjë nga këto arsye nuk ka bazë legjitime për nënvlerësimin e skajshëm dhe të vazhduar politik të të gjithë grupit.¹⁶⁷

Në rastet kur romët kanë qenë politikisht aktivë, ata shpesh kanë rënë viktime e abuzimit të të drejtave të tyre politike nga autoritetet. Delvina, në jug të vendit, është një zonë me një minoritet të konsiderueshëm. E shtrirë në një teritor i cili prej shumë grekëve konsiderohet "Epiri i Veriut", shumë pjesë të Shqipërisë së Jgut shtrihen brenda "Greqisë së idesë së madhe" që është ëndrra e pan-helenikëve. Romët, si një popullatë "e lëkundshme" votuesish, gjenden nën presionin politik të autoriteteve shqiptare në jug për ti distancuar ata nga grekët.

Sipas rezultateve të kërkimeve të ERRC, ka dy menyra të abuzimit politik ndaj romëve në Shqipëri. Para së gjithash, udhëheqësve romë ju bëhet presion të distancohen nga PBDNJ. Selamet Musta, udhëheqës i komunitetit rom të Delvinës i tregoi ERRC:

Në 3 Prill 1994, policët erdhën në shtëpinë time dhe më thanë të shkoj pas tyre. Ata nuk kishin autorizim për të më kërkuar. Më pyetën pse isha anëtar i partisë pro-greke - si anëtar i organizatës romë *Amaro Dom*, unë jam anëtar i Partisë për të Drejtat e Njeriut. Ata më thanë që "Myslimanët nuk bëjnë pjesë në të."

Ata sollën disa njerëz në rajonin e policisë. Katër nga në ishin nga Delvina. Të tjerët gjithashtu merreshin me politikë. Në rajonin e policisë, policët na rrahën me shkop dhe qytat e armëve të tyre. Ne u rrahëm gjithashtu në shputat e këmbëve. Unë u mbajta në rajonin e policisë për tre ditë, por ata më pyetën dhe më rrahën vetëm ditën e parë. Kur më lëshuan më thanë, "Ju jeni i lirë të bashkoheni me kë parti të doni, por jo me atë."¹⁶⁸

Pengimi i aktivitetit të partive politike është në kundërshtim me Nenin 269 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.¹⁶⁹

Metoda tjetër e përdorur nga autoritetet për të shtrembëruar rezultatin e zgjedhjeve në Shqipëri dhe për t'ju hequr mandatin romëve është e thjeshtë: Romët në Delvinë i treguan ERRC se kur ata shkuan në qendrat e votimit gjatë zgjedhjeve lokale dhe bashkiake në Tetor 1996, ju thanë që ata kishin votuar njëherë, kështu që duhej të largoheshin.

Si zgjedhjet e Majit dhe ato të Qershorit 1996 ishin plot parregullsi dhe u kritikuan si jo të lira dhe të barabarta nga Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Europë (OSBE), e cila vezhgoi zgjedhjet, si dhe organizata të tjera. Berisha i vodhi votat dhe pastaj rrahu protestuesit. Si u tregua më lart, të drejtat politike të romëve u dhunuan gjithashtu brutalisht nga qeveria e Berishës.

¹⁶⁶ *Human Rights Project*, interviste me "Gimin", 18 Janar 1996, Korçe.

¹⁶⁷ Kompromiset e politikaneve romë për shkak të dobësisë së tyre për të bërë marrëveshje janë pershkruar mire në rastin e Hungarisë. Shiko Kovats, Martin, "The Good, the Bad and the Ugly: Three faces of 'Dialogue'-The Development of Roma Politics in Hungary" [E mira, e keqja dhe e shemtuara: tre fytyrat e dialogut - zhvillimi i politikës romë në Hungari], në *Phralipe*, January-February, 1997, pp. 23-34.

¹⁶⁸ *European Roma Rights Center*, interviste me Selamet Musta, 4 Dhjetor 1996, Delvine.

¹⁶⁹ Neni 269 thotë: "Pengimi me force i aktivitetëve të ligjshme të partive politike, organizatave ose shoqërive përben një kundravajtje penale dhe denohet me deri dy vjet heqje lirie." Perktimi jo zyrtar në anglisht nga Kathleen Imholtz. Shiko ICCPR, Neni 18 (liria e ndërgjegjes), 19 (liria e fjalës), 21 (e drejta e demonstrimit paqësor), 22 (e drejta e pjesëmarrjes në organizata); ECHR, Neni 9 (liria e ndërgjegjes), 10 (liria e fjalës), 11 (liria e pjesëmarrjes në organizata dhe manifestime paqësore).

7. ROMËT E SHQIPËRISË JASHTË SHTETIT

Situata ekonomike në Shqipëri aktualisht është në një nivel të ulët, kështu që shumë shqiptarë e kërkojnë fatin e tyre jashtë shtetit, si "punëtorë mysafirë" në vende të tilla si Gjermani, Greqi dhe Itali. Shqipëria është aktualisht, sipas fjalëve të një vrotjuesi, "një fabrikë punëtorësh *gastarbeiter*".

Romët janë të integruar plotësisht në emigracionin shqiptar. Veçanërisht për romët e jugut të vendit, emigrimi ekonomik sezonal është një pjesë e rëndësishme e jetës tyre. Romët në Gjirokastrë, për shembull, shkojnë çdo verë të vjelin domate në Greqi. Me paratë e fituara nga vjelja e domateve, ata blejnë këpuçë të cilat i importojnë në Shqipëri dhe i shesin në një dyqan ngjitur me lagjen e tyre.¹⁷⁰

Pjesa dërmuese e jetës së romëve të Shqipërisë u kalon jashtë dhe shumica e dhunimeve të të drejtave të tyre kanë ndodhur në Greqi ose Itali, ku romët duhet të bashkejetojnë jo vetëm me faktin që janë romë, por dhe që janë romë të huaj, ndoshta objektivi më i lehtë në Europën ksenofobike. ERRC intervistoi romët që kishin raportuar raste të vrasjeve policore në Greqi dhe keqtrajtime të policisë kufitare greke dhe asaj italianë. Udhëheqësi rom Mohammed Xhambazi i tha ERRC:

Shumë romë kanë qenë keqtrajtuar nga ushtarët grekë kur po ktheheshin për në Shqipëri. Disa janë arrestuar dhe mbajtur në qeli për disa ditë. Unë për vetë jam rrahur nga ushtarët grekë. Kjo ka ndodhur afërsisht dy vjet më parë. Isha duke kaluar kufirin grek dhe u arrestova nga ushtarët e kufirit. Ata më mbajtën në arrest për katër ditë duke më rrahur çdo ditë. Më gjuajtën me shqelma në të gjithë trupin. Ishte një torturë e vërtetë.¹⁷¹

Në fillim të nëntorit 1996, policia kufitare italiane hodhi në det të gjithë refugjatët shqiptarë që ndodheshin në një varkë, duke i detyruar ata të notonin për në breg. Një nga viktimat ishte e motra e Mohammed Xhambazit:

Burri i motrës time jeton në Itali. Ne po perpiqeshim të gjenim një mënyrë për ti gjetur asaj një vizë, por në nuk ja dolëm mbanë, kështu që më në fund, një muaj më vonë, e dërguam atë dhe femijën e tyre ilegalisht me skaf. Ata u kapën nga policia kufitare italiane dhe po ktheheshin drejt bregdetit shqiptar. Para se të arrinin bregun, ata u hodhën në det. Për fat të mirë, të gjithë shpëtuan. Shumica e njerëzve në këtë jaht ishin romë. Ne nuk duam të shkojmë ilegalisht në vende të tjera, por siç është puna tashti në nuk kemi zgjidhje tjetër.¹⁷²

Gjithashtu, romët i kanë raportuar ERRC dy incidente të vrasjeve nga policët të cilat kanë ndodhur në Greqi. Në Fllorinë në Korrik 1996, Adrian Xhambazi -21 vjeç, u vra nga policia greke. Sipas kushëririt të tij Fatmir Rexha, stomaku i zotit Xhambazi ishte çarë nga bajonëta. Në verën e 1995, 27 vjeçarit Festim Kanani i kishin prerë fyti, gjithashtu nga policia greke. Fatmir Rexha i tregoi ERRC se ky rast u raportua në televizionin shqiptar dhe e shoqja e zotit Kanani e cila banon në Korçë e njohu burrin e saj nga tatuazh i veçantë që kishte në shpatull.¹⁷³

Problemi i të shkuarit jashtë për punë, megjithatë, fillon që në atdhe. Mohammed Xhambazi i tregoi ERRC rreth eksperiencës së tij në ambasadën greke në Tiranë:

Kur unë shkoj në ambasadën greke në Tiranë, ata më bëjnë të paguaj 100-200.000 dhrahmi për një vizë për në Greqi. Minoriteti grek mund të shkojë atje sa herë të dojë, dhe nëse ju jeni anëtar i Partisë Demokratike, ju gjithashtu keni shumë përfitime, por në s'fitojmë asgjë. Madje edhe po të paguaj, kush më garanton se ata nuk do të më kthejnë mbrapsht përsëri? Ne jemi një minoritet në Shqipëri, por askush nuk na ndihmon. Ne shkojmë në Greqi për të mbijetuar, por asnjëherë nuk trajtohem siç duhet.¹⁷⁴

Një numër i madh romësh që u kontaktuan nga ERRC thanë që puna sezonale në Greqi dhe Itali ishte e vetmja mënyrë për ta për të mbijetuar. Emigrimi ekonomik nuk është specifik vetëm për romët, por shumica e romëve që takoi ERRC thanë që diskriminimi në Shqipëri ka një efekt shumë rëndësues në gjendjen e tyre. Me të vërtetë, nëse për shqiptarët etnikë ekzistojnë pak mundësi në vendin e tyre, romët me të vërtetë nuk kanë asnjë mundësi:

¹⁷⁰ Në Shqipëri, ekziston një kompani e njohur e importit të kepuçeve dhe robave me pronare romë me aktivitet në gjithë vendin, e cila quhet "Firma gabi" ose "Firma intelektuale", ngaqë intelektualët paga të uletat përbejnë klientelen baze të saj.

¹⁷¹ *European Roma Rights Center*, interviste me Mohammed Xhambazi, 8 Dhjetor, 1996, Bilisht.

¹⁷² *European Roma Rights Center*, interviste me Mohammed Xhambazi, 8 Dhjetor 1996, Bilisht.

¹⁷³ *European Roma Rights Center*, interviste me Fatmir Rexha, 8 Dhjetor 1996, Maliq.

¹⁷⁴ *European Roma Rights Center*, interviste me Mohammed Xhambazi, 8 Dhjetor 1996, Bilisht.

Në zyrën e bashkisë, të gjithë nëpunësit kanë shokë dhe ju japin punë miqve të tyre. Dhe meqë të gjithë janë *gadje*, të gjitha punët i marrin *gadjet*. Fëmijët tanë shkojnë në shkollë, por kjo nuk i ndihmon ata. Ata përsëri nuk gjejnë punë. Si rezultat i kësaj, shumica e romëve duhet të shkojnë në Greqi. Thjesht nuk ka punë për neve këtu.¹⁷⁵

¹⁷⁵ *European Roma Rights Center*, interviste me Mohammed Xhambazi, 8 Dhjetor 1996, Bilisht.

8. NË ZYRËN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Ndërsa po hetonim deklaratat e dhunimeve të të drejtave të njeriut kundër romëve në Shqipëri, një problem serioz i cili vazhdimisht pengonte orvatjet e ERRC për të ndërtuar ngjarjet me vërtetësi ashtu siç kishin ndodhur, ishte vështirësia për të gjetur autoritete kompetentë të cilët mund të na ofronin disa ngjasime të komenteve zyrtare të statusit të ngjarjeve. Kjo nuk ishte për shkak të refuzimit ose armiqësisë nga ana e autoriteteve që merreshin me këtë punë. Përkundrazi, ERRC mjaft shpesh u prit ngrohtësisht nga zyrtarët. Ata na ofruan kafe, cigare dhe wisky amerikan dhe u treguan të ngrohte dhe të gatshëm të përgjigjeshin çdo pyetje tonës.

Megjithatë, disa zyrtarë me të cilët ERRC u takua, nuk dëshiruan të hynin në detaje të fakteve për raste të veçanta. Kapiteni i parë Eqerem Vrenozi, zëvendës shef i policisë së Fierit, për shembull, i tha ERRC se në katër vitet e fundit, nuk ka patur incidente të rënda në të cilat të jenë përfshirë romët e zonës së Fierit. Sipas zotit Vrenozi, "Romët pëlqejnë të punojnë dhe nuk kryejnë krime."¹⁷⁶

Akoma më shpesh, problemi qëndronte në faktin që zyrtarët me të cilët ERRC bisedoi ishin të sapo emëruar dhe fatkeqësisht nuk ishin në gjendje të ofronin komente në gjithçka që kishte ndodhur para katër-pesë muajsh. Oficeri i Policisë Bushati, Shef i Komisarariatit të Policisë së Beratit, për shembull, nuk ishte në gjendje të fliste me kompetencë për shumë çështje për të cilat ERRC ishte e shqetësuar, ngaqë ai kishte filluar punë në Berat, dy muaj para se ERRC të vizitonte këtë qytet. Ngjashmërisht, Oficeri i Policisë Qemal Cani i Komisarariatit të Kolicisë së Korçës, i tha ERRC se që nga viti 1992 ka patur disa shefa policie në Korçë. Një nëpunësi të zyrës së prokurorisë së Korçës ju duk e lezetshme dhe e çuditshme ideja që në donim të flisnim me dikë që kishte punuar në këtë zyrë në 1992-in; Korça ka patur 5 deri në 10 Shefa të Prokurorisë që atëherë. Nëpunësi nuk i kishte numëruar sa Prokurorë ishin në të vërtetë.

Së fundi, ERRC ndoqi pohimet e autoriteteve kompetente në rastet e përshkruara në këtë raport në dyert e zyrës së Prokurorisë së Përgjithshme në Tiranë. Atje na u desh të presim jashtë ndërtesës së bardhë me shumë histori, ndërsa një roje përcolli kërkesën tonë për tu takuar me dikë që mund të na ofronte komente sakta për shumë çështje rreth të cilave në donim të flisnim. Pas një ore, nëve na u tha që të shkonim në Zyrën e Studimeve të Drejtësisë dhe Departamentit të Marëdhënieve me Jashtë, ose siç na u tha, "Zyrën e të Drejtave të Njeriut".

Përshkrimi i padrejtesive të periudhës komuniste është për tej qëllimit të këtij libri. Megjithatë, trashëgimia e përpjekjeve për të "tkurrur" ligjin nuk është jashtë tij. Nën komunizëm, e drejta për avokat mbrojtës dhe e drejta e apelimit të vendimit konsideroheshin koncepte borgjeze, të panevojshme, meqë sipas doktrinës komuniste shteti vete do të zhduej. Kjo ishte teoria. Në praktikë, fuqizimi i vazhdueshëm i shtetit u duk që po fshinte institucionët legale ngaqë ato ishin një sfidë për autoritetin e centralizuar totalitar.

Në 1990-ën, u rinisi aktivitetin Ministria e Drejtësisë dhe profesioni ligjor i juristit të pavarur. Të dy ishin abroguar që më 1967.¹⁷⁷ Mënyra në të cilën qeveria shqiptare adresoi mungesën e specialistëve të ligjit u kritikua nga komuniteti ndërkombëtar. The International Helsinki Federation for Human Rights [Federata Ndërkombëtare e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut] shkroi:

Për shkak të mungesës së gjyqtarëve dhe avokatëve, qeveria vendosi më 1993 të organizojë kurse trainimi tre dhe gjashtë mujore për specialistët e ardhshëm të ligjit. Përveç garancisë fillestare të qeverisë që të diplomuarit në këto kurse do të punonin vetëm në administratë, një pjesë e tyre u emëruan si gjykatës dhe prokurorë pasi u diplomuan-pa patur kualifikimin e kërkuar profesional - një diplomë nga Fakulteti i Drejtësisë në Tiranë. Fakti që shumë nga pothuaj 200 pjesëmarrës në këto kurse u zgjodhën nga udhëheqësit lokalë të Partisë Demokratike në bazë të përkatesisë politike, vë më tej në pikëpyetje pavarësinë e punës së tyre.¹⁷⁸

Gjendja e shtetit ligjor në Shqipëri reflekton rininë e tij. Shumë njerëz nga shtesa të ndryshme njohën dhe përdorën shprehjen "të drejtat e njeriut", dhe vizita e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, José PÉres de Cuéllar në 1990 u kujtua nga romët, jevgjit dhe zyrtarët publikë. Megjithatë, përdorimi i termit rrallë lidhet me të drejtat e individit përpara ligjit. Parimi i paprekshmërisë së disa të drejtave dhe lirive bazë të individit duhet të fitojë më shumë mbështetje midis shumicës së njerëzve me të cilët ERRC foli, qytetarë privatë apo zyrtarë të shërbimeve publike. Për rrjedhojë ERRC po

¹⁷⁶ *European Roma Rights Center*, interviste me Kapitenin e parë Eqerem Vrenozi, Zv/Shef i Policisë së Fierit, 6 Dhjetor 1996.

¹⁷⁷ Shiko Hall, cituar me pare, pp. 59-61.

¹⁷⁸ International Helsinki Federation of Human Rights, *Annual Report 1995* [Raporti vjetor 1995], Vienna, 1995, p.14. Me shume se 400 te diplomuarve ne keto kurse ju kerkua te japin provimet e fundit te vitit ne Fakultetin e Drejtësisë. Niveli i kalueshmërisë ishte 100%. Se fundi, edhe pse Ministria e Drejtësisë e siguroi publikun se te diplomuarit e kurseve te pershpejtuara do te punonin vetem si asistente, ata megjithate jane emeruar ne poste te larta ne ministri. Nje i emeruar i tille u be Kryetari i Gjykates se nje rrethi dhe ishte Gjykatesi i cili refuzoi apelin e burgimit te liderit te opozites Fatos Nano.

ndihej e intriguar që po gjendej në zyrën e të Drejtave të Njeriut në ndërtesën e Prokurorit të Përgjithshëm të Shqipërisë.

Zyra e të Drejtave të Njeriut është komode dhe mikpritëse. Muret janë të zbkuruar me postera të Këshillit të Europës të cilët bënin thirrje për tolerancë, postera të UNICEF-it që lajmëronin vitin e kësaj apo asaj, dhe fëmijët që rrezatonin mirëkuptim ndër-etnik. Si edhe me zyrtarët e tjerë me të cilët ERRC foli, drejtori Edison Heba, fatkeqësisht, nuk mund të komentonte rastet që në po shqyrtonim. Megjithatë, ai mund të na tregonte neve diçka rreth Shqipërisë:

Shqipëria është një vend i vogël dhe në shqiptarët kemi një mentalitet ballkanas, që do të thotë neve na pëlqen të shoqërohemi dhe të pimë një kafe me njerëzit që takojmë. Ne njihemi me njerëzit shumë shpejt. Kjo është shumë e mirë, por mund të krijojë disa probleme.¹⁷⁹

Problemet, në mënyrë të specifikuar, janë ato që çdokush duhet të njohë dikë tjetër, gje e cila krijon pengesa të medha për vendosjen e një drjetësie neutrale:

Unë për shembull, jam nga Durrësi dhe çdokush më njeh mua atje. Unë kurrë nuk mund të punoja atje.¹⁸⁰

Afersia e një vendi, fatmiresisht, nënkuptoi që drejtori Heba njihnte një nga Prokurorët me të cilin në donim të flisnim, Prokurorin Azis Roshi, të Zyrës së Prokurorisë së Korçës në kohën kur Seran Sadiku kishte vdekur në arrest policor:

Zoti Roshi ishte hetues i Policisë Gjyqësore në Korçë. Unë e njoh atë shumë mirë.¹⁸¹

Por fatkeqësisht ai nuk mund të na tregonte se ku mund ta gjenim zotin Roshi tani:

Nuk jam i sigurtë se ku mund të jetë zoti Roshi tani. Nuk kam dëgjuar për të për një kohë të gjatë.¹⁸²

Arsyeja për këtë ishte se zoti Roshi kishte ndryshuar punë shumë herë qysh atëherë. Në fakt, kjo për zotin Heba ishte tipike:

Është normale të ndërrosh punë në Shqipëri. Unë për vetë jam lëvizur shtate herë.¹⁸³

Arsyeja publike për qarkullimin e vazhdueshëm të zyrtarëve publikë është se ajo frenon korrupsionin: nëse ju nuk rrini atje për një kohë të gjatë, ju nuk mund të bëni shumë dëme. Shumica e shqiptarëve me të cilët folëm mendonin se ishte tamam e kundërta: "Ata rrinë në një zyrë kaq kohë sa mbushin xhepat me para, dhe pastaj lëvizin - ata nuk rrinë kurrë kaq gjatë në një vend, sa të kapen dhe ndeshkohen nga ligji."¹⁸⁴

Dhe ata nuk janë në një vend për kaq kohë sa do ishte e nevojshme të sigurohej vazhdimësia në ndjekjen e krimeve lokale. Në fakt, është shumë e vështirë ti besosh spjegimit zyrtar për lëvizjet e vazhdueshme të zyrtarëve lokalë, derisa duket qartë që kjo ka qenë një dështim i plotë: I vetmja fije që lidh diversitetin e theksuar rajonal në Shqipëri ishte bindja e romëve se zyrat e shtetit ishin atje ku ata duhej të paguanin, të paguanin dhe përsëri të paguanin në një vazhde të parreshtur shfrytëzimi. Mohammed Xhambazi, Sekretar i Përgjithshëm i Romëve të Shqipërisë e quajtur *Amaro Dives*, e përmblozhi kështu per ERRC pikëpamjen e shumë romëve shqiptare:

Ne i zgjidhim konfliktet brenda komunitetit, midis njeri tjetrit. Nëse do të shkonim në polici, ata thjesht do të kërkonin para nga në. Në komunizëm ishte ndryshe. Nuk është se e pëlqej komunizmin, por do të donim të trajtoheshim me respekt edhe në demokraci. Në nuk fituam asgjë nga demokracia. Ajo që kemi në Shqipëri sot është demokracia e korrupsionit.¹⁸⁵

¹⁷⁹ *European Roma Rights Center*, interviste me Z. Edison Heba, Drejtor i Zyres se Studimeve te Drejtesise dhe Maredhenieve me Jashte prane Zyres se Prokurorit te Pergjithshem, 10 dhjetor 1996, Tirane.

¹⁸⁰ *European Roma Rights Center*, interviste me Z. Edison Heba, drejtori i Zyres se Studimeve te Drejtesise dhe Maredhenieve me Jashte prane Zyres se Prokurorit te Pergjithshem, 10 dhjetor 1996, Tirane.

¹⁸¹ *European Roma Rights Center*, interviste me z. Edison Heba, Drejtori i Zyres se Studimeve te Drejtesise dhe Maredhenieve me Jashte prane Zyres se Prokurorit te Pergjithshem, 10 dhjetor 1996, Tirane.

¹⁸² *European Roma Rights Center*, interviste me z. Edison Heba, Drejtori i Zyres se Studimeve te Drejtesise dhe Maredhenieve me Jashte prane Zyres se Prokurorit te Pergjithshem, 10 dhjetor 1996, Tirane.

¹⁸³ *European Roma Rights Center*, interviste me z. Edison Heba, Drejtori i Zyres se Studimeve te Drejtesise dhe Maredhenieve me Jashte prane Zyres se Prokurorit te Pergjithshem, 10 Dhjetor 1996, Tirane.

¹⁸⁴ *European Roma Rights Center*, interviste me 35 vjecarin F.B., 7 dhjetor 1996, Berat. *The International Helsinki Federation of Human Rights* ka arritur ne te njejtin konkluzion: "Korrupsioni shume i perhapur, si dhe zvarritjet ne hetimet e krimeve, cenojne gjithashtu funksionimin e sistemit juridik." Shiko International Helsinki Federation of Human Rights, cituar me pare, 1995, p.14. Departamenti i shtetit i Shteteve te Bashkuara gjithashtu konstatoi korrupsion ne sistemin juridik, qe ja vlen te permendet: "Si nepunes shtetore, gjykatesit paguhen shume keq, dhe besohet gjeresisht se korrupsioni eshte shume i theksuar ne gjykate." U.S. Department of State, cituar me pare, April 1996, p. 753.

¹⁸⁵ *European Roma Rights Center*, interviste me Mohammed Xhambazi, 8 Dhjetor 1996, Biliisht.

9. EPILOGU: LOGJIKJA E KAOSIT

Strategjia e mediacionit me dhunesit e tyre nuk u eci romëve të Levanit gjate shembjes se rregullit që ndodhi në Shqipëri në fillim të 1997-es. Më 28 Mars 1997, ERRC mësoi se më 26 Mars, 18 persona u vranë në komunitetin rom të Levanit. Sipas informacionit të dhënë nga *Romani Baxt* dhe *the Albanian Human Rights Group* [Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut], episodi filloi me një përpjekje të një gangsteri jo-rom për të lënë një kufomë në lagjen romë. Dëshmitarët dëshmuuan që pak kohë më vonë, 15 persona të armatosur hynë në komunitetin rom dhe filluan të terrorizojnë banorët e tij. Romët mundën ta çarmatosin pjesërisht grupin, por kur njëri nga banda mbërtheu armën, romët hapën zjarr. Gjatë sulmit, sipas burimeve më të besueshme, u vranë të 15 personat e bandës si dhe tre romë.

ERRC u informua se situata shumë delikate e romëve të Levanit u keqësua edhe më shumë, dhe vrojtues lokalë shprehin frikën rreth sigurisë së gjithë komunitetit. Sipas *the Albanian Human Rights Group*, aktualisht nuk ka asnjë autoritet që funksion ose organ policor në Levan. Incidente hakmarrëse ndodhën në 3 Prill 1997, kur persona të panjohur të armatosur hapën zjarr mbi shtëpitë e banuara nga romët në Levan, si dhe mbi individë romë në varrezat e Levanit. Një pjesë e madhe e komunitetit rom të Levanit, sipas *the Albanian Human Rights Group*, ka ikur tek një komunitet tjetër rom në Durrës. Që kur filloi kaosi në fillim të 1997s, është raportuar një burrë rom i vrarë në Mbrostar, afër Fierit, dhe një çift rom i vrarë në Korçë.¹⁸⁶

Shqipëria në 1991 u karakterizua nga një optimizëm dhe shpresë e pashembullt për premtimet e reformave demokratike dhe ri - integrimin në Europë nga e cila shqiptarët ishin shkëputur prej dekadave të izolimit. Pengesat në rrugën e këtyre reformave ishin dekurajuese: Nevoja e një kursi trainimi prej gjashtë muajsh për të rivendosur profesionin e drejtësisë, një semafor në të gjithë vendin, bunkerët prej betoni të kudo ndodhur të Hoxhës të cilët dalëngadalë helmuan peisazhin e virgjër shqiptar - këto ishin imazhet e shtypit pesimist perëndimor. Akoma, pavarësisht nga divergjencat e panumerta për një kalim të butë në demokraci, shumë shqiptarë e ruajtën humorin e tyre: "Kjo është Shqipëria," do të thonin ata me vetëdije.

Shanset për rilindjen e Shqipërisë, megjithatë, po rënoheshin vazhdimisht nga degradimi i përditshëm i jetës publike. Gazetarët sulmoheshin në rrugë nga agjentët e sigurimit dhe zyrat e tyre dëmtoheshin dhe vidheshin. Punët dhe pushteti ishin shpërndare ekskluzivisht për besnikët e klikës së presidentit. Dëshmitarët e gjyqit të *Omonias* grumbulloheshin dhe futeshin në makina, për ta gjetur vetveten pas pak ditësh në sallën e gjyqit për të dëshmuar. Zgjedhjet mashtruese të Majit 1996 lejuan Berishën të marrë kontrollin e Parlamentit. Kryetari i Gjyqit të Kasacionit u shkarkua nga një Parlament i cili nuk kishte pjesëtarët e mjaftueshëm.¹⁸⁷ Dhe kështu me radhë.

Ndërkohë, frika se konflikti jugosllav do të përhapej në zonat e Jugosllavisë dhe Maqedonisë me minoritete të mëdha shqiptare, duke shkuar drejt gogolit të shekullit të njëzetë të luftës ballkanike, e shtynë komunitetin ndërkombëtar drejt një strategjie të përkëdheljes së presidentit autoritar përherë në rritje Berisha. Fred Abrahams i "The Human Rights Watch", duke shkruar në 20 Mars 1997 në botimin a pare ne toke te huaj të të përditshmes së pavarur Koha Jonë (zyrat e së cilës në vend ishin djegur), e përmboldhi kështu historinë e kohëve të fundit të Shqipërisë:

Gjatë gjithë kohës, Berisha hasi ne nje kritike minimale nga komuniteti ndërkombëtar, veçanërisht Europa Perëndimore. E bindur se ai do të ruante paqen në mes të 2.5 milionë shqiptarëve etnike në Kosovë dhe Maqedoni, perëndimi mbylli një sy ndaj dhunimeve të dukshme të të drejtave të njeriut që po ndodhnin në Shqipëri, si gjyqet politike, dhuna policore dhe sulmet ndaj shtypit. Këshilli i Europës lavdëronte "zhvillimet demokratike" të Shqipërisë dhe Bashkimi Europian dha Shqipërisë më shumë ndihmë per fryme se çdo vendi tjetër të Evropës Lindore.¹⁸⁸

Brenda vendit Berisha e bleu heshtjen duke premtuar para të fituara lehtë. Investuesit shiten trashëgimitë familjare dhe fermat për ti investuar në një nga shumë skemat piramidale me shpresë që të merrnin 100% interes në pak muaj.¹⁸⁹ Elikisiri i pasurimit ishte paracaktuar si ngushëllim për një publik përherë e më të mjerë, një ekzistencë shqiptare që përherë e më tepër

¹⁸⁶ Shiko shtypin e *Albanian Human Rights Group*, "Acts of Violence, Maltreatments and Killing Inflicted on Roma Population" [Akte dhune, keqtrajtime dhe vrasjesh qe godasin popullsine rome], Tirana, April 6, 1997. Shiko gjithashtu Cortiade, cituar me pare.

¹⁸⁷ Shume politikanane te opozites dhe komentatore politike kane kundërshtuar ekzistencen e shumices se deputeteve (71 nga 140) gjate votimit ne te cilin parlamenti me kerkese te presidentit Berisha shkarkoi Kryetarin e Gjykates se Kasacionit Zef Brozin. Sipas *the East European Constitutional Review*, "Protokollu deshmon qe tre deputete te opozites votuan per heqjen e Brozit, kur ne fakt keta deputete nuk ishin fare ne godinen e parlamentit. Te gjitha partite e opozites e braktisen parlamentin para se te behej votimi. Kur u ballafaqua me nje ceshnje te tille, zevendes kryetari i parlamentit (nje anetar i Partise Socialiste) theksoi qe sesionet e meparshme te asamblese ishin mbajtur me vetem 68, 60, 70 anetare te parlamentit; dhe sistemi kompjuterik tregoi nje numer me te madh se 71." Shiko "Albania Update", *East European Constitutional Review*, Vol. 4, No. 4, Fall 1995, p.3.

¹⁸⁸ Abrahams, Fred, "Europe's Shame"[Turpi i Europes], *Koha Jone*, March 20, 1997, p.4.

¹⁸⁹ Endrra per t'u pasuruar nepermjet skemave piramidale u be i vetmi obsesion praktikisht i çdo shqiptari. Fshataret ne veri dhe jug e lane token djerre dhe futen gjithcka kishin ne skema. Madje njerezit shiten mallrat dhe pasuri te tjera per te perfituar nga interesi i larte qe u pa te sillte nje perfitim prej 30 ne 100% ne pak muaj. Dhe sigurisht, kur skemat falimentuan ndodhi ajo qe pritej. Ndersa njera nga shpresat me te medha po shuhej, njerezit dolen ne ruge dhe studentet hyne ne greve ." (*Koha Jone*, 20 Mars 1997, p.2)

po i përngjasonte një vullkani të mbuluar nga një shtresë e hollë normash ligjore. Gjatë kohës së misionit të dytë të ERRC në Shqipëri, në Dhjetor 1996, skemat piramidale dhe zhgënjimi politik ishin fjetet që i mbanin shqiptarët të lidhur më së miri. Kur skemat piramidale filluan të falimentojnë, zhgënjimi politik eksplodoi në një kaos eksitues i prirur të orientohet drejt atij që një vrojtues e ka quajtur "shteti mafie".¹⁹⁰

Megjithatë, ajo që dukej si kaos në pranverë të 1997-es, kishte logjikën e vet. Shumë fije të padukshme vijnë nga e kaluara dhe përshkojnë të sotmen drejt të ardhmes. Si në Levan, shumë incidente të dhunshme të pranverës kaotike shqiptare kanë historitë e tyre të patreguara. Ky raport veçoi vetëm një pjesë të vogël të realitetit shqiptar për ta analizuar: situatën e të drejtave të njeriut të romëve në shtatë vitet e fundit. Romët akoma jetojnë bashkë me të gjithë shqiptarët e tjerë. E ardhmja e romëve të Shqipërisë është e pandashme nga e ardhmja e vetë vendit.

¹⁹⁰ Shiko për një analizë të zhvillimeve Lubonja, Fatos, T., "Pyramids of Slime", Transitions, Vol. 4, No. 1. June 1997, pp.65-71.

10. NJË ZGJIDHJE E DREJTË: REKOMANDIME TË QENDRËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E ROMËVE PËR QEVERINË SHQIPTARE

The European Roma Rights Center [Qendra Europiane për të Drejtat e Romëve] i sugjeron Qeverisë Shqiptare të adoptojë të gjitha politikat e mëposhtme.

1. Të shqyrtojë rastet e raportuara të korrupsionit në forcat e policisë, veçanërisht rastet e venies në shenjester të romëve me qëllim përvetësimin e parave dhe konfiskim të paligjshëm të pasurisë. Te sillen para organeve të drejtësisë personat përgjegjës për këto forma të vazhduara abuzive.

2. Hetoni rastet e brutalitetit policor, përfshi rrahjet, ndalimet e paligjshme dhe vrasjet nga policët të raportuara nga ERRC. Përgjegjësit e këtyre akteve të vihen para përgjegjësisë ligjore.

3. Ndërmerni hapa të rëndësishëm për të reformuar policinë, hetuesinë dhe prokurorinë, duke u përqëndruar në mospërputhjet midis normave të vendit për procedurat e zbatimit të ligjit dhe praktikave të tanishme në Shqipëri.

4. Te fillohen programe, në bashkëpunim me udhëheqësit romë, të cilat do të mundësojnë pjesëmarrjen dhe të drejtën për t'ju drejtuar normalisht organeve të mbrojtjes dhe zbatimit të ligjit Filloni programe e kontrollit policor brenda komunitetit rom nga vete romet.

5. Hetoni shpërnguljet jo ligjore të romëve nga shtëpitë dhe vendbanimet e tyre dhe sillni fajtorët para drejtësisë.

6. Ofroni strehim kompensues të përshtatshëm për ata romë që janë shpërngulur si rrjedhojë e procesit të kthimit të pronave dhe privatizimit.

7. Hetoni konfliktin e dhunshëm të Levanit, duke patur parasysh sulmet e mëparshme nga komuniteti jo-rom dhe dyshimet rreth policisë lokale. Te sillen parai drejtësisë ata që janë përgjegjës për vrasjet dhe provokimet.

8. Te sillen para drejtësisë vrasësit e Fatmir Haxhiut.

9. Ndërmerni hapa të rëndësishëm për të mbikëqyrur parrëgullsitë në shpërndarjen e ndihmës sociale, në administrimin në shkolla dhe midis trupave të oficerëve të ushtrisë shqiptare. Hetoni deklaratat rreth diskriminimit në autoritetet lokale, shkolla dhe në ushtri.

10. Ndërmerni hapa të rëndësishëm, në lidhje me romët dhe organizatat joqeveritare për të drejtat e njeriut, për të futur planë mësimore dhe programe anti-raciste në shkolla dhe në media.

BIBLIOGRAFIA

- ◆ - Abrahams, Fred, "Europe's Shame", *Koha Jonë*, March 20, 1997, p.4.
- ◆ - Albanian Human Rights Group, "Acts of violence, Maltreatment and Killings Inflicted on Roma population", press release, Tirana, April 6, 1997.
- ◆ - Amnesty International, *Albania: Detention and ill-treatment of Government Opponents- The Elections of May 1996*, London, September 1996.
- ◆ - Amnesty International, *Albania: A Call for the Release of Prisoners of Conscience*, London: November 1996.
- ◆ - Amnesty International, "AI Concerns in Europe: July-December 1996", March 1997.
- ◆ - Biberaj, Elez, "Albania at the Cross-roads", *Problems of Communism*, Vol. XL, No. 5, September-October 1991.
- ◆ - Burner, George, *Nemzetiségi kérdések és kisebbségi konfliktusok Kelet-Európában*. Budapest: Teleki László Alapítvány, 1995.
- ◆ - Bugajski, Janusz, *Ethnic Politics in Eastern Europe*, Armonk, N.Y.: M.E. Sharpe, 1994.
- ◆ - Champseix, Elisabeth and Jean-Paul, *L'Albanie ou la logique de désespoir*, Paris: Editions la Découverte, 1992.
- ◆ - Cortiade, Marcel, "Schutz für die Roma Albaniens: offener Brief an das Europarlament", *Romano Li*, March 1997, p.3.
- ◆ - *The Constitutional Law of the Republic of Albania*, unofficial translation by Agron Alibali.
- ◆ - Costa, Nicholas, *Albania: A European Enigma*, East European Monographs, No. CDXIII, New York: Columbia University Press, 1995.
- ◆ - Dimitras, Panayote Elias, "Immigrants for Hire or Expulsion", *War Report*, October, 1996.
- ◆ - Draper, Stark, "The Conceptualisation of an Albanian Nation", *Ethnic and Racial Studies*, Vol. 20, No. 1, January 1997.
- ◆ - Duka, Jeta, Duka, Jenuz and Veliu, Skender, "Famille, habitat, emploi chez les roms", *Les Familles Roms d'Europe de l'Est*, IDEF, No. 3, 1993.
- ◆ - European Roma Rights Center, *Sudden Rage at Dawn: Violence Against Roma in Romania*, September 1996.
- ◆ - European Roma Rights Center, *Time of Skinheads: Denial and Exclusion of Roma in Slovakia*, January 1997.
- ◆ - European Roma Rights Center, *The Misery of Law: The Rights of Roma in the Transcarpathian Region of Ukraine*, April, 1997.
- ◆ - Fonseca, Isabel, "Among the Gypsies", *The New Yorker*, September 25, 1995, pp. 84-97.
- ◆ - Fonseca Isabel, *Bury me Standing. The Gypsies and Their Journey*, London: Chatto & Windus; New York: Alfred A. Knopf, 1995.
- ◆ - Hall, Derek, *Albania and the Albanians*, London: Pinter Reference, Pinter Publishers Ltd., London, 1994.
- ◆ - Harxhi, Edith, *An Invitation to Albania*, Tirana: MCM Rruga, 1995.
- ◆ - Hasluck, Margaret, "The Gypsies of Albania", *Journal of the Gypsy Lore Society*, Vol.XVII, Nos.2,3, and 4, 1938.
- ◆ - Human Rights Watch, *Human Rights Watch World Report 1996*, December 1995.
- ◆ - Human Rights Watch, *Human Rights Watch World Report 1997*, December 1996.
- ◆ - International Helsinki Federation of Human Rights, *Annual Report 1995*, Vienna, 1995.
- ◆ - International Helsinki Federation of Human Rights, *Annual Report 1996*, Vienna, 1996.

- ◆ - Kanev, Krasimir, "Dynamics of Inter-Ethnic Tensions in Bulgaria and the Balkans", *The Balkan Forum* (Skopje), Vol. 4, No. 2(15), June 1996.
- ◆ - Kenrick, Donald and Puxon, Grattan, *Gypsies Under the Swastika*, Hatfield: University of Hertfordshire Press, 1995.
- ◆ - Kolsti, John, "Albanian Gypsies: The Silent Survivors" in Crowe, Jim and Kolsti, John, *The Gypsies in Eastern Europe*, Armonk, New York: M.E. Sharpe, 1991.
- ◆ - Kovats, Martin, "The Good, the Bad and the Ugly: Three Faces of 'Dialogue'- the Development of Roma Politics in Hungary", in *Phralipe*, January-February, 1997.
- ◆ - Krasztev, Péter, "Vérisszák", *Beszédo*, Vol. III, No. 4, April, 1997.
- ◆ - Kurtiade, Marcel, "Between Conviviality and Antagonism: The Ambiguous Position of the Romanies in Albania", *Patrin*, No. 3, 1995.
- ◆ - Luarasi, Aleks, "Aspects of the legal Reform in Albania", *The Balkan Analyst*, No.1, January-March 1996, Institute of International and Strategic Studies, Tirana, Albania.
- ◆ - Lubonja, Fatos, T., "Pyramids of Slime" *Transitions*, Vol.4, No. 1., June, 1997.
- ◆ - Mijs, Jetske, "Albanian Roma Cry Out for Attention: Their Own Newspaper, But for How long?, *O Drom*, No.3, 1994.
- ◆ - Minnesota Advocates for Human Rights, Trial Observation Report: *The Albanian Trial of Five Ethnic Greeks for Espionage*, Minneapolis: September 1994.
- ◆ - *The Penal Code of the Republic of Albania*, unofficial translation by Kathleen Imholtz.
- ◆ - *The Penal Procedure Code of the Republic of Albania*, unofficial translation by Andi Dobrushki.
- ◆ - Poulton, Hugh, *Who Are the Macedonians?* London: C. Hurst and Co., 1995.
- ◆ - Puolton, Hugh, *The Balkans: Minorities and States in Conflict*, London: Minority Rights Publications, 1994.
- ◆ - Rekosh, Edwin, ed., *In the Public Eye: Parliamentary Transparency in Europe and North America*, Washington D.C.: International Human Rights Law Group, 1995.
- ◆ - Repa, Barbara Kate, "Albania: Making Law in a Lawless Land", *Student Lawyer*, January 1993.
- ◆ - Tarifa, Fatos, "Neither 'Bourgeois' nor 'Communist' Science: Sociology in Communist and Post-Communist Albania", *Communist and Post-Communist Studies*, Vol. 29, No.1, 1996.
- ◆ - United Nations Development Programme, *Albanian Human Development Report 1996*, 1996.
- ◆ - U.S. Department of State, *Country Reports on Human Rights Practices for 1994*, Washington: U.S. Government Printing Office, February 1995.
- ◆ - U.S. Department of State, *Country Reports on Human Rights Practices for 1995*, Washington: U.S. Government Printing Office, April 1996.
- ◆ - U.S. Department of State, *Albanian Country Report on Human Rights Practices for 1995*, Washington: U.S. Government Printing Office, January 30, 1997.

2. SHTOJCAT

SHTOJCA 1. Minoritetet etnike në Shqiperi

	Regjistrimi (1989)	Poultion ¹⁹¹	Brunër ¹⁹²	Bugajski ¹⁹³	Dept. I Shtetit US ¹⁹⁴	Burime Greke	Burime Maqedonase	Burime Rome
Grekë	58.757	40.000–100.000	59.000	55.000–200.000	80.000	150.000–400.000	--	
Maqedonas	4.697	100.000–200.000	6.000	5.000	Jo i sakte ¹⁹⁵	--	5.000-- 20.000	
Romë	1.261 ¹⁹⁶	10.000	60.000	10.000	100.000	--		80.000--120.000

SHTOJCA 2. "Arxhinjte e Shqipërisë, Pjesa III", nga Margaret Hasluck

(Originali është botuar në *the Journal of Gypsy Lore Society*, Vol. XVII, No. 4, 1938)

Duhet bërë e qartë që shqiptarët i përbuzin të gjithë arxhinjtë.[...] "Me nder, po vinë arxhinjtë, *me nder po vinë jevga*," u shpreh një mysafir në një dasëm në një fshat në Dumre. "Me nder si mëhallë jevgjish", u shpreh një amvisë tiranase e një fshati të mbajtur keq. "A duhet pritur ndonjë gjë prej një arxhiu? *Prej xhîpi a del xha?*" Pyeti një dibran. Një frikacak përshkruhet si "një arxhi prej shtatë brezash. *Shtatë brezash jefkë*." Një mallkim që përdoret për gratë e moshuara nomade është "Të piftë gjakun shejtani¹⁹⁷--*Të bangërt i pjekmi(d.m.th kokudbi) zemrën!*". Vrasja e një arxhiu "nuk konsiderohet si e qene" në mënyrë emfatike: dikush mund të vrasë po kaq mirë një grua: pas një krimi të tillë kaq të shëmtuar, pavarësisht sa i fortë është provikimi, asnjë shqiptar nga Luma nuk të thotë, "Si ja conit?" Vdekja në duart e një arxhiu është në mënyrë të ngjashme e turpshme. Kur Gjete Coka,¹⁹⁸ nënprefekti i Lesh-it, u vra me porosi të armikut të tij, Prenk Pasha i Mirditës, familja e tij ishte veçanërisht e tërbuar nga fakti që i dërguari i Pasha-s ishte një arxhi. Fshatarët ortodoksë të Shqipërisë së mesme rëfejnë që njëherë një derr i egër ishte qëlluar në atë zonë nga një arxhi. Një unazë e gjetur në një nga këmbët e përparme tregonte që ai ishte një spahi mohamedan nga rrethi ngjitur i cili ishte shndëruar nga një mallkim në një derr, që është kafsha më e nëveritshme në sytë e myslimanëve. Por ky transformim nuk ishte gjë para mënyrës se si vdiq. Këtu, shikohet që një element shtesë shtrëmbërues i është dhënë rrëfimit populor rreth shndërrimit të mohamedanëve në derra. Në 1914, rebelet kundër princ Vidit, mbretit të Shqiptarëve, kapën Fehmi Kosturin, një patriot shqiptar që rridhte nga një familje e mirë, i cili mbështeste princin. Për ta poshtëruar atë në maksimumin e mundshëm, ata i hipën një arxhi në kurriz dhe e detyruan të bridhte nëpër Tiranë.¹⁹⁹ Shumë zbatimet, shqiptarët ndonjëherë përfitojnë nga përbuzja me të cilën i trajtojnë arxhinjtë. Fshatarët që kultivojnë duhanin ndalohen me ligj të mbajnë makina për bluarjen e gjetheve në cigare, por grirja ilegale vazhdon dhe xhandarët herë pas here kerkojnë për makina të fshehura. Në të paktën një fshat, fshatarët i presin vizitat e tyre të vazhdueshme me indiferentizem. E vetmja makinë që ka ngelur në atë vend mbahet nga arxhinjtë e fshatit dhe, sic më tha shoqëruesi im, "Kush shkon të shikojë se ç'po bën një arxhi? Ai është vetëm një arxhi!" Shumë shqiptarë në Elbasan thonë se kur bie shi, arxhinjtë vijnë erë tamam si qentë. Njëherë tenda me të cilën udhëtova në verë, një *Wlymper*, më kushtoi sa shërbimi i një xhandari të shkëlqyer. Natën e parë që e ngritëm atë, thërriti një fshatar. "Unë nuk mund të mendoj ç'lloj arxhinjsh kanë një tendë të tillë", spiegoi ai. Ditën tjetër xhandari, i cili nuk duroi dot idene se po merrej për një arxhi, iku. Tashti së fundi, një fshatar mohamedan nga zonat rrotull Elbasanit i vinte rrotull një vejushe të re në një shtëpi në të cilën ai hynte e dilte si mik, dhe së fundi i mbushi mendjen asaj t'ja mbathin së bashku dhe të martohen legalisht. Por në fshatrat shqiptare, vejushat e reja janë pronë e familjes së burit, dhe pasuria e një shoku është e paprekshme. Kështu vëllai i burrit e qortoi atë rëndë pas martesë, duke thënë se sjellja e tij ishte "kaq e ulët sa as një arxhi endacak, cifut ose armen" s'do të ishte fajtor për të. Në një breg që qëndron sipër përroit të Bicaj në Shqipërinë Lindore një derë e hekurt mbyll hyrjen e një shpelle në të cilën fshihet një thesar; kjo derë thuhet të jetë kaluar vetëm nga një plak shqiptar dhe një grua arizheshkë, d.m.th dy krijesa që nuk kishin ç'të prisnin nga jeta dhe s'i trembeshin vdekjes. Kur një fshatar nga Zdrashi i Cermenikës raportoi se qeni i tij ishte terbuar, hoxha e bindi të mos e vrasë atë vetë, por t'i jepte një arxhiu të fshatit një fishek me të cilin

¹⁹¹ Poulton, Hug, *The Balkans: Minorities and States in Conflict* [Minoritetet dhe shtetet ne konflikt], London: Minority Rights Group, 1991.

¹⁹² Bruner, Georg, *Nemzetiségi kérdés és kisebbségi konfliktusor Kelet-Európában*. Budapest: Teleki László Alapítvány, 1995.

¹⁹³ Bugajski, Janusz. *Ethnic Politics in Eastern Europe* [Politikat etnike ne EUROPIANE lindore]. Armonk, New York: M.E. Sharp. 1994.

¹⁹⁴ US Department of State, cituar me pare, 1995, p.727.

¹⁹⁵ Ne pyetesorin per regjistrimin e popullsise nuk ka patur alternative te veçante per romet (arxhinjte). Shifra qe tregohet ketu eshte per "te tjere" dhe perfshin edhe vllahet.

¹⁹⁶ "Small ethnic Macedonian Villages exist in the north-east part of the country" [Fshatra te vogla maqedonasish etnike ekzistojne ne veri lindje te vendit], burimi paraardhes, p.727.

¹⁹⁷ Perktimi sipas shprehjes se aurores ne anglisht [A vampire suck your blod!]

¹⁹⁸ Emri i dhene sipas shqiptimit lokal.

¹⁹⁹ Shkrimtari anonim i *Near East and India* [Lindja e afert dhe India], 12 Shtator 1935, p.326, qe jam une, gabimisht ja atribuoi kete denim turqve.

ta qëllonte; si fshatari edhe arixhiu ishin mohamedanë, dhe të vrasësh është mëkat për mohamedanët, por për të shpëtuar shpirtin e fshatarit, hoxha nuk e cante kokën për arixhiun. Në opinionin shqiptar është zoti ai që i ka bërë arixhinjte kaq inferiorë;[...] Në tërësi, nomadët përbuzen më pak se sedentarët, sepse ata mbajnë armë, cilësi e admiruar më shumë se çdo gjë tjetër nga shqiptarët e qëmoti. Edhe pse armëmbajtja pa leje tani është e ndaluar, shumë nomadë janë ndoshta akoma të armatosur, dhe në kohën e turqve vlerat e trimërisë së tyre qëndruan kaq lartë sa që afër Lushnjës ata u inkurajuan të ndërtonin kasolle afër vëndbanimit të fshatarëve të pasur kështu që, si qentë e rojes, ata mund t'ju jepnin këtyre njerëzve sinjalin e ardhjes së armiqve të tyre. Sedentarët përshkruhen në mënyrë kaq përbuzëse si frikacakë sa që në kohën e Turqisë ata nuk mbanin armë as sa për ti treguar. Mua mu ofruan vetëm tre raste të të qëlluarit për vdekje: njëra ishte vrasja (false) e dëgjuar e Gjetë Coka-s, e dyta ishte ngjashmërisht një vrasje e paguar, dhe në të tretën ishte qëlluar një burrë kur po largohej me të shoqen e tij.

Forca e urrejtjes që shqiptarët ndiejnë ndaj arixhinjve demonstron shumë mirë në historinë e mëposhtme. Një familje arixhinjsh në Përmet në jug të Shqipërisë e cila kishte emigruar në Amerikë mbasi bëri ca para u kthye në Shqipëri menjëherë pasi e bija kishte marrë një diplomë në histori në një universitet amerikan. Ajo dëshironte të punësohej si mësuese në Shqipëri, por Ministria e Arsimit nuk do ta aktivizonte. Legata amerikane shqyrtoi rastin e saj dhe ju kerkoj drejtorëve të shkollës femërore të Kyrias, të cilët ishin shqiptarë të trenuar në Amerikë, ta punësonin. Ata ju përgjigjën se nuk donin të rrezikonin duke bërë një gjë të tillë, sepse nxënësit nuk do ta respektonin atë dhe mund të shtrinin mungesën e respektit ndaj saj tek mësuesit e tjerë. Përsëri me kërkesën e legatës amerikane, shkolla amerikane e femrave në Kavajë, e cila ishte nën drejtimin amerikan, e punësoi atë. Por shumë shpejt asaj i duhej të largohej. Vajzat e tallnin hapur për të qënit "arixheshkë" dhe mësuesit shqiptarë i qëndruan ftohtë. Tipi më i mirë i mësuesit dhe femrës e pranoi se ajo ishte e mirë dhe e sjellshme si dhe e zgjuar, por ata nuk mund të frenonin valën e urrejtjes kundër saj. Më vonë ajo gjeti punë si gazetare në Tiranë. Mjaft e vjetër për tu martuar, në këtë kohë ajo nuk mund të gjente normalisht burrin shqiptar të cilin dëshironte; asnjë nuk do të poshtërohej për tu martuar me të. Kështu ajo shpalli, ose u tha që shpalli, një lajmërim në gazetë ku thuhej se ajo do ti bënte burrit të saj një pajë prej 2.000 napolonash (afërsisht £ 1.500), dhe kjo në një vend ku paja e një femre të pasur rrallë e kalon cerekun e kësaj shume. Një femër shqiptare këshilloi shërbëtorin e të jatit të saj ti përgjigjej lajmërimit. Ai nuk e kuptoi se ajo bënte shaka, dhe megjithëse i varfër sa një lypsar, ishte shumë i ofenduar nga ky sugjerim. Në fund arixheshka gjeti një emigrant rus që deshi të martohej me të për hir të pajës së saj.

Nga mënyra si trajtohen kuptohet që arixhinjtë shikohen në kuadrin e tabuve të ndryshme. Në Zdrajsh, një fshat mohamedan në lindje të Elbasanit, më parë madje edhe arixhiu i fshatit ndalohej të hynte në një shtëpi shqiptare; nëse ai e bënte këtë, fshatarët mendonin që, ëngjëjt kaq shumë të vlerësuar nga mohamedanët, nuk do të hynin në shtëpi për 40 ditë. Në fshatin ortodoks të Shpatit në jug të Elbasanit, as arixhinjtë nomadë dhe as ata të stabilizuarit nuk pranoheshin në shtëpi një brez më parë; nëse dikush do të hynte pa pyetur, thërritej një prift për të bërë një lutje pastrimi. Madje edhe sot, shumica e shqiptarëve nuk hanë me arixhinjtë. Pak burra mund të pranojnë ta bëjnë këtë, por gratë kurrë; "kanë merak." Zoti të ndalon!" Lëshoi një pasthirmë një fshatar i krishterë kur unë akoma pa e njohur tabunë, e detyrova të hajë mëngjes me dy vizitorë arixhinj. Njëherë në Cermenikë unë organizova një drekë në fshat si shpërblim ndaj mikpritjes që më ofruan në disa fshatra. Unë poqa një dele të tërë në hell në natyrë dhe pregatita kazanë të tërë me supë dhe me pilaf. Meqe paisjet e tendes time nuk mjaftonin, unë u detyrova të marr tiganë dhe kusi në fshatin fqinj. Edhe pse gjeta më të mirin tek kovaci arixhi, unë nuk mund të rrezikoja ta ftoja atë në drekë. Ata pak burra që ishin aq liberale sa të hanin me një arixhi hynë dhe zgjodhën; arixhiu i privilegjuar nuk duhet të jetë një nomad, dhe duhet të jetë jashtëzakonisht i veçantë në larjen e duarve (shqiptarët në të gjithë vendin, jo vetëm mohamedanët, i lajnë duart para se të hanë bukë). Njeriu që ftohet të hajë me një arixhi duhet të zgjidhet me kujdes. Në një martesë fshati për shembull, orkestrantët, të quajtur më saktë "ustallarët", gjithmonë vendosen në një tavolinë të veçantë për të ngrënë. Ata janë kaq pak sa që asnjëherë nuk e mbushin tavolinën e tyre, ndërsa miqtë kaq shumë sa tavolinat e tyre rrinë ngjeshur. Nëse i zoti i dasmës dëshiron ti thotë dikujt nga mysafirët të ulet në tavolinën e ustallarëve, ai duhet t'ja kërkojë këtë nder vetëm njerëzve të afërm ose shokëve të ngushtë. Të tjerët mund të ofendohen, dhe duke flakur tutje mirësjelljen ceremoniale të rastit, thërrasin egërsisht: "Do të më ulësh të ha me arixhinjtë?" Ë njëjta tabu shfaqet midis arixhinjve, sepse asnjë arixhi sedentar nuk do të hante me nomadin. Kjo shfaqet në një formë tjetër në familjet që mbajnë shërbëtorë arixhinj; edhe pse këta shërbëtorë mund të lajnë pjatat pas vaktit, ata mund të mos gatuajnë. "Kush do të mund të hante ushqimin e një arixhiu?" Pyesin gratë shqiptare me rrenqethje. Në shtëpinë e një beu në Elbasan, ka si shërbëtorë gra shqiptare, ashtu edhe pastruese arixheshka; këto gra nuk do ta hanë ushqimin që kanë prekur arixheshkat.

Shtrëngimi i duarve me arixhinjtë është gjithashtu tabu. Kështu, një xhandar në Bulqizë jeton në kujtesën time si një përjashtim i gëzueshëm. Ai më shoqëroi me dëshirë në shtëpinë e një arixhiu aty rrotull, shtërngoi duart njerëzisht me të zotin, dhe piu kafënë e tij. Në mënyrën e zakonshme, asnjë shqiptar nuk do të vallëzonte me një arixhi; në gjithë eksperiencën time unë kam parë një vallëzim të tillë vetëm dy herë.²⁰⁰ Në xhami arixhinjtë, edhe pse lejohen në godinën kryesore, duhet të qëndrojnë në fund; nëse ata rrinë në krye shqiptarët mbrapa tyre do të mendojnë që u luten kot. Fyerja ndaj kësaj tabuje mund të ketë qenë një nga faktorët që shtyu vendalinjtë e Durrësit të ndërtojnë një xhami vetëm për arixhinjtë. Në Gjirokastrë, por jo në Korçë, vendalinjtë kristianë janë kufizuar në pjesën e tyre të kishës. Madje tabuja vazhdon edhe në vdekje; në varrezat mohamedanë të paktën dy racat qëndrojnë larg njëra-tjetrës, të ndara nga një rrugë ose një hendek.[...]

²⁰⁰ Shiko JGLS, *Jubilee Number*, p.27, per nje rast.

Romët (arixhinjtë) ngelen deri tani grupi etnik më i shtypur i Evropës. Pothuajse kudo, të drejtat e tyre bazë humanë janë të kërcënuara. Në vitet e fundit kanë ndodhur raste shqetësuese të dhunës raciste kundër romëve. Diskriminimi kundër romëve në punësim, edukim, kujdes shëndetësor, shërbime administrative e të tjera janë të zakonshme në çdo shoqëri. Fjalimet plot urrejtje kundër romëve thellojnë më tej stereotipet negative që sundojnë opinionin publik Europian. Qendra Europiane për të Drejtat e Romëve (*The European Roma Rights Center*) është një organizatë ndërkombëtare e së drejtës së interesit publikut e cila monitoron situatën e të drejtave të njeriut të romëve dhe ofron mbrojtje legale në rastet e abuzimit ndaj të drejtave të njeriut.

Qendra Europiane për të Drejtat e Romëve drejtohet nga një Bord Ndërkombëtar Drejtorësh, i cili udhëhiqet nga András Biró (Hungari) dhe përfshin Isabel Fonseca (Angli), Nicolae Gheorghe (Rumani), Deborah Harding (USA), Rudko Kawczynski (Gjermani), Khristo Kyuchukov (Bullgari), Lord Lester of Hernë Hill QC (Angli), Edgar Morin (France), Ina Zoon (Republika Ceke/Spanjë).

Dimitra Petrova është Drejtore Ekzekutive. Stafi përfshin: Claude Cahn (Koordinator Kërkimesh), Csilla Dér (Asistente Ligjore), James Goldston (Drejtor Ligjor), Nikolai Gughinski (Avokat), Judit Horváth (Asistente Ligjore), László Kemeny (Asistent ekzekutiv), Sarolta Kiss (Asistente), Petra Kovats (arkiviste), Veronika Leila Szenté (Kërkuese), Nidhi Trehan (Koordinatore per edukimin), Rita Vásárhelyi (Receptioniste).

EUROPEAN ROMA RIGHTS CENTER

H-1525 Budapest 114, P.O. Box 10/24, HUNGARY

Tel: (36-1) 4282-351

Fax: (36-1) 4282-356

E-mail:

gandi@errc.org

Internet: <http://errc.org>